

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7844 E diel 7 Prill 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* Ditës

Gjithçka filloi me një video të postuar në mediat sociale, një regjistrim sekret i vitit 2016, që duket se tregonte një oligark të njohur vendës duke ...
Vijon në faqen 21

Nga "ZËRI I AMERIKËS"

Ballkani Perëndimor, në darën e protestave



Intervista *e* Ditës

BE vërtet aktualisht është shumë e mbingarkuar, por nuk duhet ta harrojmë Ballkanin Perëndimor; thotë Michael Roth, Sekretari i Shtetit për Europën në ...
Vijon në faqen 22

Nga MICHAEL ROTH

Roth: Ka rënë interesi strategjik për Ballkanin Perëndimor



Ministri: I realizuar nëpërmjet rregullave të qarta të biznesit

"Prestige Resort" destinacion turistik, ministri Klosi: Ambient europian

"Kompleksi fantastik në Golem, i shfrytëzueshëm në të 12 muajt e vitit"

"Prestige Resort" ishte një nga më të preferuarit në sezonin e kaluar turistik dhe tashmë është shndërruar në një destinacion, që ofron turizëm jo vetëm në verë, por në 12 muajt e vitit. Kështu e ka cilësuar ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi, hotelin prestigjioz buzë detit Adriatik në Golem, i cili është bërë i dashur jo vetëm për turistët vendës ...
Në faqen 9

IU ZUNE TOKAT, SI NDAHEN 347 MILIONE LEKE MES TYRE KOMPENSOHEN 600 PRONARE, EMRAT

Agjencia e Trajtimit të Pronës: Përfituesit në pesë qytete kryesore, Tiranë, Elbasan, Durrës, Shkodër, Lezhë e Vlorë



(Në foto) Ndertime informale

Në faqen 6

PERPLASJA

Aeroporti i Kukësit gati në 2020-ën, PD-LSI: Rama mashtron popullin

Në faqen 4

DEKLARATA

KE, Kocijançiq: Djegia e mandateve minon rrugën e Shqipërisë për në BE

Në faqen 2

SHERR ME INXHINIERET

Pallati 28-katësh të Shkëmbi i Kavajës i paqëndrueshëm, pronari i kërcënon

Në faqen 8

DOSSIER

Me Endri Kekon, njeriun e artistin, jeta e panjohur e regjisorit

Në faqen 10-11

TRI FAZAT



Dy britanikët që po këshillojnë PD-në, ja sugjerimet që do ta ndryshojnë

Në faqen 3

Bashkëshortja: Natën e lë burrin vetëm, i shërbej një plake për të mbijetuar

Babai i 3 fëmijëve i vë flakën vetes: Doja të vdisja

Xhevahir Xhozi: Jam i sëmurë prej shumë vitesh, nuk marr përkrahje

NGA ENEIDA PETOVA

Një 63-vjeçar nga lagja "Çelepias" në qytetin e Beratit ka tentuar t'i japë fund jetës duke i vënë flakën vetes, pasi është lyer me benzinë. Ngjarja e rëndë ka ndodhur në lulishten e lagjes ku ai banonte dhe



kanë qenë kalimtarët, të cilët kanë njoftuar patrullën më të afërt të policisë, që e kanë transportuar me urgjencë në Spitalin Rajonal të Beratit. Pasi ka marrë mjekimin në Kirurgjinë e Beratit, 63-vjeçari ndodhet aktualisht i shtruar ...
Në faqen 7

SITUATA POLITIKE NEGOCIATAT

VOA: Paqëndrueshmëri politike në Shqipëri para zgjedhjeve dhe vendimit të BE

KE, Kocijançiq: Djegia e mandateve minon rrugën drejt BE-së

"Vendimi i opozitës pengon funksionimin e demokracisë"

Në qershor Shqipëria do të mësojë nëse Bashkimi Evropian do të vendosë për të hapur negociatat e anëtarësimit. Por, po në muajin qershor në Shqipëri janë planifikuar të zhvillohen zgjedhjet lokale dhe ndoshta pa pjesëmarrjen e partisë kryesore të opozitës, sipas "Zërit të Amerikës", ndërsa këto dy ngjarje afrohen, në vend po rritet paqëndrueshmëria politike. Protesta të përjavshme në rrugët e Tiranës, ndërsa Bashkimi Evropian përgatitet të marrë vendim nëse do të hapë bisedimet për ta pranuar Shqipërinë si anëtare të re. Protestat janë bërë të zakonshme që kur partia kryesore e opozitës u largua nga parlamenti në muajin shkurt. Partia Demokratike shprehet se nuk do të marrë pjesë në zgjedhjet lokale të qershorit, pa dorëheqjen e kryeministrit dhe formimin e një qeverie tranzicioni. "Kërkojmë dorëheqjen e kryeministrit Rama, një qeveri tranzicioni të përbërë nga socialistë që nuk janë të lidhur me krimin, të cilët mbi të gjitha do t'u zgjidhnin duart prokurorëve që të vendosnin përpara drejtësisë politikanët, të cilët janë kapur duke vjedhur zgjedhjet e vitit 2017, si dhe do të punonin me opozitën për të çuar përpara reformën zgjedhore dhe atë në drejtësi", shprehet Lulzim Basha, kryetar i Partisë Demokratike të Shqipërisë. Kryeministri Edi Rama deklaroi se qeveria e tij ka bërë shumë përparime lidhur me reformën në drejtësi, luftën ndaj krimit, korrupsionit dhe trafikut të drogës. Ai thotë se i takon opozitës të vendosë nëse do të marrë pjesë ose jo në zgjedhjet e qershorit. "Ne jetojmë në një vend të lirë, sigurisht që nuk është ende një demokraci e konsoliduar, por jemi të fortë sa duhet që jo thjesht vetëm ta kuptojmë, por edhe të sillim bazuar në parimin sipas të cilit, zgjedh-



Maja Kocijançiq

European Commission
Commission européenne

MAJA KOCIJANÇIQ
"Shqipëria ka arritur rezultate të prekshme në të gjitha fushat. Vendimi i opozitës për të dorëzuar mandatet pengon seriozisht funksionimin e demokracisë në Shqipëri dhe minon progresin që vendi ka bërë në rrugën drejt Bashkimit Evropian", - deklaroi zëdhënësjja e KE-së.

Çollaku: Veting për shërbimin diplomatik

PD: Rama drejt fundit, saldimi i Kryeministrit nuk e shpëton

Kreshnik Çollaku, anëtar i kryesisë së PD-së, u shpreh për "Politika Online" se protesta e datës 13 prill do të jetë një nga protestat më të mëdha opozitare që ka parë vendi. Çollaku tha më tej se kjo protestë do të përcaktojë zhvillime të reja në vend dhe se kryeministri Rama është drejt fundit të destinacionit që i ka projektuar populli. Sipas Çollakut, Rama e ka salduar me çelik godinën e Kryeministrit dhe me fasadë që imiton xhamat, por Kryeministri Rama është i humbur, pasi ndiqet këmba-këmbës nga qytetarët. Po kështu, Çollaku shprehet i



bindur se s'do të ketë zgjedhje pa opozitën, pasi 50% të komisionerëve zgjedhorë ku PD-ja ka shumicën nuk mund të hapin procesin dhe se ç'do skenar tjetër është grusht shteti që do të pasohet me konflikt civil. Sipas përfaqësuesit të PD-së në Bashkinë e

Tiranës, mandatet e opozitës janë dëgjur automatikisht për shkak të bojkotimit të Këshillit Bashkiak. Çollaku thekson se kryetari i PD-së, Lulzim Basha, është keqkuptuar teksa kërkon të zgjidhë problematikën ballkanike me metoda europiane. Ish-zëvendësministri i Punëve të Jashtme shprehet se në Shërbimin Diplomatik Shqiptar ka nevojë për veting, sepse ka infiltrime të fuqive jo miqësore ndaj vendit. Kommentet, Kreshnik Çollaku i bëri nga studio e emisionit "Politika Online" në "Gazeta Shqiptare" dhe "Balkanweb".

jet janë për të gjithë", deklaroi zoti Rama. Ndërkohë, ka shqetësime se përshkallëzimi i trazirave politike do të dëmtojë përpjekjet e Shqipërisë për të hyrë në BE. Zëdhënësjja e Komisionit Evropian Maja Kocijançiq i

thi "Zërit të Amerikës" se pavarësisht tensioneve aktuale politike, Shqipëria ka arritur rezultate të prekshme në të gjitha fushat. Por, ajo shtoi se vendimi i opozitës për të dorëzuar mandatet pengon seriozisht funksionimin e demokracisë në Shqipëri dhe minon progresin që vendi ka bërë në rrugën drejt Bashkimit Evropian. Kur mbeten më pak se tre muaj nga zgjedhjet lokale, pjesëmarrja e Partisë Demokratike,

opozitës kryesore të vendit, është e paqartë dhe njerëzit pyesin se sa legjitime do të ishin këto zgjedhje në këtë rast. Udhëheqësi i opozitës, Lulzim Basha, thotë se nuk është marrë ende një vendim përfundimtar lidhur me pjesëmarrjen në zgjedhje. Duket se e ardhmja politike e Shqipërisë dhe rruga e saj drejt Bashkimit Evropian tani për tani do të vazhdojë të jetë e pasigurt.



SHKURT

Ruçi në Katar: Me rëndësi, heqja e vizave për shqiptarët

Shqipëria ka interes të rrisë bashkëpunimin dhe të kërkojë shtimin e investimeve nga Katarin në projektet strategjike për vendin. Është kjo kërkesa e kryetarit të Kuvendit, Gramoz Ruçi, drejtuar homologut të tij gjatë vizitës zyrtare në Katar. Lehtësimi dhe heqja e vizave për shqiptarët është një tjetër aspekt që mundëson bashkëpunimin mes dy vendeve në shumë fusha, veçanërisht në atë të transportit ajror dhe hyrjen e "Katar Airways" për fluturime direkte Doha-Tiranë-vuri në dukje kryetari i Kuvendit. Gjithashtu, z. Ruçi kërkoj mbështetjen e shtetit të Katarit edhe për anëtarësimin e Kosovës në Interpol.

Bushati prezanton kandidatin e PS-së për Bashkinë e Pukës

Koordinatori i Partisë Socialiste në qarkun e Shkodrës, njëherazi deputet i Partisë Socialiste, Ditmir Bushati, prezantoi në Pukë, kandidatin e PS për zgjedhjet lokale të 30 qershorit. Ai është kryebashkiaku aktual Gjon Gjonaj. "Kreu i Bashkisë Pukë, z.Gjon Gjonaj, rikandidohet nga Partia Socialiste për të vazhduar projektin për transformimin e mëtejshëm të Pukës, Gjegjanit, Luf-Qerretit Qelzës dhe Rrapës. Prezantimi i z.Gjonaj u bë sot në Asamblenë e Partisë Socialiste të Bashkisë Pukë nga koordinatori politik i qarkut, z.Ditmir Bushati", shkruhet në njoftimin e Bashkisë Pukë.



Modeli konservator britanik, tri fazat kyçe për seleksionimin e kandidatëve

Deputetët nga anëtarësia, dy britanikët që po këshillojnë PD-në

Përzgjedhja, komision i posaçëm dhe votim nga anëtarësia

Valentina Madani

Anëtarësia e PD-së do të ketë fuqi të përfundimtare për përzgjedhjen e kandidatëve demokratë në parlament dhe në pushtetin lokal. Një grup pune nga Partia Konservatore Britanike po ndihmon PD-në në modernizimin e saj, duke nisur me modelin e ri të përzgjedhjes së kandidatëve. PD është në fazën finale të përgatitjes së modelit për përzgjedhjen e kandidatëve të saj nga anëtarësia. Për këtë qëllim, janë prej tri ditësh në selinë e PD-së Davis Jones, kryeverlësuesi i Komitetit të Seleksionimit të Kandidatëve të Partisë Konservatore Britanike dhe Joy Morrissey, ish-kandidate konservatore për Bashkinë e Londrës.



Davis Jones



Joy Morrissey

MBËSHETJJA

PD-ja është në fazën finale të përgatitjes së modelit për përzgjedhjen e kandidatëve të saj nga anëtarësia. Për këtë qëllim, janë prej tri ditësh në selinë e PD-së Davis Jones, kryeverlësuesi i Komitetit të Seleksionimit të Kandidatëve të Partisë Konservatore Britanike dhe Joy Morrissey, ish-kandidate konservatore për Bashkinë e Londrës.

SHKURT

Kokëdhima: Rama i çmendur, jo zgjedhje pa opozitën

Koço Kokëdhima, kreu i "Zgjidhja", deklaroi dje se forca politike që ai drejton është duke u përgatitur për zgjedhjet e 30 qershorit, kryesisht për bashkitë kryesore. Duke komentuar deklaratat e kryeministrit Rama se ne zgjedhje do të shkohet edhe nëse opozita vendos të mos marrë pjesë në to, Kokëdhima e quajti kreun e qeverisë një lider të çmendur. "Ne do të marrim pjesë në zgjedhje, nëse ato do të jenë gjithëpërfshirëse, pra ne nuk shkojmë në zgjedhje nëse nuk merr pjesë PD-ja. Vetëm një lider i çmendur si Edi Rama mund të bëjë deklaratat se ne bëjmë zgjedhje pa opozitën. Ai është i pasinqertë në çdo gjë. Para se të ftojë të tjerët në dialog, ai kokërr kusari duhet të lëshojë zgjedhjet, të lëshojë sovranitetin e shqiptarëve. Ai që mendon se mund të bëjë çdo gjë në këtë vend, që nuk pyet për Kushtetutë e ligje, ai është problemi më i madh që kanë shqiptarët sot. Unë nuk pres që ai të bëhet ndonjë ditë reflektues", tha Kokëdhima. Sipas tij, qeveria transitore nuk shtë zgjidhje, sepse kriza ka nevojë për ligj zgjedhor.

Kriza, Berisha takon zyrtarin e lartë të DASH

Ish-kryeministri Sali Berisha zhvilloi një takim me zëvendës-ndihmësin kryesor të sekretarit të Departamentit Amerikan të Shtetit, ambasadorin Jonathan Moore. Përmes një postimi në rrjetet sociale, Berisha shkruan se temë kryesore e takimit ka qenë situata aktuale në vend. "Takim me ambasadorin Johnathan Moore, zëvendës kryesor i ndihmëssekretarit të DASH, zyra e çështjeve të organizatave ndërkombëtare! Të dashur miq, unë pata një takim me ambasadorin Johnathan Moore, zëvendës kryesor i ndihmëssekretarit të DASH, Zyra e Çështjeve të Organizatave Ndërkombëtare. Me ambasadorin Moore, që më parë ka drejtuar Drejtorinë për Europën Juglindore në Departamentin e Shtetit dhe ka vizituar disa herë Shqipërinë patëm një diskutim të zgjeruar dhe shkëmbim të hapur të pikëpamjeve për gjendjen dhe zhvillimet në Shqipëri", shprehet z.Berisha.

"Babale", Spaho: Kupola qeveritare në afëra mafioze, prokuroria pjesë e skemës

Nënkryetari i PD-së, Edmond Spaho, akuzoi dje se kupola qeveritare është përfshirë në afër mafioze. Spaho deklaroi se përgjimet e fundit të publikuara në media tregojnë përfshirjen mafioze të qeverisë së vendit. "Gjatë gjithë kësaj jave, qytetarët shqiptarë dhe opinioni ndërkombëtar kanë parë dhe dëgjuar përgjimet zyrtare nga prokuroria, që provojnë skandalin mafioz të lartë të Policisë së Shtetit kanë paguar para në dorë aktor të qeverisë, Fredi Alizoti,



i dënuar më parë për trafik droge, në mënyrë që të gjënet se ishte ai dhe jo Agron Xhafaj, që koordinonte trafikun e drogës nga Vlora. Përgjimet zyrtare të prokurorisë tregojnë se ky skenar kriminal është vënë

në zbatim nga një bashkëpunim mes drejtuesve më të lartë të Policisë së Shtetit, kupolës politike të Rilindjes dhe qeverisë, me përfshirje direkte të prokurorisë dhe Shërbimit Informativ Shtetëror", u shpreh Spaho. Sipas tij, prokuroria nuk ka vepruar për rastet e fundit mafioze, por është bërë palë me Edi Ramën dhe krimin e organizuar. "Prokuroria duhet t'i kishte vënë prangat për dëshmitar të rreme, drejtorit të sapoemëruar të Fierit, Andon Marko, i cili ka deklaruar se e ka takuar vetëm një herë aktorin e qeverisë, në një kohë kur përgjimet faktojnë të kundërtën", tha Spaho.

si një veting brenda partisë, i cili jep mundësinë e zgjedhjes së kandidatëve më të përshtatshëm që do të përfaqësojnë PD-në në parlament dhe në pushtetin lokal. Kreu i PD-së, Lulzim Basha, para dy ditëve gjatë një bashkëbisedimi me studentët e Universitetit Politeknik prezantoi sistemin e ri të përzgjedhjes së kandidatëve, duke theksuar se kërkon demokratizimin e PD-së dhe ka mbështetur partnerëve perëndimorë. "Unë jam i vendosur ta demokratizoj dhe modernizoj PD-në dhe për këtë kam mbështetur e botës perëndimore, të Partisë Konser-

vatore, të Partisë Kristian-demokratike të Partisë Republike të SHBA. Sistemi që ne do të adoptojmë është një sistem që e hap PD-në. E hap ndaj çdokujt që ndan vlerat tona dhe i jep mundësi përmes garës që të kontribuojnë. Që të ndryshojë politika, duhet të ndryshojnë partitë politike. Nëse brenda partive e gjithë vendimmarrja është në dorën e një njeriu, në rastin konkret të kryetarit të partisë që bën listën e deputetëve, ashtu do të jetë nesër edhe shteti, në dorën e një njeriu. Ne do t'i japim fund kësaj praktike, duke nisur brenda PD-së sot dhe

nesër në qeverisje", tha z.Basha. "Me procesin e zgjedhjes së kandidatëve - shtoi ai - ne do të ndjekim modelin evropian, do të mundësojmë që çdokush që ka interes të përfaqësojë politikisht qytetarët, komunitetin, në çdo nivel, kryebashkiak apo deputet të kenë mundësi të kandidojnë. Do ta bëjmë këtë duke u pamundësuar kandidimin personave me rekorde kriminale apo atyre që nuk janë të aftë. Britanikët po na ndihmojnë që ne të ndërtojmë një mënyrë të zbatimit të këtyre rregullave", tha z.Basha.

QEVERISJA DEBATI

Aeroporti, Rama inspekton punimet: Do të hapen 12 mijë vende të reja pune

Aeroporti i Kukësit, gati në 2020-ën. PD: Mashtrim, s'ka asnjë punim

LSI: Punësimi, gënjeshtër e tmerrshme e Ramës

Valentina Madani

Aeroporti i Kukësit do të përfundojë brenda pranverës së 2020, për kthimin në një aeroport që do të mirëpresë fluturime ndërkombëtare. Kompania koncesionare në kontratën me qeverinë shqiptare e ka të specifikuar se punimet do të zgjasin 24 muaj, përgjatë inspektimit të nisjes së punimeve kryeministrit Edi Rama i premtonte përgjysmim të afateve: "Ne si firmë koncesionare marrim përsipër që punimet të realizohen brenda vitit. Do avancojmë, do punojmë 3-turnesh, do shtojmë kapacitetet që kjo punë të mbarojë brenda prillit 2020, pavarësisht planifikimit". Garancinë kryeministri Edi Rama e mori gjatë inspektimit të nisjes së punimeve. "Është vendosur që të gjitha ndërtesat ekzistuese do të shemben për të ndërtuar një terminal të ri modern dhe me efikasitet të plotë. Shtimi i pistës do jetë kryesorja, pasi duhet të shtohet me disa qindra metra, gjë që do kërkojë kohën e vet. Megjithatë, ne jemi brenda afateve, pa i kaluar asnjë ditë", u shpreh z.Rama. Koha e përfutur nga përsheptimi i punimeve civile do të shfrytëzohet për certifikimin e aeroportit dhe trajnimit e stafit. Kryeministri Rama njoftoi se menjëherë pas përfundimit të këtij projekti, do të krijohet dhe certifikohet operatori i specializuar i aeroportit, me ndihmën e partnerëve europianë, ku stafi i aeroportit do të trajnohet për menaxhimin e tij. "Ka shumë procedura certifikimi, akreditimi. I pamë me 'Air Albania', që kërkohet kohë me kontroll, verifikime me grupe të ndryshme të organizmave ndërkombëtare, por ajo që është e rëndësishme është që puna civile të mbarojë më shpejt", deklaroi z.Rama.

AKUZAT

Partia Demokratike akuzoi dje kryeministrin Edi Rama se po mashtron kukësanët për ndërtimin e aeroportit të Kukësit. Partia Demokratike publikoi një video dhe shprehet se në pamje shihet qartë se makinë të largohen që aty, sapo Rama largohet nga Kukësi. Sipas PD-së, videoja tregon mashtrimin e Ramës me qytetarët e Kukësit. "Makinat që janë në video provojnë mashtrimin e Edi Ramës me nisjen e punimeve në aeroportin e Kukësit. Video është bërë dje (të premtën) rreth orës 17.00. Pas largimit të Edi Ramës,



Kryeministri Edi Rama në Kukës

Aeroporti, Balluku: Balta e përditshme e PD-së! Për 24 muaj do të jetë gati

Ministria e Infrastruktura dhe Energjisë, Belinda Balluku, reagoi dje ndaj akuzave të PD-së se punimet për ndërtimin e aeroportit të Kukësit nuk kanë nisur dhe se Rama mashtron kur thotë se do e ndërtojë atë dhe se akoma nuk është siguruar leja nga KKT. Përmes një statusi në "Twitter", Balluku sqaron: "Aeroporti ndërkombëtar i Kukësit është realitet. Punimet civile do të zgjasin 12



muaj dhe dorëzimi për operim 24 muaj. Kush e ka të paqartë këtë? Askush,

janë larguar të gjitha makinë të tija që ishin pjesë e 'show' të tij në Kukës. Ne aeroport nuk ka nisur asnjë punim, edhe për faktin se akoma nuk ka një leje ndërtimi nga KKT", thuhet në reagimin e PD-së.

REAGIMI

Nënkryetari i LSI-së, Përit Vasili, përmes një statusi në rrjetin social "Facebook" shkruan se Edi Rama gënjeu në një mënyrë të tmerrshme qytetarët në Kukës. Vasili tha se Rama në

Kukës deklaroi se me çeljen e aeroportit të Kukësit do të hapeshin 12 mijë vende të reja pune. Vasili vlerëson se kjo shifër është një gënjeshtër e tmerrshme e Ramës dhe të tijve. Ai bën një krahasim edhe me aeroportin ndërkombëtar "Nënë Tereza" dhe atë të Romës, duke thënë se edhe këto aeroporte, që kanë shumë udhëtarë, nuk kanë qatë punonjës. "Gënjeshtër e tmerrshme e Ramës e të tijve, me 12 mijë vende pune në Kukës, më

thjesht pak baltë edhe për sot. Kështu, për 24 muaj aeroporti do jetë gati. 12 muaj do të zgjasin punimet civile dhe 12 muaj e tjerë shërbejnë për certifikimin nga organizmat ndërkombëtarë. Ministria shton se, "ashtu siç bën në çdo rast, edhe opozita vijon të hedhë baltë mbi çdo punë të mirë, çdo projekt që gjeneron punësim e mirëqenie për çdo shqiptar". Reagimi i misstres Balluku vjen pas akuzave të PD-së se nuk ka nisur punimet për aeroportin e Kukësit

shumë se Roma dhe Rinasit bashkë! Dje (të premtën) me gojën plot Rama dhe të tijtë mbushën dyndjen me gënjeshtërën sa idioti, aq edhe diskutues se do hapnin 12 mijë vende pune në Kukës. Sebepe i këtyre 12 mijë vendeve pune ishte se aeroportin i Kukësit, i cili do të ketë sipas hesapeve të këtyre 300 mijë udhëtarë në vit. Po ju shpjegoj fare thjesht se sa të trashë janë Rama dhe të tijtë kur gënjejnë. Aeroporti ndërko-

SHKURT

Protesta, Berisha: Rama u hakmor në Kukës

Ish-kryeministri Sali Berisha, duke iu referuar mesazhit të qytetarit dixhital, shkruan se kryeministri Edi Rama është hakmarrë ndaj kukësanëve, që e priten të premtën me protestë, e sipas tij, "e përcollën me bisht nën shalë!". "Edvin Kristaq, urretësi hakmerret ndaj Kukësit, që e përcolli me bisht nën shalë! Kryeministri i narkoshtetit urdhëron ndërprerjen e energjisë elektrike për Kukësin e fshatrat përreth për hakmarrje", - shkruan Berisha, duke cituar denoncimin e një banori.

Rama në Kukës, Paloka: U ngjesh me antiplumb, por të përzunë

Nënkryetari i PD-së, Edi Paloka, deklaroi dje se kryeministri Rama gjatë vizitës në Kukës, pavarësisht se solli mijëra forca të policisë dhe u ngjesh me antiplumb, nuk arriti të përballë me qytetarët për mungesë guximi. Në reagimin e tij në "Facebook", Paloka thekson se kryeministrin Rama nuk e duan jo vetëm kukësanët, por shumica e shqiptarëve. "Nuk mund të qëndrosh më kryeministër i një populli që të urren dhe e urren. Në Kukës, edhe pse solli mijëra forca, përfshi forcat speciale, u ngjesh edhe me antiplumb dhe prapë nuk guxove të ballafaqohesh me qytetarët, por mbloodhe me detyrim administratën e deri nxënësit e shkollave me çanta në krah, për të zbrazur urretjen tënde për shqiptarët. Nuk të duan më, jo kukësanët, por shumica e shqiptarëve. Kjo, një njeri normal do ta bënte të reflektohet, por një si ty e tërbon. Ndaj, do të vazhdosh edhe pak të zbrazësh urretjen dhe arrogancën tënde ndaj qytetarëve, siç ke bërë në të gjithë Shqipërinë e dje në Kukës. Por, një gjë është e sigurt, njerëzit kanë nevojë për një qeverisje dhe një kryeministër normal, prandaj po të përzënë kudo që shkon me bisht ndër shalë. Janë qytetarët e vërtetë e normalë të këtij vendi. Asnjëri prej tyre nuk është i droguar. I vetmi i droguar në Kukës ishte ti, Edvin..."-shprehet z.Paloka.



aeroporti 'Leonardo da Vinci' në Romë - 'Fiumicino' dhe 12 herë më shumë të punësuar se aeroporti i Rinasit 'Nënë Tereza'?! Po ju vë në dispozicion edhe shifrat zyrtare në tabelat zyrtare që ndodhen në uebet e aeroportit të Romës dhe të Rinasit. I shihni vetë me nge dhe pastaj qeshni pak, por duhet të ulërin shumë, pasi idiotë dhe mashtrues të tillë ordinere, ky vend nuk ka parë ndonjëherë", shprehet z.Vasili.

ASHK nis punën, Artan Lame: Tri shtyllat kryesore të reformës për pronën

Agjencia Shtetërore të Kadastrës do të regjistrojë 220 mijë AMTP

Braçe: 96% e totalit të pronave është pa regjistruar

Ligjërimi i ndërti meve pa leje, pajisja me AMTP dhe certifikatë pronësie për tokën bujqësore dhe trajtimin e pronës dhe inventarizimin e pronave shtetërore janë tri shtyllat kryesore, ku do të mbështetë puna e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Më krimin e strukturës së re do të regjistrohen 220,000 Akte të Marrjes së Tokës në Përdorim me ligjin 7501, të cilat përfaqësojnë gjysmën e tokës së punueshme në fshat, do të pajisen me AMTP 20,000 familje, do të regjistrohen rreth 10% të banesave të para vitit 1991, ende të paregjistruara dhe do të regjistrohen rreth 160,000 prona (96% e totalit) që u kanë kaluar njërive vendore dhe që janë ende të paregjistruara. Drejtimi i institucionit që do të mbyllë procesin e legalizimit, do të mbyllë procesin e kompensimit të pronarëve, do të krijojë hartën digjitale të pronës i është besuar Artan Lames. Prezantimi i kreut të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës u bë dje nga zëvendëskryeministri Erion Braçe. "Qeveria e ka fokusin në programin e saj qeverisës rregullimin një herë e mirë të çështjes së pronës. Reforma tërësore e shërbimeve publike që lidhen me titujt e pronës së përfshin vizionin e ri për: organizimin dhe strukturimin e institucioneve përkatëse, që tashmë ndodhi; futjen e teknologjisë dhe informatizimit të shërbimit; përmirësimin dhe kompletimin e ofrimit të shërbimit ndaj qytetarit, për ta bërë atë një shërbim cilësor, profesional dhe të shpejtë", tha Braçe. Kreu i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Artan Lame,

ERION BRAÇE

"Dua të bëj apel edhe për agjencitë e tjera, apel edhe banorëve, kërkoni shërbim, mos paguani asgjë që nesër mund t'ju kthehet në të kundërt, vepër penale. Bëj apel edhe për nëpunësit, edhe për ata që mendojnë se mund ta blejnë shërbimin me para, do ta luftojmë korrupsionin".



Kreu i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Artan Lame dhe zëvendëskryeministri, Erion Braçe

ARTAN LAME

"Sot mund të themi vetëm një gjë, barra është e jashtëzakonshme, por rrugë tjetër për të mbyllur tri dekadat e kaosit pronësor, nuk ka. Zgjidhja e çështjes së pronësive vazhdon të mbetet thembra e Akilit për kohezionin ekonomik dhe social të vendit".

pohoi se tri janë reformat kryesore që do të ndërmarë ky institucion. "Reformën që do të ndërmarim, mund ta përmbledh në tri drejtime: reformë thelbësore në hartografi, reformë thelbësore në sisteme shërbimi dhe reformë thelbësore në burime njerëzore", tha Lame. Zëvendëskryeministri theksoi se Agjencia Shtetërore e Kadastrës ka rol të rëndësishëm në zgjidhjen e çështjes së pronave në Shqipëri. "Rëndësi të veçantë në këtë drejtim merr unifikimi i regjistrave në kadastrën digjitale, që përfshin gjithë hartografinë e pronës. Nevojshmëria për të rregulluar problematikën e akumuluar ndër vite dhe vizioni i qeverisë në këtë drejtim u materializuan në krijimin e këtij institucionit të ri, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Ky institucion është

TË DHËNAT MBI PRONAT NË TË GJITHË VENDIN

1. Rreth 220,000 familje që jetojnë në fshat me AMTP të paregjistruara, pra afërsisht gjysmën e tokës së punueshme në fshat.
2. Rreth 20,000 familje që nuk janë pajisur me AMTP.
3. Rreth 10% të banesave të para vitit 1991, ende të paregjistruara.
4. Rreth 160,000 prona (96% e totalit) që ju kanë kaluar njërive vendore dhe që janë ende të paregjistruara.
5. Rreth 10% të territorit të vendit, ku ende nuk ka filluar procesi i regjistrimit fillestar.

i domosdoshëm për harmonizimin e proceseve të ndryshme, të cilat deri dje kryheshin nga institucione të ndryshme dhe nuk perceptoheshin në shërbim të një funksioni të vetëm, pra në shërbim të pronës", theksoi Braçe.

Agjencia "Agjencia Shtetërore e Kadastrës do të duhet që me fillimin e veprimtarisë së saj të rrisë efikasitetin në kryerjen e proceseve që lidhen me pronën e paluajtshme, rezultat i pritshëm nga një organ i

vetëm i qendëruar. Të përmirësojë administrimin e regjistrimit publik të kadastrës, të garantojë një hartë kadastrale të saktë dhe të besueshme dhe të trajtojë e të zgjidhë përfundimisht mbivendosjet e titujve të pronë-

sisë", deklaroi zëvendëskryeministri. "Nga drejtori i ri i Kadastrës - tha Braçe - pritet drejtimi i aktivitetit të Agjencisë në zbatim të legjislacionit sipas objektivave politike të qeverisë dhe kontratës së performancës. Personalisht do të ndjek jo vetëm mbarëvajtjen e Agjencisë, por në mënyrë të veçantë mobilizimin dhe koordinimin me të gjitha institucionet ndërvepruese në këtë proces të rëndësishëm. Ky proces nuk do të ketë sukses, nëse nuk do të ketë bashkëpunim me të gjithë aktorët. Bëj një apel, bashkitë kanë marrëtribute të qenësishme, edhe për legalizimin dhe certifikimin e titujve të pronësive, janë bashkitë që duhet të çojnë procesin përpara, të jenë të interesuara që procesi të përfundojë sa më parë të jetë e mundur", deklaroi Braçe.

Marrëveshjet e ndaluara në tendera

APP dhe Autoriteti i Konkurrencës: Shkeljet që bën biznesi

Agjencia e Prokurimit Publik dhe Autoriteti i Konkurrencës kanë evidentuar disa praktika të dyshimta në drejtim të marrëveshjeve të ndaluara mes operatorëve ekonomikë për pjesëmarrjen në një garë tenderuese. Sipas tyre, në momentin e përlogaritjes së vlerës së fondit limit, operatorët ekonomikë u japin autoriteteve kontraktore oferta me vlera shumë të larta, në krahasim me ofertat që ato paraqesin në tender për këtë objekt prokurimi. Por, sipas Autoritetit të Konkurrencës, ky veprim shoqëruar me sjellje të

dyshimta të operatorëve ekonomikë gjatë pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit, si dhe pas lidhjes së kontratës mund të përbëjë një evidencë për ekzistencën e marrëveshjeve të ndaluara në oferta. Për këtë arsye, APP kërkon nga operatorët ekonomikë që të jenë më të përgjegjshëm gjatë llogaritjes së vlerës së fondit limit për një procedurë tenderuese, pasi paraqitja e ofertave me vlera

shumë të larta në momentin e testimit të tregut për përlogaritjen e fondit limit, në krahasim me ato që paraqiten në tender mund të përbëjë shkak që autoritetet kontraktore t'i drejtohen Autoritetit të Konkurrencës. Po ashtu, APP u kujton operatorëve ekonomikë se marrëveshjet e ndaluara çojnë në pengimin, kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, çka përbën dhe shkelje ligjore.

Paralajmërimi i Tatimeve: Kujdes kur kryeni transaksione me këto subjekte, sepse do të penalizoheni!

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informon se çdo tatimpagues përpara se të hyjë në një transaksion me një tatimpagues tjetër, duhet të verifikojë statusin e tij dhe të sigurohet që blerësi apo shitësi është tatimpagues me status "Aktiv" dhe mund të kryejë transaksione. Për tatimpaguesit me status "Pasiv" do të konsiderohet shkelje administrative, çdo transaksion i kryer nga tatimpaguesit, persona fizikë apo jurid-



ikë, tregtarë, të cilët në datën e kryerjes së transaksionit rezultojnë të jenë me status pasiv. Për tatimpaguesit me status "Aktiv" me përjashtim të transaksioneve të kryera nga subjekte që ushrojnë aktivitet në fushën e telekomunikacionit, shitjes

së energjisë dhe ujit për konsumatorët finalë, sigurimeve, si dhe në rastet kur janë lidhur kontrata afatgjata "leasing", do të konsiderohet shkelje administrative çdo transaksion i kryer nga tatimpaguesit aktiv, persona fizikë apo juridikë tregtarë, me tatimpagues të cilët janë me status pasiv. Të gjithë tatimpaguesit mund të konsultojnë listën e tatimpaguesve, të cilët kanë kaluar në regjistrin pasiv në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Publikohet lista me pronarët që kompensohen për truallin e zënë nga ndërtimet informale

Qeveria ka miratuar kompensimin financiar të pronarëve që preken nga ndërtimet informale. Janë në total 600 pronarë, të cilët do marrin mbi 347 milionë lekë. Përfituesit janë në Elbasan, Tiranë Veri, Tiranë Jug, Tiranë Shitesat, Durrës, Vlorë dhe Shkodër. Masa e kompensimit është 20 694,8 m² dhe vlera e përgjithshme e kompensimit financiar është 347 349 219 lekë. "Gazeta Shqiptare" publikon listën e plotë të përfituesve së bashku me shumë për çdo pronar. Për kompensimin e pronarëve përdoren po ato të ardhura që arkëtohen Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Agjencia e Trajtimit të Pronës. Pronari plotëson një

Tokat e zëna, 600 pronarë marrin 347 milionë lekë

Përfituesit në Tiranë, Elbasan, Durrës, Shkodër, Lezhë e Vlorë

kërkesë për kompensimin në vlerë sipas formatit tip, që vihet në dispozicion nga ATP-ja. I interesuari duhet të paraqesë dëshminë e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të

subjektit përfitues, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil. Për dëshmitë e trashëgimive të lëshuara nga gjykata për testamentin e bërë me akt

noterial të sillet certifikatë familjare e personit, për të cilin është lëshuar kjo dëshmi trashëgimie. Një tjetër dokument është vërtetimi i lëshuar nga banka e nivelit të dytë për hapjen e llogarisë

bankare në emër dhe për llogari të subjektit përfitues, ku përcaktohet edhe numri i llogarisë bankare ku do të transferohet vlera financiare e përfituar. Qeveria urdhëron Zyrat Vendore e

Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, përkatesisht në Elbasan, Tiranë, Durrës, Vlorë dhe Shkodër, të kryejnë ndryshimet përkatëse e pasurive të paluajtshme.

LISTA ME PRONARËT QË KOMPENSOHEN

| Sipërfaqja për kalim pronësie (m ²) | Numri i Pronarëve e qe kompensohen | Kompensimi i Pronarëve | | | Shuma - Vlera e kompensimit (lek) |
|---|------------------------------------|------------------------|-------|---------|-----------------------------------|
| | | Emër | Atësi | Mbiemër | |

| | | | | |
|-----|---------|---------|----------|------------|
| 393 | EDUART | SALI | BELIU | 400,179.00 |
| | 394 | GANI | ABDULLA | |
| | 395 | MERITA | SALI | |
| 396 | RAMAZAN | ABDULLA | BELIU | |
| 397 | DIANA | ESAT | CORAJ | |
| 398 | ZHAKLIN | ESAT | BELIU | |
| 399 | ZHENI | ARBEN | TREBICKA | |
| 400 | LEIF | ABDULLA | XHAVID | BALIU |
| 401 | MYZEJEN | ABDULLA | KAZAZI | |

| | | | | |
|-----|----------|--|----------|------------|
| 402 | ADNAN | | DIBRA | 415,570.50 |
| 403 | ARTAN | | DIBRA | |
| 404 | ASTRIT | | TOPTANI | |
| 405 | BIBIKA | | STAROVA | |
| 406 | BONIN | | TOPTANI | |
| 407 | DASHURI | | DIBRA | |
| 408 | DRITA | | BOBRATI | |
| 409 | ELDA | | KONOMI | |
| 410 | ELISABET | | TOPTANI | |
| 411 | FUAT | | LIBOHOVA | |
| 412 | GAZMEND | | DIBRA | |
| 413 | GENCI | | DIBRA | |
| 414 | HIRMA | | DIBRA | |
| 415 | ILIR | | DIBRA | |
| 416 | KADRI | | LIBOHOVA | |
| 417 | LIMANE | | ORGOCKA | |
| 418 | LUAN | | DIBRA | |
| 419 | LULZIM | | TOPTANI | |
| 420 | MELI | | KELLICI | |
| 421 | NASIBE | | QOSE | |
| 422 | NERMIN | | DIZDARI | |
| 423 | RAHMI | | GORALIU | |
| 424 | TEFTA | | BABAMETO | |
| 425 | VERA | | HAKIU | |
| 426 | XHIMI | | DIBRA | |

| | | | | |
|-----|---------|-------|-----------------|--------------|
| 427 | ESAT | FEVRI | PAZARI | 1,674,595.20 |
| 428 | VIOLETA | FEVRI | KAZAZI (PAZARI) | |

| | | | | |
|-----|---------|-------|---------|------------|
| 430 | ATLJUE | | YLLI | 116,975.40 |
| | BILAL | | BOGDANI | |
| | DIANA | BEQIR | BIBA | |
| 431 | ELDA | RAKIP | BOGDANI | |
| | ELVI | AGRON | BOGDANI | |
| 432 | ENIDA | | BOGDANI | |
| | FATMR | | BOGDANI | |
| | RAMAZAN | | BOGDANI | |
| | RESHAT | | BOGDANI | |
| | SAIMR | KADRI | BIBA | |

| Sipërfaqja për kalim pronësie (m ²) | Numri i Pronarëve e qe kompensohen | Kompensimi i Pronarëve | | | Shuma - Vlera e kompensimit (lek) |
|---|------------------------------------|------------------------|-------|---------|-----------------------------------|
| | | Emër | Atësi | Mbiemër | |

| | | | | |
|-----|----------|---------|----------|--------------|
| 432 | RESHAT | | BOGDANI | 1,169,975.40 |
| | SAIMR | KADRI | BIBA | |
| | ENIDA | | BOGDANI | |
| | ELDA | RAKIP | BOGDANI | |
| | ELM | AGRON | BOGDANI | |
| 433 | ATLJUE | | YLLI | 1,095,874.80 |
| | BILAL | | BOGDANI | |
| | DIANA | BEQIR | BIBA | |
| | FATMR | | BOGDANI | |
| | RAMAZAN | | BOGDANI | |
| 434 | RESHAT | | BOGDANI | 1,849,014.09 |
| | SAIMR | KADRI | BIBA | |
| | 435 | DESHIRA | GREVA | |
| | 436 | HAJDAR | ZELA | |
| 437 | QEFISERE | RUSHEKU | | |
| 438 | VJOLLCA | VOKSHI | | |
| 439 | XHEVRUJE | | KATROSHI | |

| | | | | |
|-----|---------|--|----------|------------|
| 440 | ADILE | | JAHO | 232,234.40 |
| 441 | AGIM | | JAHO | |
| 442 | EDMOND | | JAHO | |
| 443 | FATMIRA | | JAHO | |
| 444 | GEZM | | JAHO | |
| 445 | INDRIT | | JAHO | |
| 446 | MUHAZES | | JAHO | |
| 447 | NEXHMUE | | JAHO | |
| 448 | MIMI | | JAHO | |
| 449 | AGRON | | SKENDERI | |

| | | | | |
|-----|---------|--|-----------|--------------|
| 450 | BASHKIM | | PINARI V. | 2,516,728.50 |
| 451 | BASHKIM | | KACA | |
| 452 | EDMOND | | MEMA | |
| 453 | JALLDIZ | | MEMA | |
| 454 | LULZIM | | KACA | |
| 455 | RITA | | MEMA | |
| 456 | YLLI | | MEMA | |

| | | | | |
|-----|---------|-------|-----------|--------------|
| 457 | MURAT | IHSAN | PODGORICA | 1,613,952.69 |
| 458 | SILVANA | IHSAN | PODGORICA | |
| 459 | TAULANT | IHSAN | PODGORICA | |
| 460 | XHEVDET | OAZIM | LIBOHOVA | |

| | | | | |
|-----|---------|-------|-------|------------|
| 461 | BRIGITA | | XHEPA | 138,238.12 |
| 462 | KURT | OAZIM | XHEPA | |

| Sipërfaqja për kalim pronësie (m ²) | Numri i Pronarëve e qe kompensohen | Kompensimi i Pronarëve | | | Shuma - Vlera e kompensimit (lek) |
|---|------------------------------------|------------------------|-------|---------|-----------------------------------|
| | | Emër | Atësi | Mbiemër | |

| | | | | |
|-----|---------|--|--------|------------|
| 463 | ARIANA | | PILIKA | 632,115.00 |
| 464 | TAKUINA | | ADAMI | |
| 465 | ARIANA | | PILIKA | |
| 466 | TAKUINA | | ADAMI | |

| | | | | |
|-----|--------|-----|-------|--------------|
| 467 | ISMAIL | ALI | GJINI | 5,748,640.00 |
| 468 | ISMAIL | ALI | GJINI | 4,712,000.00 |

| | | | | |
|-----|------------------|--|---------|--------------|
| 469 | DHURATA | | KALTANI | 2,881,064.00 |
| 470 | HADIJE | | OSMANI | |
| 471 | ISMETE | | KALTANI | |
| 472 | ALMA | | GJELI | |
| 473 | BUJAR | | OSMANI | |
| 474 | BURBUQ | | ARUCI | |
| 475 | ELMIRA | | HAJDARI | |
| 476 | MUHAME | | OSMANI | |
| 477 | HEKTOR | | OSMANI | |
| 478 | HELIDON | | OSMANI | |
| 479 | NADIRE | | OSMANI | |
| 480 | ALMA | | GJELI | |
| 481 | BUJAR | | OSMANI | |
| 482 | BURBUQ | | ARUCI | |
| 483 | ELMIRA | | HAJDARI | |
| 484 | MUHAME | | OSMANI | |
| 485 | HEKTOR | | OSMANI | |
| 486 | HELIDON | | OSMANI | |
| 487 | NADIRE | | OSMANI | |
| 488 | FONDI BESA S.H.A | | | 986,136.00 |
| 489 | ERALD | | BERHOMI | 96,680.00 |
| 490 | AISHE | | ARAPI | 754,104.00 |
| 491 | BURHAN | | ARAPI | |
| 492 | DHURATA | | ARAPI | |
| 493 | KADRI | | ARAPI | |
| 494 | LEJLA | | ARAPI | |
| 495 | SAIMR | | ARAPI | |

| | | | | |
|-----|---------|--|-----------|---------------|
| 496 | LEFFERI | | SHKURTI | 10,808,824.00 |
| 497 | EVALDA | | CHIARELLA | 3,963,880.00 |
| 498 | EVALDA | | CHIARELLA | 773,440.00 |
| 499 | EVALDA | | CHIARELLA | 328,712.00 |
| 500 | EVALDA | | CHIARELLA | 38,672.00 |
| 501 | EVALDA | | CHIARELLA | 2,823,056.00 |
| 502 | EVALDA | | CHIARELLA | 290,040.00 |
| 503 | EVALDA | | CHIARELLA | 4,853,336.00 |
| 504 | EVALDA | | CHIARELLA | 1,121,488.00 |
| 505 | EVALDA | | CHIARELLA | 19,336.00 |
| 506 | EVALDA | | CHIARELLA | 464,064.00 |
| 507 | EVALDA | | CHIARELLA | 4,892,008.00 |
| 508 | EVALDA | | CHIARELLA | 599,416.00 |
| 509 | EVALDA | | CHIARELLA | 870,120.00 |
| 510 | EVALDA | | CHIARELLA | 58,008.00 |
| 511 | EVALDA | | CHIARELLA | 386,720.00 |
| 512 | EVALDA | | CHIARELLA | 38,672.00 |

Bashkëshortja: Natën e lë burrin vetëm, i shërbej një plake për të mbijetuar


Babai i 3 fëmijëve i vë flakën vetes: Nuk kemi bukë të hamë, doja të vdisja

Xhevahir Xhozi: Jam i sëmurë prej shumë vitesh, nuk marr përkrahje ekonomike dhe as Kemp

ENEIDA PETOVA

BERAT

Një 63-vjeçar nga lagja "Çelepias" në qytetin e Beratit ka tentuar t'i japë fund jetës duke i vënë flakën vetes, pasi është lyer me benzinë. Ngjarja e rëndë ka ndodhur në lulishten e lagjes ku ai banon dhe kanë qenë kalimtarët, të cilët kanë njoftuar patrullën më të afërt të policisë, që e kanë transportuar me urgjencë në Spitalin Rajonal të Beratit. Pasi ka marrë mjekimin në Kirurgjinë e Beratit, 63-vjeçari ndodhet aktualisht i shtruar në dhomën nr.5 të këtij reparti. Mjekët kirurgë deklaruan dje për "Gazeta Shqiptare" se i moshuari ka djegie të shkallës së dytë në të gjithë pjesën e poshtme të trupit. Bashkëshortët Xhevahir dhe Zhaneta Gjozi treguan se shkak për këtë ngjarje janë kushtet e vështira



Xhevahir Gjozi në spitalin e Beratit



Zhaneta Gjozi fuke folur për "GSH"

ekonomike, në të cilat ata jetojnë. Xhevahir Gjozi u shpreh se nuk e do më jetën për shkak se nuk kanë bukë të hanë. Pavarësisht versionit të dhënë prej tij, dyshohet se ai ka edhe probleme të tjera. 63-vjeçari pohoi se kjo gjendje e rënduar vazhdon prej shumë vitesh dhe ai është i sëmurë e nuk merr as pension e as Kemp. Bashkëshortja e tij, Zhaneta Gjozi tha se Xhevairi është i sëmurë dhe nuk merr asnjë Kemp nga shteti. Ajo pohoi

se prej shumë vitesh kujdeset për të e vetme dhe se ka kërkuar disa herë ndihmë nga shteti për ta shtruar në qendra të specializuara për kujdesin e tij. Ajo i bëri apel shtetit që t'i lidhë një pension ose Kemp, pasi të dy bashkëshortët nuk kanë asnjë të ardhur ekonomike për të jetuar. Në këto kushte Zhaneta, për të siguruar pak të ardhura për t'u ushqyer, largohet natën nga banesa për t'u kujdesur disa herë në javë për një plak të

ndërsa sot tentoi të vetëdigjej", tha Zhaneta Gjozi. Ndërsa, bashkëshorti i saj deklaroi në një intervistë për "GSH" se gjithçka e ka bërë nga kushte e këqija ekonomike. Përse tentove të vetëvritesh? Çfarë të bësh tjetër kur je i sëmurë dhe i papunë? Kur s'ke çfarë të bën, dot të tentosh të vrasësh veten siç bëra sot. Ky është kapitalizmi. Është e vështirë, nuk është e lehtë në kapitalizëm.

Je i dhunshëm? Jo, jo. Po me bashkëshortin? Jo. Me gruan kam 40 vjet martesë dhe kam 3 kalamaj me të. Popëse mendon se vdekja do të të shpëtojë? Vdekja do të bëjë punën e saj. Thashë se jam në hall të madh dhe nuk kam zgjidhje. Cili është apeli juaj ndaj shtetit? Ashtu siç tha dhe gruaja ime, kërkoj që shteti të më lidh pension ose Kemp, ose të më japë përkrahje ekonomike që të mbajmë shpirtin gjallë.

SHKURT

Lirohet i "infiltruari" në protestën e opozitës

TIRANË - Gjykata e Tiranës ka liruar dje nga ambientet e paraburgimit Olsi Albajramajn, i cili u arrestua paraditen e së mërkurës në protestën e opozitës. Albajrami do të hetohet në gjendje të lirë, pasi akuzohet për dhunë dhe kundërshtim të punonjësve të policisë. Ditën e protestës, 29-vjeçari u dhunua nga protestuesit, pasi mbante në kokë një kapuç dhe ata pretendonin se ai ishte efektiv policie i infiltruar mes tyre.

Gjendet e vetëvarur në banesë, 86-vjeçarja

ELBASAN - Policia e Elbasanit njofton se një 86-vjeçare është vetëflijuar në banesën e saj në lagjen "Beqir Dardha". E moshuara u gjet pa shenja jete nga fqinjët. Nga këqyrja paraprake e kryer nga mjeku-ligjor nuk janë konstatuar shenja dhune. Grupi hetimor ndodhet në vendngjarje dhe po punon për sqarimin e rrethanave të ngjarjes.

Shkatërrohet grupi i trafikut të drogës, në pranga edhe shqiptarë

ITALI - Policia italiane shkatërroi dje një grup kriminal të trafikut të drogës që vepronte në Citadela të Italisë. Grupi funksiononte në këtë zonë dhe shpërndante lëndë narkotike për përdoruesit. Pas një hetimi të gjatë të filluar në vitin 2016, pesë persona, italianë dhe shqiptarë, përfunduan në burg ose në arrest shtëpiak. Shtëpitë e bashkëpunëtorëve të dyshuar u kontrolluan në provincat e Padovës dhe Trevisos. Furnizuesi kryesor ishte një banor 40-vjeçar shqiptar në Tribano, i prezantuar si shitës i makinave të përdorura, por në të vërtetë një trafikant i njohur në botën e drogës. Ai ishte furnizuar nga një bashkatdhetar 36-vjeçar nga Piombino Dese. Shqiptari ishte tregtari referent i drogës për dhjetëra konsumatorë, të cilët gjithashtu dolën nga jashtë provincës për të

OPERACIONI

TË ARESTUARIT

Artur Hysa 40 vjeç, shtetas shqiptar, rezident në Tribano.

Mirjan Ndrepepaj 36 vjeç, shtetas shqiptar, me banim në Piombino Dese.

Xhuli Gjeloşi 28 vjeç shtetas shqiptar me banim në Piombino Dese (PD).

NË PARABURGIM

Antonio Balo 57 vjeç, me banim në Loreggia.

Denis Gregoriani 50 vjeç, banor i Piombino Dese. Ndërsa njëri u la në arrest shtëpiak.

marrë doza. Ai punësoi tre të dyshuar të tjerë: një 28-vjeçar shqiptar nga Piombino Dese dhe dy Paduan 50 dhe 57 vjeç banorë të Piombino dhe Resana. Nga 5 të ar-

restuarit, 3 shqiptarë janë në burg. Operacioni çoi në arrestimin e 5 personave dhe sekuestrimin e një sasi të madhe droge: 1 kg marijuanë dhe 225 gr kokainë.



Përdhunonte gruan në sy të fëmijëve, shqiptari rrezikon burgun

ITALI - Një histori abuzimesh, e cila mori fund me masën paraprake të nënshkruar nga gjyqtari hetues i gjykatës në Imperia, i cili e ndaloi shqiptarit t'i afrohej gruas dhe fëmijëve, ndërkohë që hetohet që po gjendje të lirë. E gjithë historia nisi me denoncimin e ish-gruas të dëshpëruar, e cila u drejtua policisë, duke iu kërkuar t'i jepnin fund asaj që ishte shndërruar në një makt për të. Në fakt, bashkëshorti, me të cilin ishte në një proces ndarjeje të trazuar për shkak të sjelljes së tij të dhunshme, herë pas herë shkonte në shtëpinë e gruas për të takuar fëmijët. Por, nuk mjaftonte vetëm që e detyronte me kërcënime dhe dhunë të kryente marrëdhënie seksuale, por fëmija duhet të ishte i pranishëm në akt dhe kjo ishte rrethana më e rëndë e gjithë ngjarjes. Seksioni i Departamentit të Prokurorisë së Imperias, paraditen e djeshme i dha fund kësaj historie të shëmtuar; duke i ndaluar shqiptarit afrimin ndaj ish-gruas dhe fëmijëve. Nëse ish-burri nuk pajtohet me ndalimin, ai do të vihet në pranga.

Zbulohen 100 predha artilerie në Bradashesh

ELBASAN - Efektivët e EOD të batalionit xhenier të Komandës Mbështetëse në FA kanë zhvilluar një operacion për zbulimin e predhëve dhe municioneve në Bradashesh, të Elbasanit. Mësohet se gjatë operacionit janë zbuluar rreth 100 predha artilerie. Lajmi bëhet i ditur nga Ministria e Mbrojtjes. Predhat janë transportuar për në poligon ku edhe do asgjësohen. Mësohet se predhat u konstatuan në afërsi të lumit, ndërsa kërkesa për ndërhyrje u bë nga prefekti i Elbasanit. Mendohet që predhat e artilerisë, rreth 85 mm, i përkasin vitit 1997. Në operacion assistuan edhe efektivët të Policisë së Shtetit.



Vrasjet në Shkodër, Hodaj: Ja pistat ku është përqendruar policia

TIRANË - Në emisionin "Kjo javë" në "News 24", zv.ministri i Brendshëm, Julian Hodaj komentoi situatën e rendit e sigurisë në vend. Hodaj tha se ka një mobilizim të Policisë së Shtetit, ndërsa solli në vëmendje zëvendësimin e strukturave drejtuese të policisë. "Ajo që ndodhi në Shkodër, nuk është produkt as

i një dite as i një nate. Është fryt i asaj që është mbarsur në këto 25 apo 30 vjet. Pra, është një situatë e mbartur, sepse nuk lindën as sot as dje grupet kriminale, kanë qenë aty dhe kanë operuar në terren. Kjo që ndodhi janë episode të luftës ndërmjet dhe kjo është pista që besoj unë policia po ndjek, të luftës mes grupeve të ndryshme që

kanë çuar në këtë lloj rezultati. Gjithsesi, policia është e angazhuar fort, po mbështetet edhe nga Ministria e Brendshme dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese dhe besoj shumë shpejt do ketë rezultate në këtë drejtim", u shpreh Hodaj. "Shkodra është një nga qytetet ku ishte përqendruar edhe vëmendja e forcës së ligjit, por nuk

ishte i vetmi. Në shumë operacione e keni parë që edhe lidhjet ndërmjet qyteteve janë goxha të afërta. 'Volvo 4' kishte shumë njerëz, por të shtrirë në 4-5 qytete. Shkodra ka qenë ndër qytetet që mbetet gjithmonë problematike, mbetet në vëmendje të Policisë së Shtetit, por kjo nuk do të thotë se vëmendja është hequr nga qytete të tjera", theksoi zv.ministri i Brendshëm.

Në 2017-ën u shembën konstruksionet e 3 kateve të fundit të ndërtesës në breg të detit

DURRËS

Drejtori dhe disa specialistë të Institutit të Ndërtimit në Tiranë janë kërcënuar nga dy persona në emër të pronarit të pallatit 28-katësh të Shkëmbi i Kavajës në Durrës, Enver Shala. Burime pranë këtij institucioni bënë me dije se kërcënimi i inxhinierëve u bë pas një studimi, që ky institut bëri me kërkesë të Prokurorisë së Durrësit, për këtë ndërtesë të lartë në breg të detit Adriatik. Mësohet se kërkimet

6-mujore të institutit në fjalë dolën në përfundimin se ndërtimi është i paqëndrueshëm dhe se kërkohen ndërhyrje emergjente, siç mund të jetë heqja e disa kateve apo përforcimi i strukturave. Ndërkaq, burime nga Instituti i Ndërtimit thanë për "News 24" dhe "Gazeta Shqiptare" se nuk është ky institucion që merr vendim për prishjen e një objekti. Instituti ka kompetencë vetëm studimin e ndërtesave dhe nxjerrjen e konkluzioneve mbi strukturat e tyre. Megjithatë, kjo nuk e ka penguar pronarin e godinës në breg të detit që të kërcënojë inxhinierët, të cilët kanë bërë denoncim në policinë e Tiranës.

PALLATI SHUMËKATËSH

Historia e ndërtesës 28-katëshe të Shkëmbi i Kavajës nuk është e re. Në vitin 2017 konstruksionet e 3 kateve të fundit shtesë u shembën, duke rrezikuar jetën e punëtorëve dhe të banorëve. Në atë kohë, biznesmeni Enver Shala u ndalua nga policia e Durrësit dhe u

Pallati 28-katësh te Shkëmbi i Kavajës i paqëndrueshëm, pronari kërcënon inxhinierët

Instituti i Ndërtimit: Konkluzioni për objektin, pas një studimi 6-mujor

HETIMI

Në vitin 2017 konstruksionet e 3 kateve të fundit shtesë u shembën, duke rrezikuar jetën e punëtorëve dhe të banorëve. Në atë kohë, biznesmeni Enver Shala u ndalua nga policia e Durrësit dhe u gjendje të lirë për shkatërrim të pronës nga pakujdesia dhe shkelje të rregullave të mbrojtjes në punë. Të njëjtit pronar, në vitin 2013 i është prishur edhe kompleksi "Kamelia" në Durrës.



Pallati 28-katësh te Shkëmbi i Kavajës

DENONCIMI

Burime nga Instituti i Ndërtimit thanë për "News 24" dhe "Gazeta Shqiptare" se nuk është ky institucion, që merr vendim për prishjen e një objekti. Instituti ka kompetencë vetëm studimin e ndërtesave dhe nxjerrjen e konkluzioneve mbi strukturat e tyre. Megjithatë, kjo nuk e ka penguar pronarin e godinës në breg të detit që të kërcënojë inxhinierët, të cilët kanë bërë denoncim në policinë e Tiranës.

bën, duke rrezikuar jetën e punëtorëve dhe të banorëve. Në atë kohë, biznesmeni Enver Shala u ndalua nga policia e Durrësit dhe u

hetua në gjendje të lirë për shkatërrim të pronës nga pakujdesia dhe shkelje të rregullave të mbrojtjes në punë. Të njëjtit pronar, në

vitin 2013 i është prishur edhe kompleksi "Kamelia" në Durrës. Ai po ashtu është ndërtuesi i një tjetër pallati gati 30-katësh në afërsi

të Portit të Durrësit, ku 8 kate shtesë janë pa leje. Disa herë janë ndërmarrë iniciativa nga autoritetet lokale dhe qendrore për të ndë-

rhyrë në shtesat e kateve që ka bërë ky sipërmarrës në objektet e ndërtuara prej tij, por në asnjë rast nuk është vepruar.

Prokurori shkodran, kandidat edhe në listën e SPAK

Vendi vakant në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Vate Staka kandidat i vetëm

TIRANË - Prokurori i Shkodrës, Vate Staka, është vetëm një hap larg karrigës se anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Institucioni i ri, i ngritur në kuadër të reformës në drejtësi, që konsiderohet si "qeveria" e prokurorëve funksionon me vetëm 10 anëtarë, që pas shkarkimit të Antoneta Sevdarit nga Kolegji i Posaçëm të Apelit. Menjëherë pas këtij vendimi, kryeprokurorja e përkohshme hap garën

dhe ftoi të gjithë prokurorët e interesuar të garonin për vendin vakant në Këshill. I vetmi që paraqiti kandidaturën brenda afatit ligjor dyjavor ishte Vate Staka, i cili gjatë garës së parë nuk i bindi dot kolegët prokurorë t'i jepnin besimin për t'i përfaqësuar në Këshill, ndonëse e ka kaluar me sukses testin e vetingut. Në kushtet kur i vetmi kandidat është i vetuar, prokurorja e

përgjithshme e përkohshme pritet të thërrasë mbledhjen e prokurorëve për ta votuar Stakën. Çka do të thotë që automatikisht, prokurori i Shkodrës do të jetë anëtar i Këshillit. E kundërta mund të ndodhë vetëm nëse dësh-ton mbledhja e prokurorëve, për shkak të mosarritjes së kuorumit. Burimet zyrtare pranë institucionit qendror të akuzës thanë për "News

24" se po diskutohet që mbledhja të zhvillohet me datë 11 prill e për këtë pritet vetëm urdhri i firmosur nga Arta Marku. Nëse Staka zgjidhet në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, atëherë reduktohet në 24, lista me kandidatët potenciale për Prokurorinë e Posaçme. Të premtën Këshilli i Lartë i Prokurorisë miratoi listën me 25 kandidatët për SPAK dhe ua dërgoi institu-



Prokurori i Shkodrës, Vate Staka

cioneve të vetingut për t'i rivlerësuar me përparësi sikurse parashikohet në ligj. Në dokumentet e tyre emri i kan-

didatit Vate Staka, i cili njëherazi aspiron vendin vakant të qeverisë së prokurorëve.

"Ambient i magjishëm europian, i realizuar nëpërmjet rregullave të qarta të biznesit"

"Prestige Resort" destinacion turistik, ministri Blendi Klosi: Ambient europian

Durrës

Prestige Resort" ishte një nga më të preferuarit në sezonin e kaluar turistik dhe tashmë është shndërruar në një destinacion, që ofron turizëm jo vetëm në verë, por në 12 muajt e vitit. Kështu e ka cilësuar ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi, hotelin prestigjioz buzë detit Adriatik në Golem, i cili është bërë i dashur jo vetëm për turistët vendës, por edhe ata të huaj. Klosi tha se ky resort me peizazhin e bukur, kushtet komode dhe shërbimin që ofron, pritet të tërheqë këtë vit shumë turistë të huaj, të cilët do të japin impaktin e tyre edhe në ekonominë shqiptare. "Një nga surprizat e vitit të kaluar për turizmin shqiptar ka qenë hapja e resortit 'Prestige', i cili ofroi mundësinë reale për t'u afruar operatorëve të huaj dhe mijëra turistëve. Një ambient të magjishëm, europian të realizuar nëpërmjet rregullave



të qarta të biznesit të turizmit dhe po ashtu, një pikë turistike e cila është në bregun e detit, por krijon mundësinë e një biznesi 2-mujor. Besoj që këtë vit 'Prestige' do të afrohet për turizmin shqiptar, si padyshim një nga pikat më të bukura, më të mirorgani-zuara dhe ku realisht prezenca e turistëve të huaj do të

thotë ekonomi", - u shpreh Klosi. Ministri Klosi mori pjesë në Panairin Ndërkombëtar të Turizmit, ku ftoi operatorët e ndryshëm turistikë të vizitoni Shqipërinë dhe i njohu ata me diversifikimin e ofertës turistike dhe lançimin e festave lokale. "Ju ftojme të vizitoni një vend që të afrojnë një natyrë

të mrekullueshme. Një vend që të ofron një kombinim perfekt të bukurisë detit, natyrës, trashëgimisë kulturore", - theksoi Klosi. Edhe ministria e Kulturës, Elva Margariti, prezantoi përpara operatorëve turistikë nga shumë vende të botës, atraksionin kulturor që ofron Shqipëria.



Aksidenti, makina përfundon përmbys në mes të qytetit

SHKODËR - Një aksidenti i rëndë automobilistik që ka përfunduar fatmirësisht pa njerëz të lënduar ka ndodhur djeg në qytetin e Shkodrës. Ngjarja ndodhi në afërsi të poliklinikës së specialiteteve, rreth orës 12.50. Mësohet se një makinë ka ardhur me shpejtësi nga qendra e qytetit në drejtim të poliklinikës. Në një parking aty afër, një mjet tjetër ka qenë duke dalë. Ka mjaftuar një përplasje e vogël që mjeti tip "Volkswagen" të fluturojë në ajër dhe të përfundojë disa metra më tutje. Sipas bluve, si pasojë e këtij aksidenti nuk ka të dëmtuar në njerëz, por vetëm disa lëndime të lehta që ka pësuar drejtuesi i makinës, e cila u përmbys pas përplasjes. Shoferi është dërguar në spitalin rajonal të Shkodrës, ku dhe ka marrë ndihmën e stafit mjekësor. Sipas bluzave të bardha të këtij qyteti, i plagosuri nuk ka asnjë rrezik për jetën. Menjëherë në vendngjarje ka mbërritur policia vendore e Shkodrës, e cila ka nisur hetimet. Gjithashtu, mësohet se si pasojë e përmbysjes së automjetit është bllokuar për pak kohë rruga që të çon drejt poliklinikës nga ana e policisë, duke mos lejuar qarkullimin. Ky aksident mund të kishte rezultuar edhe fatal, duke qenë se ai aks në atë orë është tejet i frekuentuar nga lëvizja e këmbësorëve, por ka kaluar pa pasojë. Aksidenti si në ndonjë skenë të "Fast&Furious" ka mbledhur shumë kureshtarë rreth e rrotull, duke bërë supozime për çfarë kishte ndodhur. Policia gjithashtu ka kryer veprimet procedurale e hetimore në vendin e ngjarjes. Dyshohet se shkak për aksidentin ka qenë shpejtësia tej normave të lejuara.

ARRSH: Nënkalimi është ndërtuar, askush nuk është i izoluar

"Projekti për 'By-Pass'-in na bllokoi rrugën" 36 familje në Mbrostar hidhen në protestë

FIER - 36 familje të fshatit Mbrostar kanë dalë djeg në protestë kundër projektit që çon në bllokimin e rrugës për në banesat e tyre. Sipas banorëve, "By-Pass"-i bllokoi rrugën dhe nuk lejon kalimin as të zjarrfikësve apo autoambulancave. Ata u mbledhën në vendin ku "By-Pass"-i i Fierit izoloi plotësisht rrugën e tyre gati 100-veçare me aksin kryesor Lushnje-Fier. Disa prej banorëve pohuan se nuk lëvizin dot për të kryer punët e përditshme. "Kjo është e vetmja rrugë, nuk ka rrugë tjetër. Nuk kalon asnjë makinë apo ambulancë. Kemi bërë shumë ankese, por nuk na është dhënë zgjidhje", u shprehën banorët të revoltuar. Ndërkohë, ata paralajmëruan se do të përkallë-zojmë protestat deri në bllokimin e rrugës, nëse nuk do të merrret zgjidhje për problemin e tyre. Në mbështetje të protestuesve ka qenë



Protesta e djeshme në Mbrostar

edhe kryetari i PD-së në Fier, Luan Baçi. Baçi tha se, "do të jemi krah banorëve në këtë të drejtë që iu takon. Banorët janë bllokuar dhe po ndeshin me veshin e shurdhër të qeverisë. Do t'i mbështesim në çdo hap, edhe nëse bllokoi aksin nacional", deklaroi Baçi. Ndërkaq, Autoriteti Rrugor Shqiptar ka re-

aguar lidhur me problematikën e ngritur ditën e sotme, arsye për të cilën banorët të lagjes Mbrostar-Ura protestuan. Ai sqaron se pranë kilometrit të parë ku po ndërtohet ky "By-Pass" është tashmë i ndërtuar një nënkalin dhe se ndërtimi i tij ndërpret vetëm një nga daljet në rrugën kombëtare, ndërkohë



që dalja tjetër është funksionale. **NJOFTIMI I PLOTË I ARRSH** Lidhur me problematikën e ngritur sot në media, ku u pasqyrua se në lagjen

Mbrostar-Ura disa banorë izolohen nga ndërtimi i "By-Pass"-it Fier informojmë të gjithë të interesuarit se pranë km. 1 të këtij projekti dhe pikërisht në lagjen "Mbrostar", nënkalin tashmë i ndërtuar sipas projektit të miratuar, është funksional dhe në përdorim të banorëve (jo më shumë se 10 banesa) të cilët më parë kanë pasur akses në dy dalje me rrugën kombëtare Lushnje-Fier nëpërmjet aksesit me rrugë të shtruar me çakëll. Aktualisht ndërtimi i "By-Pass"-it

Fier ndërpret vetëm një nga daljet në rrugën kombëtare, ndërkohë që dalja tjetër është funksionale. ARRSH dhe kontraktorët janë duke studiuar mundësinë për të bërë edhe një raketim në pjesën që është ndërprerë nga projekti, por për shkak të kthesës dhe diferencës në nivel të rrugës nuk garantohej siguria maksimale për mjetet. Dëshirojmë të ritheksujmë se aktualisht të gjithë banorët kanë akses në rrugën kombëtare dhe askush nuk është i izoluar.

Njoftim për shitje me ankand të parë
 Shoqëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k ka shpallur në datë 28.03.2019 ankandin e parë të pasurisë të palës debitore Sh" Meat Master Vilezerit Kimca" sh.p.k dhe e palës dorezane, e përbërë nga:
 " Njësi" me numër pasurie 7/80 ND a ndodhur në Rr: "M Bicikemi" Shkodër e regjistruar në ZK 8593 Regji Hipotekor në 03 datë 30.10.1988 volum 17, faqe 149 me sipërfaqe 42.75 m². Ankandi i pasurisë fillon me gimin fillastar në masën 45. 517. 3 Euro detyzë e pesë mijë e pesëqind e shtatëmbëdhjetë pikë tre Euro)
 Ankandi do të zhvillohet në datë 15.04.2019 ora 15:00 në sallinë Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr.5 Kontakti tel. 0672082543, ilir.dervishaj@yahoo.com, WEB www.powerjustice-al.com


Shoqëria permbarimore JUSTITIA shpall ankandin, faza e parë, për shitjen e pasurisë së palaujtshme për të cilën ka vene hipoteke ALPHA BANK, me këto të dhëna:
 Apartament me nr.pas.7/21+1-4, z.k.8360, vol.26, fq. 204, me sip 138.40 m², Rruga "Zenei Baboc" Tiranë, në pronësi të z.Gentian Kujtim TOSKU.
 Në vlerën 124.000 Euro (njëqind e njëzetë e katër mijë e gjashtë eur).
 Ankandi zhvillohet në datën 23.04.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përbaruesit gjyqësor me adresë Bulevardi"Baïram Curri", Pall. 21,Shk. 3, Ap. 18, Tiranë.

DOSSIER
PËRVJETORI

Dritëro Agolli

Me Endri Kekon,
njeriun dhe artistinNë tridhjetëvjetorin e ndarjes nga jeta të
kinoregjisorit Endri Keko

Tridhjetë vjet më parë, më 8 Prill 1989 u nda nga jeta regjisori Endri Keko, "Artist i Popullit", duke lënë mes nesh emrin e mirë si njeri dhe artist. Regjisori i parë i ekranit shqiptar, kinodokumentaristi, Endri Keko, e nisi punën si regjisor qysh në fillim të viteve '50, kur ende ishte student në Moskë. Më pas, më 10 korrik 1952, ditën e inaugurimit të Kinostudios "Shqipëria e Re", duke firmosur në kinostudio në parë si regjisor i tij, një realizim dhe prodhim ky tërësisht shqiptar, ai firmosi edhe rrugëtimin e gjatë më 14 maj 1979, kur u largua për fundimisht nga krijimtaria dhe vendosi kurrin e 338 në raftet e filmarkivit. Endri Keko realizoi dhjetëra filmadokumentarë, ndër më të suksesshmit për atmosferën, këndvështrimin dhe nivelin artistik. "Shqipëria", "Pranvera e nëntë", "Në shtigjet malore", "Letër nga fshati", "Dritë mbi Shqipëri", "Vallëzim i shqipeve", "Ringjallje", "Në flakë të revolucionit", "Rruga jote, shok", "Punë të mbarë, shokë", "Tregim në shtëpi e nënës" janë vetëm disa nga titujt e realizimeve, që mbajnë firmën e regjisorit, i cili lëvroi me sukses të gjitha zhanret e saj, që nga filmi kronikal, kinoreportazhi e kinopoeama deri të filmi dokumentar e ai artistik dhe ku fiksoi në ekran jetën e shqiptarëve në të katërta anët e vendit, njerëzit që me shembullin e tyre udhëhiqnin rindërtimin dhe më pas ndërtimin e vendit, intelektualët e spikaturit që i bënë ndër vendit, ngjarjet madhore të Shqipërisë... Me krijimtarinë e tij në harkun kohor të viteve 1952-1979, regjisori Endri Keko ishte padyshim firma e parë e filmi dokumentar shqiptar, personaliteti më i spikatur i kësaj gjinie dhe më i vlerësuar. Fitues i Kupës për filmin më të mirë dokumentar në Festivalin e dytë të Filmit Shqiptar (1977) dhe Festivalin e tretë të Filmit Shqiptar (1979), fitues i çmimit të Nderit në Festivalin e Karlovivarit (Cekosllovakia - 1952), Diplomës së Nderit në Festivalin e Moskës (BRSS - 1959), Medaljes së Bronzit në Festivalin e Parisit (Francë - 1962) dhe Diplomës së Nderit në Festivalin e Lajpsigut (DDR - 1962), fitues i Çmimit të Republikës për filmat dokumentarë "Dritë mbi Shqipëri" (1959), "Në flakë të revolucionit" (1970) dhe "Lumja ti, moj Shqipëri" (1979), fitues i shumë çmimeve në konkurset letrare për skenarë filmash. Endri Keko vazhdon të konsiderohet edhe sot një nga personalitetet më të spikatura të kinematografisë shqiptare. Vepra e tij për gati tri dekada që shquhet për nivelin e lartë artistik e që me të drejtë vlerësohet dhe konsiderohet si një pasuri e çmuar, i bën ndër kinemasë shqiptare, ndërkohe që emri i tij mbetet në memorie si një ndër themeluesit e kinematografisë shqiptare, ndër më të spikaturit e atyre njerëzve, të cilët me përkushtim i shërbyen shoqërisë dhe ndër më të respektuarit, pasi dhjetëra kineastë të rinj kanë pasur si udhërrëfyes në krijimtarinë e tyre mjeshtrinë e sh-



Endri Keko, 1987

kollës së regjisorit Endri Keko. Me këtë rast dhe në nderim të veprës dhe emrit të regjisorit të shquar të kinematografisë shqiptare, po ribotojmë të plotë shkrimin e botuar tridhjetë vjet më parë në revistën "Skena dhe Ekran" nr 2 - 1989 me rastin e ndarjes nga jeta të regjisorit Endri Keko, nga shoku dhe bashkëpunëtori i afërt, shkrimtari Dritëro Agolli. Bashkë me këtë shkrim të publikojmë edhe disa foto të rralla, ku Endri Keko ka dalë në shtëpinë e tij me Agollin, foto që janë shkrepur nga mjeshtri i fotografisë, Niko Xhufka, gjithashtu një mik i ngushtë i tyre.

(Dashnor Kaloçi)

1. Në një rrugëz të shkurtër në Tiranë, që degëzohet me Rrugën e Durrësit, pothuajse përballë kafe "Florës", është një ndërtesë pesëkatëshe. Sa herë kaloj andej, pa dashur ngre kryet drejt një ballkoni në katin e katërt. Kujtoj se ka dalë ai në ballkon dhe do të më thërrasë për një kafe. Pastaj ul kokën dhe aty për aty psherëtit. Nuk del ai më në ballkon dhe nuk do më thërrasë më. Ka vdekur Endri. Por zëri i tij aq i njohur për mua, zë tingëllyes dhe i veshur me një qeshje të përherëshme, më ndjek pas dhe më duket sikur e dëgjoj: "Ç'bëhet, more!". Jo vetëm sikur e dëgjoj, por edhe sikur i përgjigjem: "Do shërohesha, ja ç'bëhet!". Unë atë e njihja më shumë se një treçerek jete. Me Endri Kekon e gëzuar e gjithmonë me humor e me dashamirësi, me Endri Kekon e papërtuar e gjithmonë të shqetësuar për

jetën e punën e shokut, të njohurit dhe ndoshta edhe të panjohurit, me Endri Kekon e zgjatur dhe të matur më kanë lidhur shumë gjëra të përbashkëta.

Në ishim nga një krahinë; ai nga Devollit i sipërm, unë nga mesi i Devollit; ai ishte nga Dardha, unë nga Menkulusi. E kam takuar Endrin partizan në shtëpinë e tim eti, me një pushkë të shkurtër e me një kitarë. Më 1943 e kam takuar. Atëherë unë isha dymbëdhjetë vjet dhe ai nëntëmbëdhjetë. Asaj mbremë më shtëpi ai i ra kitarës e këndoio me partizanët. Unë rrija pranë dhe e shikoja si e lëvizte dorën mbi tete. Më dukte partizani më i zoti, se i binte edhe kitarës. Erdhi edhe dy-tër herë në shtëpi dhe për një kohë të gjatë nuk e pashë. Po e dija se kitarë e tij udhëtonte mal më mal. Ajo përhapte tinguj me tymit të barutit të lufës. Dhe këta tinguj ishin uvertyra e jetës prej artisti të Endrit. Nuk u bë



Endri Keko, 1965

artist muzike, po artist kinematografie, regjisor dokumentarist i shquar. Të gjitha artet janë një familje e madhe. Unë e kam fjalën për uvertyrën që e hapë kitarë, uvertyrën e rrugës së artit, ku do të ecte Endri. Kitarë akoma është atje në apartamentin e asaj ndërtesës pesëkatëshe, pothuajse përballë kafe "Florës" të Rrugës së Durrësit.

Pastaj me nuk u pamë për shumë kohë. Lufta, çlirimi, rindërtimi i vendit, vitet e mësimt dhe studimit në shkollë të mesme, në universitet jashtë atdheut, njerëzit i shpërndanin që ti bashkonin persëri. Unë e kuptoja Endrin vetëm kur shihja ndonjërin me kitarë, apo kur dëgjoja tingujt e saj në ndonjë shesh ose skenë. Dhe thosha: "Dikur kam parë një partizan me kitarë".

Pas katërmëdhjetë vjetëve, më 1957, ne u takuam persëri për t'u njohur përgjithmonë dhe për të mbetur miq e shokë përgjithmonë. Ai punonte në Kinostudion "Shqipëria e Re", unë në "Zërin e Popullit". Si mik i përherëshëm i gazetarëve, poetëve e prozatorëve, rrinte shpesh me ta; ua lexonte artikujt, vjershat, tregimet e romanet. Gëzohej si ata, gëzohej për gjërat e mira. Bënte edhe humor me ta. Kur lexonte ndonjë shkrim që i pëlqente, thoshte:

"More, ku i keni gjithë këto mend? Unë ngaherë me ju rri, por nuk më dukeni të keni kaq mend!" - dhe qeshte me zë të lartë.

Në atë kohë në fund të viteve pesëdhjetë dhe të viteve gjashtëdhjetë, Endri bashkëpunonte shumë me poetin Lazar Siliqi. Pjesën më të madhe të filmave dokumentar-artistikë të asaj periudhe ai e ka bërë me skenarë të Lazar Siliqit, veprë që e bëri të njohur Endrin. Me mua filloi të bashkëpunojë nga mesi i viteve gjashtëdhjetë. Duke i lexuar reportazhet e përshkrimet e mia në "Zërin e Popullit", e ngrinte dorën dhe tundte gazetën:

"Ja, bre, ky reportazh

mund të bëhet një skenar për film dokumentar! Ik, ore! Ju s'ndihmoni fare! Shokë jemi, apo ç'jemi!" - thoshte ai.

"Do ta bëjmë, do ta bëjmë!" - i thosha.

Ai afrohej më shikonte drejt e në sy, duke tundur kokën, që atëherë kishte filluar t'i thinjete:

"Tallu, tallu! Ti të gjitha i merr me shaka! Ç'bëhet, more, ç'bëhet me këta njerëz!"

2.

Endri e donte si jetën kinematografine dhe gëzohej si fëmijë për ecjen e saj, se vetë ishte nga pionierët e parë të lindjes së këtij arti të ri në vendin tonë. Ishte i pari që krijoi kronikën kinematografike dhe filmin dokumentar-artistik. E them "artistik" pasi shumë filma të tij nuk janë thjesht dokumentarë, por edhe artistikë, që krijojnë figura të vërteta. Në këta filma ai i vinte rëndësi të veçantë skenarit, dimte t'i zgjidhte bashkëpunëtorët skenaristë dhe dimte t'i afrohte dhe t'i mësonte se si t'i shkruanin. Pas skenarit, ai kërkonte një tekst të gjallë, me fjalë plot kolorit, që të prekte dëgjuesin, që të mos e linte indiferent atë, që t'i nxirrte në relief faktet dhe mendimet e filmit. Dhe vërejtjet e tij ishin konkrete, vërejtjet të bëra me takt e me dashamirësi të vërtetë. Mua në fillim ai më tërhoqi me tekstin. Bënte ndonjë film dokumentar, më ftonte në studio ta shihja dhe pastaj, anës e anës, më thoshte t'i shkruaja tekstin. Ndonjëherë kjo tërhoqje për t'i shkruar tekstin ishte thirrje e papritur. Ishte si një ngjarje, si një tregim.

Në shkurt të 1966 bëhet një udhëtim i gjatë prej 21 ditësh nga rinia nëpër gjurmët e një brigade partizane. Atëherë në Tiranë ishte ngrohtë, megjithëse mesdimri, por andej nga do të shkonte rinia (nëpër kodrat e Pezës e të Peqinit, nëpër malet e Gramshit e të Qarishtës, nëpër Tomoricë e Gorë-Opar rrethë Lenies, nëpër Mokër e Çermenikë, nëpër Martanesh e Mat, nëpër Malin me Gropë e Dajti) do të ishte ftohtë dhe do të binte shi e dëborë. Unë kisha dëshirë ta ndiqja këtë udhëtim, që do të bëhej i tiri me këmbë dhe ndër rhyra në redaksinë e "Zërit të Popullit" që të mëlejonte të shkoja. Do të shikoja gjithë ato vende, do të njihesha me njerëz e me zakone të panjohura dhe do të jepja me telefon reportazhe dhe mbresa udhëtimi. Më takon Endri në kafe "Tirana", atë kur sot është Muzeu Historik Kombëtar. Kafe "Tirana" ishte në katin e parë të një ndërtesë të vogël, një kafe simpatike, që ishte bërë vendi më i dashur i gazetarëve, poetëve, kineastëve, artistëve. Më pa Endri që isha veshur me mushama ushtarake dhe mbathur me cizme të gjata; më pa edhe torbën e madhe pranë këmbëve. U ul të pinte kafe:

"Ku shkon, në stërvtije ushtarake?" - më pyet.
Ia shpjegoj udhëtimin.
"Ik, o, - tha ai. - Ku e ndjek dot ti rininë! Ik, o, se do të qorrollisesh në ndonjë përrual!" - tha ai duke qeshur.
Unë atëherë isha tridhjetepesë vjeç dhe nuk e ndjeja veten të dobët, por Endri bënte shaka.
"Hajde edhe ti Endri! Do ta mbajmë mend këtë udhëtim!" - i them.
"Paske lajthitur? Unë jam dyzetënjë vjeç! E ha unë atë? Të qeshë me mua rininë?" - tha ai me shaka.
"More, ti do të vish dhe do të marrësh me vete edhe operatorin, edhe ndihmësin e tij

3. Filmat e tij ishin sintetikë e përgjithësues. Ngjarjet dhe faktet e vërteta të jetës i ngrinte, i arsyetonte dhe i jepte përmasë filmit në lëvizje, si në një veperë artistike. Në të njëjtën kohë ato e ruanin informacionin dhe dokumentacionin. Merrej vesh qartë se ku ndodhte kjo apo ajo ngjarje dhe personazhet e vërtetë kishin adresë të caktuar. Po t'i shohësh sot filmat e Endrit, do e ndjesh atmosferën e viteve vesh re dhe ndjenjën e hollë të perspektivës, që kishte ai për vendin dhe për njerëzit. Shumë njerëz të thjeshtë që ka xhiruar;



bashkë me aparatit e xhirimit e vegla të tjera. Madje do ta marrësh edhe kitarën dhe një rrëzë edhe një herë nëpër male!" - qesha unë.

Ai u mendua, fërkoj mjekrën dhe heshti për një çast. Pastaj u ngrit e tundti dorën në erë:

"Ç'bëhet, more, ç'bëhet! Më prit këtu se do të vij. Dhe dëgjo! Do të më bësh skenarin dhe tekstin e filmit" - dhe doli nga kafe "Tirana".

Kështu ne u nisëm me rininë nëpër male në mes të dimrit. Kjo ishte një histori e tërë me lodhje e me humor. Nëpër gryka të vështira e në të përpjeta si thikë, kur mbulohehim në djersë, Endri thoshte:

"Ah, ç'na bëre! Edhe unë mora mendjen tëndel... S'e dinë ato gratë tonë se ç'heqim ne të shkretët! - dhe pastaj qeshte me të madhe.

Përmasë këtij udhëtimi, si pa kuptuar, më futi Endri Kekoja në rrugën e atyre pak skenarëve për filmadokumentar-artistikë, që kam shkruar. Por me të ishte kënaqësi të punoj, se kishte një mënyrë komunikimi të gëzueshëm. Ta kthehte skenarin dhe tekstin me shënime të qarta: ky episod të dalë kështu, ky fakt të zbulohet më mirë në këtë vend, kjo frazë të ketë fjalë më me ngjyrë..."

"Hë, se e bën! Si i mban gjithë ato mend, more! Kësaj i them mendje unë!" - thoshte ai, kur skenari ndreqej sipas vërejtjeve të tij dhe pastaj persëri ta kthente.

"Po ti më i lavdërove mendit! Prapë ma kthen?" - i thosha.

"Hë, se mendja s'ka kufi! Kësaj i them punë! Ku e gjeni gjithë këtë durim, more!" - qeshte ai dhe të përfafonte.

3.



← tani janë bërë kuadro të rëndësishëm në gjithë sferat e jetës, në ekonomi, kulturë, ideologji, politikë. Ka nga ta që janë bërë shkencëtarë, inxhinierë, artistë, ministra, deputetë, anëtarë të KQ të Partisë. Në filma Endri ishte parashikues realist dhe në të njëjtën kohë edhe romantik që dinte të ëndërronte, që e donte dhe e çmonte të bukurën. Kishte dëshirë të jepte në filma kontraste, teza dhe antiteza, krahasime të së sotmes me të djeshmen për t'i përfytyruar konturet e të nesërës. Një nga filmat ku duken më qartë këto elemente, që përbënin stilin e tij, është "Rruga jote, shok!" dalë në nëntor të 1969, me rastin e 25-vjetorit të çlirimit. E kishte menduar gjatë këtë film. Që në pranverën e 1968 më thotë një ditë se kishte në mend të bënte një film dokumentar-artistik me metrazh të gjatë për të regruar se ç'shite sot Shqipëria, çila është toka e saj dhe njerëzit e saj. Filmi të konceptojë në formën e një poemë dhe njëkohësisht të ishte i vërtetë, i bazuar në dokumente të gjalla, të kishte një destinacion dhe një adresë të caktuar.

"Skam qejf të ndërtohet kronologjikisht, sipas viteve dhe periudhave historike!" - më tha.

"Të përzihem ngjarjet dhe njëkohësisht të kenë një rrjedhshmëri, një harmoni, një simetri..." - arsyetova unë.

Ai m'i hodhi sytë, sikur të më vështronte për herë të parë:

"E gjete! Pse s'thua që e ke gazetë skenarin! E po, mbaroi kjo punë!"

Unë e kundërshtova. Ateherë kisha shumë punë në gazetë. Dilja shpesh me shërbime të gjata nëpër gjithë vendin. Kisha menduar të shkruaja edhe poemën "Baballarët" dhe punoja edhe mbi romanin "Komisar Memo".

"Aman, Endri. Nuk i qëlloj dot skenarët unë!", u luta. Endri më zgjati një cigare. Nuk mu lut. Madje s'foli më për filmin. Më tha vetëm të shkonim në kafe "Tirana".

Morëm nga një kafë e nga një konjak. Përballë nesh ishte Llazar Siliqi me 3-4 poetë të rinj, dashamirës, i entuziazmuar. Unë më trezë pranë dritarës rrinte i vetëm Dhimitër Shuteriqi, duke shkruar si gjithnjë kokullur, i menduar, i zymtë. Më tutje Petro Markuza me Skënder Luarasin kishin ndezur një bisëzë të zjarrtë.

"Sa mirë e keni ju sh-

i zgjuar që je! Ah, ku i ke gjithë këto mend!"

Llazar Siliqi, që sapo kishte ardhur nga Shkodra, se atëherë kishte një shërbim të gjatë në atë qytet, ktheu kokën nga trezëra jonë:

"Çpaskeni sot?" - qeshi ai.

"Po bëjmë një skenar. Llazar! E kemi vështirësinë të ndërtimi" - tha Endri.

Llazar e besoi.

"Ashtu? Me nam!" - tha ai.

Ne pastaj u ngritëm e dolëm, duke bërë humor me kafe "Tiranën" dhe me shkrimtarët, që Endri i donte dhe i kishte shokë. Më ftoi në shtëpi për drekë, por unë kisha për të shkruar një artikull dhe i thashë se do të veja një herë tjetër.

Pasdarke në shtëpi e marr në telefon, 54-43. Tani ky numër, si të jetë në ekran, më nxjerr ngaherë fytyrën e Endrit, flokët e tij të bardha, hundën si të shqijonës. Përmes këtij numri sikur dëgjoj zërin e tij: "E more, ç'bëhet? Si s' mbloodhëm një herë!" Kur e marr në telefon Xhanfise Kekon, të shoqen e tij, Aristen e Popullit, gati sa s'them

daktor. Endri e shikonte shishen e thoshte:

"Aman, Dritëro, ti mos p! Të kam xhan, mos pi, se ma le përgjysmë skenarin!"

"E mo, Endri, njëckë le të pijë!" - thoshte Sofoja.

"O Sofol! - Për sabotim erdhe?" - i kthehej ai Sofos së gjatë e të hollë si aris-tokrat.

Edhe me Sofon, atëherë gazetar i dëgjuar, Endri kishte bashkëpunuar dhe me skenarët e tij kishte xhiruar disa filma si "Vëllezërit Tare" dhe "Në flakët e revolucionit".

"Edhe ti, Sofo, m'i ke zvarritur skenarët dhe më ke sjellë vërdalë sa ke dashur!" - i thoshte Sofos.

Sa nisim të pinin, Endri tundte kokën:

"Iku skenari! Ç'janë këto që bën, moj Sadie! Ç'ishte kjo shishë që nxore!" - i kthehej ai gruas sime gjithmonë me të qeshur.

Me të mbaruar skenari, Endri filloi xhirimin. Atë vit u d h e t u a m shumë bashkë: në Vaun e Dejës ku ngrihej hidrocentrali, në Kukës, në Tropojë, në Bulqizë, në Peshkop. Kur shtroheshim me fshatarët, më thoshte:

"Ngri sa të duash doli! Tani skenarin e kam!"

Para se ta mbaronte filmin, në fillim të marsit 1969, unë mora honorarët e skenarit. Ateherë sa më kishte lindur djali. Gruaja ishte në materninë. Do të dilte e ta sillte djalin në shtëpi, por nuk kishim krevat të vogël. Kishte lezet. Ajo kishte bërë gjithë atë djalë dhe të mos gjente në shtëpi krevat për të!

"S'ka lezet! tha Endri. Hajde ta blejmë!"

Para se të vinim në Mapo, i them Endrit të ktheheshim në restorant "Donika", që atëherë pas "Dajrit" ishte më i miri. Mezi erdhim. Duhej të festonim edhe lindjen e djalit, edhe skenarin e filmit "Rruga jote, shok!", që kishte filluar të xhirohej. Endri e pa se në "Donika" po shreshishin honorarët dhe tha:

"M'i jep pare!"

Unë nxora njëmijë lekë të vjetra.

"Të gjitha! Të dymbëdhjetëmijë!" - urdhëroi ai dhe unë ja dhashë, megjithëse kthevati kushtonat nja dymijë...

"Ja, ku i ke!" - i thashë.

"Ashtu! Po t'i prishim, me se do ta blejmë krevatin? Hajde më dorë, hajde!" - tha ai me parë në dorë.

U ngritëm dhe shkuan në Mapo. Aje e blejmë krevatin e vogël. E zëm një më një anë dhe tjeiri në anën tjetër dhe në nisëm ndër të bivalet me të madh të Tiranës. Shokët gazetarë, poetë, shkrimtarë e të njohur të tjerë na shikonin e pyetnin se për çfarë e kishim këtë krevat.

"Djalë, more, djalë!" - thëriste Endri.

Gruaja doli nga materniteti. Erdhën shumë njerëz nga Shkodra, nga Tirana e Korça



Endri Keko dhe Dritëro Agolli gjatë shkruarjes së skenarit, 1969

krimtarët! Jeni krejt të pavarur. Një letër, një laps... Ne kin-eastët e gjorë varem nga disa të lajtthitur si ju. Ju lutem për skenarë. Ju qerasim me kafe. Ju marrim me të mirë, të mos ju prishim qejfin. Aq mirë e keni sa..." - tha si me ironi dhe humor.

E ndjeja se vërtitët rreth skenarit, që duhej t'ia shkruaja, por nuk më thoshte drejt-përdrejt.

"Filmi që ke në mend të bësh, jo vetëm s'duhet ndërtuar me parimin kronologjik, por as tematik, sipas sektorëve: për industrinë, për bujqësinë, për kulturën, për politikën e jashtme... Janë bërë të merrtshëm dokumentarët me këtë ndërtim... Edhe këto tema duhen përzierë. Filmi të jetë poemë për njerinë dhe për Shqipërinë..." - i thashë më shumë për t'ia hequr mierzë.

Dhe këtu ai s'u përmbydte dhe u hodh në karrige:

"E pashë unë, që ti u ngacmove! Po e bën që këtu skenarin! Më duket se po e bën!"

"Endri, më mirë ta ruajmë miqësinë. Po e fillova skenarin, në do të prishim miqësinë..." - i thashë.

Më pa si me çudi.

"Pse do të prishim miqësinë?"

"Si të të them! Unë do të të gënjë. Nuk do ta mbaj fjalën. E bëj sot, e bëj nesër, e bëj pasnesër! Do të të sjell e do të të vërtit. Ti do të zëmërohesh e do të thashë. "Ipsur qoftë, kurrë mos e bëshi! Ja, iku miqësia! thashë unë."

Endri i dha të qeshurit dhe pastaj më zuri për flokësh, duke u tallur:

"O koloçuçi i xhaxhait, sa

"ç'bën Endri?" Dhe më push-ton një mall. A e keni provuar ndonjëherë të humbni një shok të ngushtë dhe të merrni në telefon me numrin e tij?

Dhe kështu, pasdarke e marr në telefon:

"Endri! Do ta bëj skenarin! Do ta bëj, por e di se do të ta zvarris!"

Nga fundi i fillit të telit erdhin zëri i gëzuar i Endrit:

"Këttji i them shok unë! Dalim?"

"Dalim, Endri!" - dhe atë pasdarke ndenjëm bashkë gjatë.

E shkrova skenarin, doemos me javët e zvarritura, se nuk më linin të qetë telashtet e gazetës dhe herë-herë më pengonte vullneti im i dobët. Endri më vinte dy-tri herë në ditë në shtëpi dhe e lexonte në dorëshkrim faqe pas faqesh. Nuk më bente vërejtje. Unë e kuptoja pse s'më bënte. Kishte frikë se mos ia lija përgjysmë. Kur e mbarova, atëherë filloi ju vërejtjet. Shtonte edhe vetë pjesë të tëra, ndërronte radhën e episodeve dhe bënte ndregjet e veta. Kur unë e zvarrisja skenarin dhe e mbaja për drekë a për darkë në shtëpi, ai thoshte:

"Në dëmin tënd është zvarritja. Zvarritte ti, zvarritte, pa unë do të dëmtoj ekonomikisht, se do të rri për drekë e për darkë!" - dhe qesh-te.

Kur gruaja ime nxirrte raki, se për drekë vinte ndonjëherë edhe Sofokli Afexolli që ishte sekretar kolegji në gazetën "Mësuesi" e më vonë kryere-



Dritëro Agolli në shtëpinë e Endri Keko, 1979

dhe u mbush plot shtëpia. Njerëzit mezi merreshin vesh se ç'emër duhej t'i vinin djalit. E ëma dhe tati i gruas, motrat, vëllezërit dhe kunetërit e saj nga Shkodra donin t'i vinin emrin Ardian. Nënë ima, motra, vëllai, kushërinjët ngulnin këmbë për Artan. Unë s'kisha kujt t'ia drejeja e kujt t'ia prisheja. Endri, si diplomat i madh, ndërronte herë pas here me të qeshur, por edhe ai s'ua prishte dot miqve të Shkodrës. Nënë ima, ndjese pastë, ia shtypte gjurin Endrit dhe i thoshte: "Endri, thuaj Artan! Do të bëhet jona! Jona do të fitojë, jo e Shkodrës!"

Dhe Endri u ngrit e tha me gotë në dorë:

"Tani edhe unë mik jam në këtë shtëpi, siç janë mik edhe këta të Shkodrës. Më mirë t'ia vëmë emrin Artan! Dhe të bëhet njëqind e një vjet! Shëndeti i Artanit!" - tha ai dhe e pui me fund.

Asnjërit nuk i mbeti qejfi, se Endrin e dëgjonin dhe e donin të gjithë.

Atë natë unë s'kisha ku të flija, pasi shtëpia prej dy dhomash e një kuzhinë, ishte mizëri me njerëz dhe shkova tek Endri. E ëma e tij, Krisulla, ndjese pastë, një grua e gjatë, e pashme dhe ngaherë me fustan të zi, kur mori vesh se unë do të flija tek ata, m'i lëshua duke tundur gishtin tregues para fytyrës:

"Ah, more, Dritro, - se smë thoshte dot Dritëro. - Ah, more Dritro! S'ka brëç vaki, që njeriu të lehtë shtëpinë e tij në Tiranë e të flerë në një shtëpi tjetër po në 'Tiranë! Jo, jo! Kjo s'është parë dhe s'është dëgjuar! Ah, more, Dritro, edhe vjen duar thatë, pa një pako kafe, a pa një shishe recel! Ti e di që kam qenë edhe pa qejf në shtat e mbërthyer! Eh, ku ka tani sajdi e respekt! Eh! Kështu janë këta! Eh!" - tundi kokën dhe shkoi e u ul në kanapenë prej derese, të mbuluar me velenxë kuq e zi.

Ajo ishte tepër shakatore dhe shumë ironike, me një zgjuarsi të rrallë nga natyra dhe nga përvoja e viteve të gjatë.

Xhanfiseja, që tani është mjaft e njohur, autore e filmave "Beni ecën vetë" e plot të tjerëve, atëherë e re, me një fytyrë të lëmuar e flokë të zeze e të drejtë, një grua e pashme e fisnike, e vështroi të vjehrën me bisht të syrit.

"Ama edhe ti, mëmë, si flet! Në shtëpinë e vëllait do të flerë! - tha ajo, duke mos kuptuar shakanë e së vjehrës.

Krisulla u ngrit, ktheu kokën nga ballkoni, e bëri:

"Eh! Sikur thashë gjë! Hën! Kjo di të bëjë vetëm filma e të cepkaltë vazot e luleve! Të tjerat i bëj unë! Eh! Sikur thashë..."

Ja, kështu e festuam fillimin e filmit "Rruga jote, shok!" dhe lindjen e tij. Më vonë shkruam bashkë edhe skenarin e filmit do-

ku mentaro-artistik "Krevati i perandorit" dhe tekste të tjerë. Ne ishim si vëllezër dhe na lidhnin mjëra fije miqësie e dashurie. Shpesh udhëtonim bashkë nëpër Shqipëri, ku me këmbë e ku me makinë, dhe në shtëpitë e fshatarëve ai dinte të fitonte dashurinë dhe zemrën.

Udhëtimin e fundit e bëmë në Vranisht të Vlorës, ku fjetëm në shtëpinë e Maman Salitit, një komandanti partizan të vjetër, burri të nderuar në gjithë Labërinë. Unë atëherë shkruaja një skenar për një film dokumentar-artistik për jetën e Hynsi Kapos. Filmin do ta xhironte Artisti i Popullit Viktor Gjika, por për shoqëri erdhi edhe Endri Keko. Mamani e njhte Endrin, tregonte histori dhe anekdota e ne qeshnim. Aty nga mëngjesi ra një shi i madh, si rrëshesh dhe doli nga shtrati lumi i Vranishtit, që mbledh ujërat e malit të Çikës. Ne atëherë ishim bërë gati për t'u nisur, por nuk e kalonim dot lumin, se urë nuk kishte. Megjithatë vendosëm. Veturën tonë të vogël e lidhëm pas një kamioni dhe u futëm në lumë. Uji hyri në makinë dhe ne u lagëm gjer në brez. Ishim të marrë!

Më vonë Endri shkroi një testament, sikur e kisha lënë unë:

"Para se të futeshim në lumë, Dritëro! Ia këtë amanet në klubin e Vranishtit para Maman Salitit dhe Endri Kekos... ato miliona para që kam në arkë e kursimit t'i jepem fshatit Menkulas për shtëpinë e kulturës dhe muzeun; këtë shishe me raki që kemi marrë nga Vranisht t'ia dorëzojmë Fatmir Gjatës për të na kujtuar; këtë bisht dashi që nuk e hëngrëm mbrëmë dhe që Mamani na e dha me vetë t'ia shpjemë Niko Nikollës për shpirtin e tij; këto fletorka e stilografin t'ia japim Sadies për t'i dërguar në muzeun e Bilishtit..." e të tjera.

Endri e lexonte këtë testament kur mblidheshim në shtëpitë e njeri-tjetrit dhe përhapte një gjëzim të këndshëm... që krijonte një gjendje shpirtërore të bukur. Ne të gjithë qeshnim.

"Eh, do të mbyteshiti! S'e sheh? Trimëri të madhe pas-ki bërë!" - thoshte Krisulla me buzën pakëz në gaz e duke zgjuar fytyrën me rrudha nga ballkoni.

Ishte e gëzuar jeta me Endrin, artistin e shquar, njeriun e vërtetë dhe shokun tim më të dashur. Unë tani kaloj andej nga rrugica, ku ngrihet një ndërtesë pesëkatëshe, përballë "Flores" së rrugës së Durrësit, hindnë sytë padashka në ballkon, por ai nuk del më... Ka vdektar? S'e besoj... Njeriu vdes vetëm kur harrohet. Endri nuk harrohet dhe nuk vdes...

Maj, 1989

SHFAQJA



NORM DHE AHMED

"Ngjyra jote e lëkurës nuk është errësirë"

Fatmira Nikolli

-Dil pak në dritë. Je fiks sic e mendoja. Ti je më shumë ngjyrë ulliri. A të ka thirrur njeri ty o 'errësirë'? jo.

- Po Norm, dikush edhe e ka bërë. - Mos u zemëro, po mendoj që me që ti nuk je aq i zi, mund ta kalosh mirë edhe te ne.

Norm dhe Ahmed janë njohur tashmë krejt rastësisht në një stacion autobusi pas mesnate. Është Norm, që i ka kërkuar një çakmak, një djaloshi pakistanez në Sidnej. Një vendas dhe një emigrant janë përballë dhe një bisedë që nisi krejt si rastësore po endet në dasitë mes kombeve. Janë përballë një mysliman dhe një i krishterë, një ish-ushtar që ka marrë pjesë në luftëra dhe një student artesh, që do të njohë qenien njerëzore.

Ndërsa njëri rrëfen luftën në Egjipt e Galipoli, të vranët atje, "të egrit" që kish lënë pas nëpër luftëra, tjetri befasi endjen frikën.

"Më vjen shumë keq për të rënë në beteja. Të gjerët! Por, legjendat e tyre kujtohen shpesh për të mbështetur dhe justifikuar luftëra të tjera. Më falni që po e them këtë si një kritikë ndaj vendit tuaj. Nuk duhet të harroj se jam mysafir në këtë vend. Ju kërkoj një mijë herë falje", thotë Ahmed.

Lulzim Zeqja është veshur si pakistanez dhe ka drojën e frikën, ka ngurrimin e një të huaji në Australi. E një të huaji në një vend ku të qenit ndryshe gjykohej, ku gjykohej ngjyra e lëkurës, veshja, feja dhe kultura. Zeqja e ka veshur pakistanezin në lëkurën e tij dhe flet me gjysmë zëri Gert Ferrës, i hedh hapat të pasigurt nëpër një skenë të errët. Ai është një lindor në Australi. Një çantë shpine e lë mënjanë. "Asnjë racë njerëzore nuk është superiore, asnjë besim fetar nuk është inferior". - ky është mesazhi që jep vepra "Norm dhe Ahmed", shkruar nga Alex Buzo, që u vu në skenë këtë fundjavë nga Armand Bora me interpretimin e Gert Ferrës, Lulzim Zeqes dhe Gladiola Harizajt.

Më 1968, shumë vite para asaj që ndodhi këtë vit në Australi, ku një ekstremist vrau disa njerëz në xhami, një shqiptar që kishte lindur e ishte rritur në Australi trajton përmes kësaj vepre diskriminimin e emigrantëve. Dhe vë përballë, dy fe, dy kultura, të dobëtin përballë të fortit, në një natë të errët, në një stacion të braktisur, ku nuk pipëtin asgjë përveç tyre. I vë përballë dhe i lë të tre-

gojnë botët e tyre, e ndërsa duken se po kuptohen e po miqësohen se po e pranojnë tjetrin, dikur e keqja nxjerr krye. "Ndodhë kaq shpejt dhe kaq papritur sa është e pamundur që ta ndalosh... dhe gjithnjë kështu ndodhë... çdo natë dhe kudo...", thotë Ola Harizaj si rrëfimtare në anë të skenës.


Premiera më e re e Teatrit Kombëtar "Norm dhe Ahmed" u vu në skenë në datat 5 dhe 6 prill dhe shfaqet edhe sonte në mbrëmje në "arTurbina".

Në orët e vona të natës, në një stacion të harruar autobusi, në periferi të qytetit të Sidneit, jo larg bregut shkëmbor të Oqeanit Paqësor, do të takohen Norm dhe Ahmed për të na treguar një histori të vjetër sa vetë historia e njerëzimit. "Norm dhe Ahmed" është vepra që e futi autorin shqiptaro-australianin Alex Buzo, në radhën e shkrimtareve më të mirë të kontinentit australian. E shkruar me një gjuhë dhe stil ku nuk mungojnë situatat dhe batutat e humorit, ironisë dhe sarkazmës. E vlerësuar me disa çmime dhe e vendosur në disa vende të botës, kjo vepër vazhdon të mbajë hapur debate dhe diskutime të forta për temën dhe konfliktin e ashpër që trajton.

Me skenat dhe kostumet e Romeo Çanit dhe përkthimin e Diana Çulit, vepra trajton përplasjet e kulturave.

DRAMATURGU

Alex Buzo ka lindur në Sidnej, më 23 korrik 1944. Mbaron shkollën më të famshme "Shkollën Armidale" në Australi dhe më pas në "Shkollën Ndërkombëtare" në Gjenevë-Zvicër, ndërsa studimet e larta i kreu në Universitetin e "New South



Wales", ku u diplomua në vitin 1965. Në vitin 2005, u dekorua me titullin "Nderi i Shkronjavë" në Universitetin e "New South Wales" për kontributin e tij në letërsinë australiane. Aleks Buzo vjen fuqishëm në letërsinë australiane në vitin 1968, me dramën e parë, "Norm dhe Ahmed", që ishte ndër të parët autorë që ngriti diskriminimin e emigrantëve në Australi dhe zgjoi vëmendjen e kombit australian, duke vënë në pah problemet e asaj kohe lidhur me emigrantët. Publiku australian u

Përballë ish-ushtarit Gert Ferra, pakistanezi që studion arte, Lulzim Zeqja

shin shumë gjini letrare, drama dhe romane, skenarë filmash, artistikuj etj. Gjithashtu, ka shkruar disa libra mbi sportin, gjuhën dhe teatrin.


NDËR VEPRAT E TIJ RADHISIM:

"Revolta" (1967); "Norm dhe Ahmed" (Valuta Press 1968; "Djemtë e dhomës qëndrore" (Valuta Press, 1970); "Macquarie" (Valuta Press, 1971); "Batmani-shef i plazhit" (1973); "Rrënjët" (Valuta Press, 1973); "Tregimet e Roy Murphy-t" (Valuta Press, 1973); "Coralie Lansdoëne thotë jo" (Valuta Press, 1974); "Tom" (Angus & Robertson, 1975); "Vicki Madison del jashtë" (Valuta Press, 1976); "Kullat Martello" (Valuta Press, 1976); "Koralet Makassar" (Valuta Press, 1978); "Lumi i madh" (Valuta Press, 1985); "Ferma marginale" (Valuta Press, 1985); "Stingray" (Valuta Press, 1987); "Rruga Shellcove" (1989); "Bashkimi në Paqësor" (Valuta Press, 1995); "Legjendat e Bagit te Gjelbër" (Allen & Unwin, Sydney, 2004; "Një fjalor thuaje i dukshëm" (Tekst Publishing Company, Melbourne, 1998); "Kiwese" (Mandarin, Port Melbourne, 1994); "Ndeshja më e gjatë" me bashkautor Jamie Grant (Mandarin, Port Melbourne, 1990); "Personat e rinj" si dhe një "Udhëzues për Teatrin" (Penguin, Ringwood, 1988); "Regëtime të rrahurash" (Penguin, Ringwood, 1987); "Njihuni me klasën e re" (Angus dhe Robertson, Sydney, 1981). "Tautologji" (Penguin, Ringwood, 1981); "Pru futuron drejt veriut" (Mandarin, Port Melbourne, 1991) dhe "Kërkimi për Harry Allway" (Angus dhe Robertson, Sydney 1985).

befasua nga aftësia e tij në idiomat e anglishtes dhe nga angazhimi i palodhur i Buzos për të reflektuar natyrën e vërtetë të shoqërisë australiane. Ai është autor i 88 dramave dhe veprave letrare. Veprat e tij janë vënë në skenë në Australi, Angli dhe Amerike dhe sot konsiderohet si një ndër pionierët e Rilindjes së dramës australiane dhe më gjerë të letërsisë anglishtfolëse...

Në vitin 1972, Aleks Buzos iu dha "Medalja e Artë në Letërsi" e për dramën e tij "Macquarie". Aleks Buzo në karrierën e tij për-

E DIEL
7 Prill
2019



E drejta dokësore shqiptare te "Breznitë e Hankonatëve"

AGRON ALIBALI, LL.M.*

Le të shqyrtojmë filli miisht faktet dhe rrethanat e çështjes, që përbën boshtin e novelës.

Data e gjykimit është 20 mars 1703 - mëngjes, prag pranvere;

Vendi i gjykimit është Gjirokastra, në agun e zgjerimit të saj qytetës;

Palët ndërgjyqëse janë Basri Hankoni - paditës, ardhës diku nga malet e Zagorisë apo Tepelenës, dhe Jahja Toro - anas, i paditur;

Objekti i padisë apo i mosmarrëveshjes është Ara e Mullenjave, të cilën e pre-

ndon paditësi;

Gjykatës është Kadiu Abdelkadir "Kadilerët e Gjirokastrës - shon Shkrimtari - ish-in të dëgjuar në gjithë shtetin e madh osman për zotësinë e tyre".

Procesi gjyqësor kishte qenë i zvargur. Gjykata ishte munduar t'i jepte zgjidhje, duke shqyrtuar maspari tapitë e vjetra. Mirëpo përcaktimi i kufirit kishte qenë i pamundur për shkak të rrëmujës së arkivave, por edhe për shkak të një përroi të ardhur nga Mali i Gjerë, që me zigzaget e paparashikueshme të prurjeve stinore, e kishte ngatërruar dhe më shumë fillin e sinoreve.

2. E DREJTA POZITIVE DHE E DREJTA DOKËSORE

Në thelb, konflikti civil nuk

ishite vetëm njëfarë përplasjeje interesash pasurore midis anasit dhe ardhësit. Ai ishte sidomos konflikt midis dy sistemesh të ndryshme juridike: midis ligjit otoman si shprehje e së drejtës pozitive, të prurë nga Anadulli, me ligjin e gjetur ose ekzistues, që s'ishite tjetër veçse kodi i lashitë dhe i pashkruar vendas. Megjithë përpjekjet e kadiut, kishte qenë e pamundur që çështja të zgjidhej me ligjin otoman. Mjeti i vetëm i mbetur ishte e drejta dokësore vendase - apo rregullat e lashta që përcaktonin ndarjen e pleqësisë përmes bësë. Atë ditë agu pranvere të vitit të largët 1703 palët ndërgjyqëse parandjenin në heshtje se "e drejta e lashitë gjindet mes nesh sot e gjithë

ditën".

E drejta pozitive është, në thelb, tërësia e normave, dispozitave apo rregullave, e ngulitur në trajtën e shkruar, në ligj. Ajo shfaqet tek "Breznitë" përmes përmendjes së dekretive, fermaneve sultanore, reformave juridike të Tanzimatit, rregulloreve të ndryshme etj. Natyrisht, kjo tablo e ligjit "të importuar" nuk do të ishte e plotë pa shëriatin.

Nga ana tjetër, e drejta e pashkruar mund të përkufizohet si tërësia e normave të transmetuara gojarisht ndër breza - qysh "herëherët", siç gjejmë të shprehur në Kanunin e Lekë Dukagjinit - ose të ndërmarra si vendime apo si sulle në kuvende, të cilat rregullonin në mbarë trojet shqiptare

marrëdhëniet shoqërore, familjare, pronës, trashëgimie etj.

Nëse rrekemi ta ndajmë më tej këtë korpus të çmuar dokësor mund të themi se ai, sikurse e drejta pozitive, përbëhet nga e drejta zakonore penale, që rregullonte "mbrapshtinat", apo krimet ndaj personit, komunitetit, pronës, gjasë etj, dhe e drejta zakonore civile, që rregullonte të gjitha mosmarrëveshjet për pasurinë e luajtshme e të paluajtshme. Kësaj të fundit mund t'i bashkëngjisim edhe rregullimet në fushën e trashëgimisë e të mosmarrëveshjeve familjare etj. Kjo Jus non scriptum e shoqëron rrëfimin e Shkrimtarit përgjatë gjithë novelës.

→ Vijnë në faqen 14

Në këtë numër: AGRON ALIBALI, GJORGJE KRAJISHNIK PËR ARIAN LEKËN, VLADIMIR VOLAN, HIKMET FERIDUN ES DHE KUJTIM NURO

L
LETËRSI

Kjo sprovë rreket të përcjellë disa anë të së drejtës së pashkruar shqiptare të fushës civile, të pasqyruara në veprën e Kadarese "Breznitë e Hankonatëve". Përndryshe, aspektet më prekëse e dramatike të së drejtës dokësore shqiptare, ato në fushën penale, që lidhen me gjakun, gjakmarrjen, besën, mikprerjen etj. janë trajtuar gjerësisht dhe në këndvështrime të ndryshme nga kritika vendëse dhe e huaj. Përmes përshkrimit të fateve të gjashtë brezave të familjes Hankoni, "Breznitë e Hankonatëve" na përçon aspekte sa të çmuara, aq edhe të çuditshme të së drejtës pozitive dhe asaj zakonore, si dhe të ndërthurjeve e ndërveprimit midis tyre.

E drejta dokësore shqiptare te "Breznitë e Hankonatëve"

NGA AGRON ALIBALI, LL.M.*

3. Ligji i lashtë dhe i mirë vijon

Ligji apo e drejta dokësore ka dy tipare themelore. Maspari e drejta e pashkruar duhet të jetë e vjetër. Njihëri, ajo duhet të jetë e mirë.

Mosha apo vjetëria ishte përgjithësisht tipari më i qenësishëm i dokeve më të hershme, të cilave po u referohemi si ligji objektiv. I lindur në agun e shoqërisë njerëzore, i përsëritur, transmetuar, përcjellë e zbatuar brez pas brezi, ky "leges patrum" apo "ligji i etërve"... ishte, në fakt, zakon". Dhe pikërisht "sipas zakonit të vjetër", apo kryerjes së bësë në pronën objekt padie, vërtiten ngjarjet në novelën tonë.

Mirëpo nuk është veç mosha që krijon ligjin e pashkruar. Ky përmban në vetvete edhe një element tjetër të qenësishëm: ai duhet të jetë edhe ligj i mirë. Sepse zakonet apo praktikrat e ngulitura jo gjithnjë janë të mira. Shembuj tipikë janë gjakmarrja, pozita relative e gruas, fejesat në djep etj.

Atë ditë të marsit 1703, kur e drejta pozitive kishte shtuar në tagrin e vet për të vendosur në drejtën, palët vendosin ta zgjidhin mosmarrëveshjen përmes së drejtës dokësore. Dhe pikërisht me institutin e lashtë të bësë. E drejta pozitive, megjithatë, nuk dorëzohet kollaj. Në vend të pleqve, apo pleqnarëve mitikë, që ndanin gjyqet e mosmarrëveshjet nëpër malet shqiptare, "seancën gjyqësore" në qiell të hapur e drejtojnë gjykatësi otoman.

Pyetja e parë është se çfarë burimi të së drejtës zbaton Kadareja në rrëfimin e vet? E thënë ndryshe, çfarë ligjesh dokësore, vendime (sulle) apo institute zakonore përdor Shkrimtari si mjete artistike për ndërtimin e tekstit dhe për ta ripërcjellë konfliktin ligjor / dokësor në veprën e tij?

Dhe më tej, si mund ta ketë përthithur dhe përçuar ai këtë korpus gjigand ligjesh dhe sullesh të pashkruara? Dhe së fundi, çfarë e ndan fikcionin, të përcjellë përmes tekstit si narrativë, nga burimorja, të nënkuptuar dhe referuar në shkrim?

Dihet se areali ku ngjarjet marinarin shtat është vendlindja e Kadarese. Kuptohet që Shkrimtari mbështetet në të drejtën zakonore të Shqipërisë së Poshtme, një masë dheu që, në atë kohë, përmbledhje



midis lumit Shkumbin dhe Gjiut të Artës. Këtu përfshihen, në vija të trasha, e drejta zakonore e Çamërisë, ajo e Labërisë, dhe e Toskërisë.

Një shënim i çuditshëm i Gjeçovit na jep të dhënat rrethanore për korpusin juridik që Shkrimtari zbaton në Gjirokastër. Shkruan gjurmuesi i njohur: "Edhe Labëria ose arbëneshët e Toskënisë bajnë kuvende mbas Kanunit të Lekë Dukagjinit." Dhe më tej: "Krahi qi i afrohet Gjinoastrës thonë: "Me ba kuvend mbas kanunit të Pirrit."

Kjo thënie e Gjeçovit, natyrisht, duhet marrë me rezervë dhe duhet qartësuar më tej. Ajo çka na intereson këtu është uniciteti në diversitet, njëjësia apo përbashkësia e së drejtës zakonore shqiptare në jugë e veri. Përtej shumësisë së Arbërive të vogla të kohës, me dallimet, lokalizmat e veçoritë e tyre të natyrshe në të drejtën dokësore, ngrihej Arbëria e përbashkët dhe e plotë, që kishte të njëjtë jo vetëm gjuhën e gjakun, por edhe thelbin e së drejtës dokësore. Pavarësisht nga variacionet apo devijacionet, ku veçojmë për shembull "martesën midis kushërinjve të parë për shkak të moscopëtimit të pasurisë," kjo e drejtë e lashtë gojore ishte e njëjtë dhe koherente sa u takon parimeve, institucioneve dhe trajtave të veta themelore. Kuvendet në rrethet e Gjirokastër i "bajnë ...mbas Kanunit të Lekë

Dukagjinit", shprehet Gjeçovi. Edhe Kadareja pra, kur flet apo shkruan për të drejtën zakonore të Gjirokastër, nuk është aspak larg Kanunit të Lekës, të Skënderbeut apo të Dibrës në veri.

Arma kundër Hankonatëve

Arma tjetër në arsenalin e opinionit publik ishte leçitja, d.m.th. izolimi i përgjithshëm e absolut që i bëhej dhunuesit të zakonit, duke mos i shkelur në shtëpi. Heshitja dhe një formë e leçitjes u shfaqën papritmas si sanksione përmbi brezninë e pestë të Hankonatëve, pas vetëvrasjes së pleqve Çanatë, natën e Vitit të Ri, ngaqë "s'kishin t'u kthenin Hankonatëve borxhin e dyfishuar nga fajdeja". Sikurse përmendim tjetërkund, fajdeja ishte e ndaluar me Kanun. Mirëpo Hankonatët e kishin shkelur këtë dispozitë të së drejtës zakonore. Dënimi i opinionit publik ndaj këtij veprimi të Hankonatëve nuk vonoi. Ai u shfaq në trajtën e një "vale inati shurdhan kundër tyre" në mbarë qytetin.

4. Shkrimtari dhe e drejta dokësore

Si diçka e pashkruar, dhe e transmetuar gojarisht nëpër breza, e drejta zakonore ruan në vetvete ngjizjen dhe qëndrueshmërinë e parimit a normës, mbështetur në kujtesën individuale dhe kolektive, dhe sidomos në parimin thelbësor procedural të precedentit. Mirëpo për vetë karakterin e saj të pashkruar dhe mbështetur tek kazusi i gjykuar dikur, ajo është veçanërisht e prirur për intertekstualizim, ndryshim e përpunim. Ky elasticitet apo plasticitet - duke ruajtur gjithnjë boshnjat e trashëguar nga leges patrum - përfaqëson pikërisht forcën, larminë, apo edhe vetë gjallërinë e jetës së saj.

Në këtë sprovë të jashtëzakonshme Kadareja na shfaqet, së pari, si njëfarë mbledhësi apo gjurmuesi të normës së pashkruar. Si vëzhgues i mprehtë dhe i vëmendshëm, Shkrimtari shkon në gurrë. Ai e "mbledh" të drejtën zakonore nga tregimet dhe bisedat e paraardhësve të tij, netëve të gjata rreth oxhakut të odave të qytetit të gurtë, ose si dëgjues i kujdesshëm i kumteve gojore të anëve gjirokastrite rotull "masësë" së kafesë.

Mirëpo Kadareja nuk ndalet këtu. Ai e qëmton atë edhe si vëzhgues i drejtpërdrejtë, ose si dëshmitar i dorës së parë i ngjarjeve të

çuditshme që zhvillohen rreth tij, dhe që i përshkruan në vepër: Shkurt, Shkrimtari e ka përthithur të drejtën e pashkruar të pastër e të kulluar nga burimi, por edhe të zbatuar drejtpërdrejtë në praktikë. Shembull i qartë është zakoni lokal i martesave brenda gjakut, i praktikuar në Gjirokastër, i cili përbënte largim thelbësor nga praktika e gjithëzbatuar e së drejtës së pashkruar shqiptare.

Pa hyrë thellë në analizë, natyrisht, Shkrimtari ka pikëtakime e dallime me gjurmuesin apo mbledhësin, ta quajmë, profesionist. Çfarë metodologjie ka zbatuar, për shembull Shtjefën Gjeçovi, në mblehjen dhe përpunimin e Kanunit të Lekë Dukagjinit? Ne dimë se ai ka mbledhur lëndën e së drejtës zakonore shteg në shteg nga goja e popullit. Mirëpo dimë, nga ana tjetër, se versioni i Kanunit, i botuar për herë të parë tek Albania e Konicës, ndryshon nga ai i botuar më vonë tek Hylli i Dritës. Pra, në thelb, edhe Kanuni i Lekë Dukagjinit, po t'i referohemi variantit që kemi sot të mbledhur nga Gjeçovi, përmban një element të pamohueshëm subjektiv. Çka na sjell tek Shkrimtari, tek i cili subjektivitetin e marrim të mirëqënë.

Ndryshe nga mbledhësi profesionist, roli i të cilit përfundon tek kodifikimi apo ngulitja në tekst e normave dhe kazuseve gojore të mblehdura, të drejtën e pashkruar Shkrimtari e vëzhgon dhe e përjeton. Kësajsoj, ai e përthith, e përpunon dhe na e transmeton atë artistikisht. Nëqoftëse mbledhësi i parë e shkëput të drejtën zakonore nga burimi gojor dhe na e ngurtëson atë në trajtën e tekstit, apo së shkruarës, shkrimtari, përmes lartësimit artistik të këtij ligji dokësor, e thith nektarin e gurrës dokësore dhe ia rikthen atë lexuesit - që në njëfarë kuptimi është vetë burimi gojor i produktit të mbledhur - jo si një kod i thatë nënesh dhe ligjesh, por si një kronikë e gjallë jete, dashurish dhe vdekjeje. Në vështrim krahasimor, Shkrimtari ngjan me gjykatësin në "common law", i cili vendimin e mbështet në faktet dhe provat, dhe e arsyeton të mbështetur në ligj, në parimin stare decisis apo precedentin gjyqësor, si dhe në një mori parimesh e doktrinash juridike të zhvilluara në shekuj.

5. E drejta dokësore tek "Breznitë e Hankonatëve"

Sikurse u përmend më herët, "Breznitë e Hankonatëve" është

I IDEJA

NGA BEN ANDONI

"Njeriu përdor pasqyrën të shikoj fytyrën, aman i duhet të përdorë veprat e artit që të këqyrë shpirtin e tij", thoshte dikur Bernard Shaw.

Po a mundemi vallë të shikojmë më në shpirtin tonë? Me gjërat që po ndodhin në Shqipëri është e pamundur. Marshi i antivlerave dhe i gjërave sipërfaqësore kanë marrë revansh të paparë dhe ato janë të pamundura të ndalen. Humori banal, muzika tallava, letërsia kitch apo arti në përgjithësi pa identitet dhe dorëzimi para politikës është një dhimbje e madhe.

Një adhurues i artit do t'i hidhte poshtë këto dhe do kujtonte se një i dashuruar pas artit dhe kulturës është i aftë të argumentojë se arti sjell bukurinë në mjedisin tonë dhe ofron raste për reflektim intelektual dhe emocional, thuhet në një nga referencat kulturore që mbushin almanakët teorikë, veçse në masë, sot, shqiptari jo vetëm nuk e vlerëson si duhet

Por a mundemi vallë të shikojmë më në shpirtin tonë? Me gjërat që po ndodhin në Shqipëri është e pamundur. Marshi i antivlerave dhe i gjërave sipërfaqësore kanë marrë revansh të paparë dhe ato janë të pamundura të ndalen. Humori banal, muzika tallava, letërsia kitch apo arti në përgjithësi pa identitet dhe dorëzimi para politikës është një dhimbje e madhe.

Në emër të artit dhe vlerave të pamundura në Shqipëri

por arrin dhe e ka relativizuar çdo gjë. Arti shikohet si i panevojshëm dhe i pavlerë dhe më shumë akoma: atë mund ta bëjë kushdo që ka pak miq në vendin e duhur, apo që një moment i mbushet mendja se mund të bëhet artist dhe më shumë akoma, ai që mendon se një femër e bukur asetin më të bukur estetik ka buzët e fryra dhe format e pshndjellëse me fotoshop.

Vite më parë, autori, në një intervistë me kantautorin e shquar Deda, këmbënguljes për shoqësimet që vuan artisti shqiptar mori këtë përgjigje: "Nuk ka sesi të mos vuajë, kur koncepti i të bërit muzikë sot, ndryshon kryekëput nga themeli i të bërit muzikë. Është një mishmash jo thjesht shijesh, por injorantësh që kërkojnë famë të shpejtë, pa pasur



as edukimin përkatës, as kulturën

përkatëse dhe mbi të gjitha me një shije turbo-tallavaje ballkanase shumë të rëndë".

Kjo të shkon ndërmend kur të rinjtë harxhojnë kohë e radhë në gjëra të komedisë së dobët, ndërsa mungon prezenca në shfaqjet e artit të vërtetë. Këtë e dëgjon me ditët e fundit kur dikush me krenari do përmendte "vuajtjen" e një filmi të fundit të Hollywood që mezi kishte shitur 25.000 bileta për gati tre muaj dhe një komedi vendase, e cila e kishte kaluar numrin e biletave në vetëm pak ditë.

A e dimë se ku po shikojmë? Po a e dimë vallë se ku jemi? Kemi frikë se në masën e komunitetit artistik kjo dihet shumë pak, pasi artistëve tanë u mungon ideologjia, ndërsa tashmë jo pak janë nënshtruar politikës dhe ar-

tit për art, ku mungesa e sistemit të vlerave dhe mungesa e moralit për t'i vlerësuar ka shkakuar hapësira pa fund. Dhe, ndodh jo pak herë, që artistët rishtarë janë mes luksit, ndërsa ata që kanë mbajtur artin shqiptar vuajnë apo përfundojnë me pensione qesharake saqë mezi mbajnë frymën. "Kur njeriu ka probleme me ekzistencializmin bazik të tij, arti është i fundit që do shikojë në rregullim", i thoshte Elton Deda autorit në të njëjtën intervistë. Për fat të keq helmi që është derdhur dhe mban shumë nga gjendet te artistët shqiptarë nuk rresht. Teksa rëndja pas çmimit dhe promovimit të pavlerës synon të uzurpojë gjithçka. Tek e fundit, kush nga ne do të shikonte te arti, atë zezonë që pasqyron shpirti ynë. (Milosao)

një kronikë shumëbrezëshe, ku përveç konfliktit anas - ardhës, ndërthurren e përplacen e drejta e shkruar me të drejtën e pashkruar.

Novela fillon me një gjyq për pronën - në njëjës, të Basri Hankanit I. Ajo mbaron me një gjyq për pronat! - në shumës, për të shfuqizuar testamentin e detajuar apo vakëfnamen e Basri Hankanit III.

Kryekrejtet dalin në pah disa institute dhe elemente të rëndësishme të së drejtës zakonore, siç janë kufiri, besa e rreme, opinioni publik etj.

Le ta nisim, së pari, me një "zakon të lashtë...me prejardhje nga shoqëria fisnore", d.m.th. me martesën me kunatën. Studiuasi Kahrman Ulqini, që e analizoi atë kryesisht sipas praktikës së dokeve të veriut, e kategorizon në dy trajta: (i) martesë e burrit me gruan e vëllait të vdekur; ose (ii) martesë me motrën e gruas së vdekur. Mirëpo zakoni është mbarëshqiptar, duke dëshmuar sërish njëjësinë e së drejtës dokësore shqiptare. Shkrimtari na e përcjell këtë përmes veprës artistike. Tek Hankanatët zakoni e lashtë e hasim në brezin e tretë: Basri Hankanit II, djali i Hatibit, martohet me Selmanë, vajzën e hallës, Shanos. Rravgimin e bujshëm nga norma e përgjithshme dokësore Kadareja na e shpreh kështu: "Martesat midis kushërinjve të parë, për shkak të moscopëtimit të pasurisë, nuk ishin të pazakonshme në Gjirokastër". Porse pasojat do të ishin krejt të pazakonshme...

Të analizojmë më tej institutin e kufirit, që sipas Margaret Hasluck, kishte rëndësi thelbësore në të drejtën zakonore shqiptare. "Kufini ngulet njëherë e përgjithmonë"; "Kufini që dihet, s'luhet ma"; "Kufiri nuk preket; Ligji e sheh ndryshimin e kufirit si dhunimin



risi krahinore, ose më saktë, qytetëse. Në Gjirokastër e Hankanatëve atë e hasim në brezin e tretë: Basri Hankanit II, djali i Hatibit, martohet me Selmanë, vajzën e hallës, Shanos. Rravgimin e bujshëm nga norma e përgjithshme dokësore Kadareja na e shpreh kështu: "Martesat midis kushërinjve të parë, për shkak të moscopëtimit të pasurisë, nuk ishin të pazakonshme në Gjirokastër". Porse pasojat do të ishin krejt të pazakonshme...

Të analizojmë më tej institutin e kufirit, që sipas Margaret Hasluck, kishte rëndësi thelbësore në të drejtën zakonore shqiptare. "Kufini ngulet njëherë e përgjithmonë"; "Kufini që dihet, s'luhet ma"; "Kufiri nuk preket; Ligji e sheh ndryshimin e kufirit si dhunimin

Pse është aktuale "Breznia e Hankanatëve"

E parë me dritën e sotme, e drejta zakonore shqiptare, e përcjellë përmes veprës madhore të Kadarese "Breznitë e Hankanatëve", si dhe ndërthurja e saj me të drejtën pozitive, ka çuditërisht rezonancë aktuale.

Nëse krahasojmë këtë "lesharap gjyqesh", siç e quan Kadareja, apo konfliktet anas - ardhës shoqëruar me përplasjet e sotme të jashtëzakonshme për çështjet e pronave në Shqipëri, nuk mund të mos vëmë pyetjen nëse hiya apo fantazma e "bërrejshtit" Basri Hankoni është e gjallë dhe shtruar këmbëkryq sot e gjithë ditën tek palët ndërgjyqësore shqiptare.

më të madh: kufiri është i shenjtë", theksohet tek Kanuni i Lekë Dukagjinit dhe Kanuni i Skënderbeut. Konfliktet për kufirin mund të ishin veçanërisht të përgjakshme, duke cenuar rëndë rendin shoqëror dhe ekonomik në malet shqiptare.

E pra, i gjithë thelbi i konfliktit të parë, por edhe atyre të lindur në breznitë e mëpasme të Hankanatëve, ishte lufta për më shumë pronë, që në në vetvete ishte luftë për kufirin.

Përmendim shkarazi edhe aspektin e lashtë procedural sipas të cilit gjyqet bëhen vetëm në mëngjes, dhe jo pasdrekë. Edhe bëja e 20 marsit 1703 tek Ara e Mullenjave u bë në mëngjes.

Le të përqendrohemi tek akti i bësë së rreme. Siç na përshkruan Kadareja qysh në fillim të novelës,

Basri Hankoni ngjau shojet e këpucëve me baltën e arës së vet në kufi me Arën e Mullenjave dhe, kur kadiu me sekretaren, që qëndronin në mes të arës, e ftuan të betohej mbi Kuran, pa ia bërë syri tërr, ai tha: "Betohe mbi këtë kuran të shenjtë, se balta që është nën shojet e mia është toka ime".

Betimi mbi librin e shenjtë është një ndër llojet e bësë sipas Kanunit. Për "kufijt e harruem", "Kanuja e hershme njeh benë" me gurë në krah". Në rastin tonë, në mos ishin të harruar, kufinj të ish-sigurisht të diskutueshëm. Megjithatë, për shkak të shartimit juridik të kohës, bëja me gurë në krah ia la vendin bësë mbi kuran.

Në Kanunin e Lekë Dukagjinit hasen edhe llojet të tjera bësë: (i) bëja mbi kryet e fëmijës; (ii) mbi bukë e krypë; (iii) mbi zjarrmin e votrës; (iv) me gurë në krah; (v) mbi vorret e pleqve. Edhe bëja e Motmotit, një ndër më të rëndësishmet në malet shqiptare, bëhej "me gurë në krah".

Mirëpo betimi, si proces, nuk ishte aspak veprim rutinor. Bëja, apo akti në themel të procedurës së betimit, me Kanun "...asht gjë e shejt". Madje, "bëja e rrejshe heret e vonë e vret të zonë". Pason, pra, ishin më shumë se morale dhe fizike. Ato mund të ishin fatale. Ishte njëfarë sentence apo dënim universal, që "Bërrejshtmi i humb të gjitha", siç sanksiononte Kanuni.

Këtu dalim papritur tek roli i opinionit publik, i cili është i pranishëm gjerësisht në veprën e Kadarese. Ai është si personazh misterioz herë i padukshëm, që shfaqet herë përmes frazave të tilla si: "thoshin njerëzit", "në qytet filluan ta thërritnin"; ose herë me variante të foljeve "thuhej", "fitej" "pëshpëritej"; apo veprimeve të

→ Vijon nga faqja 15

lidhura me emra e kategori të tjera gramatikore, si "njerëzit", "tregimtarët", "të gjithë" etj. Dënimi i parashikuar në Kanun përcillet - edhe pse heshturazi - pikërisht përmes opinionit publik.

Në këtë rast, opinioni publik merrte përsipër rolin e njëfarë arbitri kolektiv apo jurie, e cili gjykonte e dënonte përmes mjetit më të çuditshëm dhe, pse jo, edhe të efektshëm, heshtjes. "Mjerë ata ç'i gjeti, thoshin", ku opinioni publik shprehte keqardhje për fatin e Fatri Hankonit, fëmijës idiot të lindur nga martesë midis Basri Hankonit II dhe Selmasë, të dy kushërinj të parë.

Heshtja, pra, është mënyra me të cilën opinioni publik ballafaqohet me shkelësin. Diskutimet - njëloj si debatet e brendshme (deliberare) të jurive gjyqësore - qartë-



fituesve të pandershëm, bashkë me pasardhësit e tyre, njëloj sikurse e pësuan në fund vetë Hankonët me marritë, mallkimin ndër dhe mbarëbrezor; dhe fatin e zi të tyre.

Bibliografi e pjeshme

Aaron Xavier Fellmeth, Maurice Horéitz, Guide to Latin in International Law
Alan Watson, Ancient Law and Modern Understanding - At the Edges, The University of Georgia, Athens and London, 1998
Davis Report, Le primer report des cases & matters en ley resolues & adiudges en les courts del Roy en Ireland. Collect et digest per Sr. John Dauys Chiualer Attorney General del Roy en cest realm
E Drejta Zakonore Shqiptare, I, Kanuni i Lekë Dukagjinit, Tiranë, Akademia e Shkencave të R. Shqipërisë 1989
Fjalori i Gjuhës Shqipe, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 19
Floresha Dado, Lexuesi "në kurth", eseistika e Kadarese, Tiranë, 2016
Fritz Kern, Kingship and Law in the Middle Ages, translated with an introduction by S.B. Chrimes, Basil Blackwell, Oxford, 1948
Ismail Kadare, Dialog me Alain Bosquet, Onufri, bot. IV,
Ismet Elezi, E drejta zakonore e Labërisë

E drejta dokësore shqiptare te "Breznitë e Hankonatëve"

sojnë e ngurtësojnë qëndrimin e kësaj mase të pacaktuar qytetare ndaj ngjarjes apo veprimit të shkelësit. Por ndryshe nga juritë e zakonshme, që verdiktin e shpallin publikisht, vendimet e bashkësisë gjyqësore do të mbeten brenda për brenda kuadrin të opinionit publik, dhe nuk i shpallen apo nuk i përpallen në fytyrë shkelësit. "Basri Hankoni s'do të bënte kurrë prokopi me atë mall harram" "pëshpërisnin" "njerëzit që e dinin punën e besë së rreme".

Arma tjetër në arsenalin e opinionit publik ishte leçitja, d.m.th. izolimi i përgjithshëm e absolut që i bëhej dhunuesit të zakonit, duke mos i shkelur në shtëpi.

Heshtja dhe një formë e leçitjes u shfaqën papritmas si sanksione përmbi brezninë e pestë të Hankonatëve, pas vetëvrasjes së pleqve Çanatë, natën e Vitit të Ri, ngaqë "s'kishin t'u kthenin Hankonatëve borxhin e dyfishuar nga fajdeja". Sikurse përmendim tjetërkund, fajdeja ishte e ndaluar me kanun. Mirëpo Hankonatët e kishin shkelur këtë dispozitë të së drejtës zakonore. Dënimi i opinionit publik ndaj këtij veprimi të Hankonatëve nuk vonoi. Ai u shfaq në trajtën e një "vale inati shurdhan kundër tyre" në mbarë qytetin. Ishte njëfarë hibridi midis heshtjes dhe leçitjes. Përveç dëimit nga vendbanimi, i sanksionuar sipas rastit të skajshëm nga pleqësia, dënimi me heshtje nga ana e opinionit publik ishte më i ashpër. Paralelizmi me ligjin e lashtë dhe të mirë nuk mund të jetë më i afert. Lex është mutus magistrus - ligji është veç një gjykatës i heshtur, shprehej Ciceroni shumë shekuj më herët... Ligji, si shprehje tekstuale e heshtur, e pa shpirt, dhe që merrte frymë e jetë nga opinionin i pleqnarit apo gjykatësit, tashmë përdorte si ndëshkim pikërisht heshtjen.

Opinionin, po ashtu, vepron si njëfarë "standardi" sjelljeje shoqërore dhe juridike. Në këtë

drejtim, Gjirokastra e fundit të mesjetës në botën dokësore shqiptare, dhe më konkretisht, instituti i "opinionit publik" sjell, çuditërisht, pikëtakime me institute thelbësore në të drejtën krahasimore, siç janë bonus paterfamilias, apo reasonable person.

Opinionin publik thërret në vëmendje krahasimisht korin në tragjeditë e lashta antike greke. Interkulturaliteti, tipar par excellence, i fushës të së drejtës, vepron në një këndvështrim, përmes interpretimit që lexuesi i bën tekstit. Lexuesi vendoset përball dilemës së arsyeshme se si do të reagonte dhe si do të vepronte ai vetë përball veprimeve në shkelje të normës dokësore të Basri Hankonit dhe pjestarëve të tjerë të familjes.

Nëse rrotën e madhe të kohës e rrokullisim me 200 vjet më pas, Basri Hankoni i tretë, e ndjente se mbante mbi ndërgjegje peshën e pabesive dhe krimeve të paraardhësve të vet. Qarku, tashmë, ishte mbyllur. Béja e rrejtshme ishte takuar me fatin e vet të pashmangshëm e të pamëshirshëm. "Mëkati fillestar", ishte vërtetuar madje edhe me zbulimin e "corpus delicti", ose me këpucën e përdorur atë ditë marsi të vitit 1703, të gjetur disa breza më pas në sterëne e shtëpisë së Hankonatëve.

Basriu i fundit do të përshkruante kësaj tri "krimet" e brezive të Hankonatëve:

Së pari, béja e rreme;
Së dyti, vrasja e Roksanës - çka sjell në vëmendje institutin dokësor të gjakut dhe të nderit, të shpërfytyruar tek veprimi i dyshuar i Hankonatëve;

Së treti, vetëvrasja e pleqve Çanatë, nga fajdeja të cilën nuk mund ta paguanin.

Në krye, natyrisht, Basri Hankoni i tretë do të vinte bënë e rreme! Tejet tragjikisht, por jo fare papritur, 200 vjet dhe gjashtë breza më vonë, Hankonatët vuani,

pra, pasojat e "mëkati fillestar", bejës së rrejtshme të Basriut të parë. Si retë e murrme mbi Malin e Gjerë, ajo bëu undenji mbi kokë brez pas brez.

6. Përfundim

"Nuk ka nder më të madh për shkrimtarin sesa të arresohet për një roman të tijin", përmendte Kadareja para ca kohe. Të burgosesh për të shkruar është ndofta aspekti më i skajshëm, quasi tragjik i marrëdhënies së shkrimtarit me ligjin, ose më mirë, me peshën e pamëshirshme të tij në diktaturë. Përndryshe, marrëdhënia e shkrimtarit me ligjin në demokraci është më e hapur, më transparente, më ndërkomunikuese e me përfitim të ndërsjellë.

Nëse raporti i shkrimtarit me ligjin pozitiv në diktaturë është i ngurtë e i shtangët, raporti midis tij me të drejtën zakonore është i lirshëm, dinamik. Në njëfarë mënyre, trajtimi artistik i së drejtës dokësore në diktaturë është si rreze shprese e dritë lirie në errësirë. Marrëdhënia shkrimtar - e drejtë dokësore luhatet midis xhenies së korpusit të saj përmes ngulitjes në tekste të dokeve e sulleve të qëmtuara nga të tjerë, dhe mbrytjes artistike përmes përvajave individuale jetësore. Dhe pikërisht, tek takimi i dokësore me tekstin fillon edhe shkëputja nga ky i fundit, çka na vjen me anë të transformimit artistik, dhe ngulitjes së krijimtarisë si fikson në veprën letrare. Edhe garku i krijimtarisë tashmë mbyllet: e drejta zakonore u vol dikur prej mbledhësit nga goja e popullit, drejtëpërdrejt në gurrë, për t'u kthyer artistikisht lexuesit, d.m.th. burimit, përmes Shkrimtarit. Atë çka mbledhësi e merr; në një pikëpamje Shkrimtari e kthen.

Kjo dinamikë e çuditshme intertekstuale, e luhatur midis sulleve kuvendore dhe normave kanunore, kazuseve si precedentë gjyqësorë të pleqnarëve, rolit të opinionit publik përmes stan-

dardit juridik të "reasonable person", dhe prurjes fiksonale të shkrimtarit, nuk parakupton aspak që shkrimtari dhe mbledhësi profesionist arrijnë konkluzione diverguese në vëzhgimet e tyre. Përkundrazi. "Kodi i vjetër zakonor shqiptar...ngjan çuditërisht demokratik", vëren me mprehtësi Kadareja. Krahasimisht, Margaret Hasluck, studiuesja dhe gjurmuesja e shquar britanike, do të shprehej se "...vetëqeverisja e malësorëve të Shqipërisë ishte shumë pranë konceptit të demokracisë së vërtetë...Në mënyrën e vet të mirëfilltë ajo ishte qeverisje e popullit, nga populli, për popullin".

E parë me dritën e sotme, e drejta zakonore shqiptare, e përcjellë përmes veprës madhore të Kadarese "Breznitë e Hankonatëve", si dhe ndërthurja e saj me të drejtën pozitive, ka çuditërisht rezonancë aktuale.

Nëse krahasojmë këtë "lesharap gjyqësor", siç e quan Kadareja, apo konfliktet anas-ardhës shoqëruar me përplasjet e sotme të jashtëzakonshme për çështjet e pronave në Shqipëri, nuk mund të mos vëmë pyetjen nëse hijja apo fantazma e "bërrejshmit" Basri Hankoni është e gjallë dhe shtuar këmbëkrqy sot e gjithë ditën tek palët ndërgjyqësore shqiptare.

Me të vërtetë, nëse pranojmë se e vërteta është një, dhe të tilla e të mirëpërcaktuara janë edhe sinoret, apo kufinj të trojeve a pronave, dhe nëse mbajmë parasysh se dy ose më shumë palë pretendojnë të drejtën apo të vërtetën, atëherë mund të themi se béja e rreme, ashtu si atë mëngjes mitik të 20 marsit 1703, fatqegjësish vazhdon të ushtrohet sot e gjithë ditën nga paditës e të paditur shqiptarë. Pyetja që mbetet është nëse pasojat e këtyre "mbrapëshinave", në shkelje të plotë të së drejtës së sotme pozitive dhe asaj të lashtë të pashkuar, do të vërtiten dikur përmbi fatet e pretenduesve a

në planin krahasues, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 1984

Ismet Elezi, E drejta zakonore e Labërisë, Tiranë, 1994

Kanuni i Lekë Dukagjinit mbledhur nga Shtjefën Gjeçov, Gjonleka, New York, 1989

Margaret Hasluck, The Unwritten Laws in Albania, Cambridge University Press

Peter Goodrich dhe Yifat Hachamovitch, Habes Corpus: A semiotic analysis of common law cartographies, tek Tracing the Semiotic Boundaries of Politics, Edited by Pertti Ahonen, Mouton de Gruyter, Berlin, NY, 1993

Pëllumb Xhufi, Arbërit e Jonit, Onufri, 2016

Xhemal Meçi, Kanuni i Lekë Dukagjinit. I Varianti i Pukës, Botimet Çabej MÇM, Tiranë, 1997

Xhevat Lloshi, Parathënie, e veprës së Ismail Kadarese, Breznitë e Hankonatëve, "Onufri", Tiranë, 2000.

Artikuj

Abaz Dojaka, Disa udhëzime për mbledhjen, sistemin dhe studimin e së drejtës zakonore, Etnografia Shqiptare, Akademia e Shkencave, Vol. VII-VIII, Tiranë, 1976, f. 277.

Abaz Dojaka, Doka e zakone ndër shqiptarët në Mesjetë dhe në kohë të sotme, Etnografia Shqiptare, Vol. 13, 1983

Ani Kokobobo, The "Curse" of Eastern Bloc in Ismail Kadare's "Elegy for Kosovo", Ullbandus Revieë, 1.1.2010, Vol. 13, ff. 79-93;

Charles Johnson, the Land of the Blood Feud, Harper's Weekly, 1913, Vol. 57

Elvira Lumi, The Traditional System of Justice in the Ismail Kadare's Novel, International Journal of Arts and Sciences, 2011, 4(14), ff. 197 - 209;

Kahreman Ulqini, E drejta kanonike shqiptare përballë së drejtës kanonike dhe shariatit, Etnografia Shqiptare, Vol. 16, Akademia e Shkencave, Tiranë, 1989

Mirjona Sadiku, The Origins of the Kanun, Exploring the Development of the Albanian Customary Law, Balkan Arastirma Enstitüsü Dergisi, Dec. 2014, Vol 3 (2), ff. 77-95;

Pal Doçi, Rreth disa çështjeve të së drejtës së malësisë, Kultura Popullore, 1/1991, f. 169

Persida Asllani, Kanuni në prozën shqipe: miti i përshkët "i shenjtërimit", Studime Filologjike, 2008, 1-2, ff. 37-50;

Sandra F. Joireman, Aiming for Certainty: the Kanun, blood feuds and the ascertainment of customary law, the Journal of Legal Pluralism and Unofficial Law, May 2014, ff. 1-14;

Revista "Ylli", 1965, Nr. 6

Kazuse

Healthcare at Home Limited v The Common Services Agency [2014]

*Autori është studiues në Universitetin e Massachusetts-it në Boston

...nga numri i shkuar

"Milosao" e këtij numri ishte e mirë, por pak si shumë patetike. Lamë dy argumente kryesore, ku njëra i dedikohet aktorit të madh të botës gjermanike me origjinë shqiptare Aleksandër Moisi. Paradoksi ishte se autori i një libri, që po përgatitet për të, na premtoi se do të sillte materiale të panjohura për të, ndërsa na përcollti një intervistë të vetën shumë patetike dhe të fryrë. Një auto-intervistë, që u mundua ta modifikonim.

Argumenti i dytë i kushtohet dokumentaristit të njohur Endri Keko, që e pamë përmes një këndvështrimi të redaktorit dhe pastaj dhe ditarit të tij, që dukej si shumë i kuruar. Në fakt, Endri Keko ka shumë vlera për atë që ka lënë si dokument të asaj kohe, veshur kuptohet me ngjyresat e propagandës.

Edhe në këtë numër nuk mungoi Sami Frashëri, një Rilindas që është harruar krejtësisht dhe që e sollëm me bashkëpunimin e Kujtim Nuros, një nga osmanologët më të mirë në vend me një kontribut të jashtëzakonshëm. Ai ka sjellë shkrimin e gazetarit të mirënjohur turk Hikmet Feridun Es, në gazetën "Aksham" (Stamboll), Dhjetor 1944-Janar 1945 me titull: *Personalitetet e famshme që*



nuk i njohim- Shemseddin Samiu - Një gjigand mendimtari, të cilin nuk e njohim aspak (Arkivi i Taha Toros - Universiteti i Qytetit të Stambollit). Në numrin e shkuar thamë se shkrimi do shtrihet në dy numra, por nuk ndodh kështu, për shkak të shkri-meve kilometrike që kemi. Dhe, një problem, jo i pakët: Shkrimi është krejt me "e", që redaktori me kohën e pakët që disponon nuk i rregullon dot.

Redaktori vendosi në këtë numër një shkrim për piktorin Anton Panarit, ku u përmend se piktori ndër vite ka ndryshuar dhe sidomos përmirësuar jo vetëm idetë dhe perceptimin e materies, por edhe teknikën dhe sidomos disiplinimin para idesë dhe i vlerësuan ngjyrën.

Inis Jorgo, një autore që jeton jashtë vendit, pas një pritje jo të vogël erdhi me tre poezi, ku melankonia e një jete tjetër, larg vendit, është një nga motivet që kaplon autoren, sipas redaktorit, që futi pak nostalgji në këtë përshkrim...

Në përgjithësi ishte një numër shumë patetik, por edhe me cilësi, ku layout nuk punoi aq mirë, kjo edhe për mungesë bashkëpunimi të duhur me redaktorin.

Po vijojmë pjesën e tretë me shkrimin e një gazetari turk, i cili përshkruan jetën e Sami Frashërit, përgatitur nga Kujtim Nuro, një osmanolog i shkuar. Hikmet Feridun Es e ka botuar në gazetën "Aksham" (Stamboll), dhjetor 1944-janar 1945 me titull: *Personalitetet e famshme që nuk i njohim- Shemseddin Samiu - Një gjigand mendimtari, të cilin nuk e njohim aspak* (Arkivi i Taha Toros - Universiteti i Qytetit të Stambollit).

P

PERSONAZH


Jeta e përkorë e Sami Frashërit

NGA HIKMET FERIDUN ES
DHE KUJTIM NURO

Vijon nga numri i shkuar

Në asnjë vend nuk shkonte. Mjekrën do ta rregullonte vetë. Ana më e veçantë e trupit të Samiut, është mjekra e tij e bardhë.

Pjesa, e cila binte në sy në trupin e Samiut, i cili në jetën e tij nuk piu asnjë cigare, që ndodhej e madhe, në gjendjen e një bishti të luanit, është mjekra e tij krejt e bardhë. Duhet theksuar se mjekra e tij vinte një e bardhe me të vërtetë e bukur. Dhe atë, përveç kohës që ishte djalosh, përveç kohës së femijërisë, askush nuk e kishte parë pa mjekër. Kjo mjekër e tij, të cilën dijetari i madh e donte aq shumë, ka dhe një histori tërheqëse. Samiu, atë nuk e ka prerë asnjëherë. Me fjalë të tjera, në kohën që po kalonte nga mosha e femijërisë në atë të djalerisë, kur mjekra kishte filluar t'i rritej, kur nuk vendosi një bisturi. Me vone, duke u rritur, u bë e bardhë. Ne kete menyre, Samiu nuk e ka prerë kurrë mjekrën dhe kurre nuk ka vendosur një brisik në lekuren e tij. Nga dita, e cila filloi t'i dale perhere te pare deri ne fund te jetes se tij, ngaqe nuk e preu, mjekres se tij te bukur i tregoi një kujdes te madh. Qimet e saj derdheshin plotesisht poshte. Per te mos iu ndare nga koha e te shkruarit, kur dilte nga shtepia, aspak nuk shkonte tek berberi. Ai e rregullonte ate me doren e tij, e priste me gershere, i jepte asaj formen qe dëshironte. Kete mjekër, asnjë dore tjetër nuk e kishte prekur: Gjate 20 - 30 viteve te fundit, Samiu, nuk ka shkuar tek asnjë berber. Cdo menjëgjës, me tu ngritur, e lante koken me uje te bollshem dhe mjekren me shume shkume. Dhe pastaj koken, fytyren dhe mjekren e bardhe si debora me uje. I thante ato me peshqir te ashpër dhe perseri ulej te shkruante.



Samii Frashëri në kohën që ishte 40 vjeç, tregonte se ishte në moshën 80-vjeçare. Gjatë natës, në mënyrë kategorike nuk mbulohej me jorgan. Jorgani dhe velenja ishin armiku i tij. Në të gjithë jetën e tij, nuk është parë, bile edhe njëherë me robdishan. A ka zjarr? Tregimi i macës me ngjyre te perhimte. Pandoflat, te cilat i veshi 11 vjet. Mbas shkrimit, një gote konjak. Shkalla e nderimit ndaj librit. Femije, i cili nuk luajti asnjë loje.

Ne kete shkrim, do te vecojme disa vecori me vlere dhe me interes te dijetarit te madh te gjuhes. Sami Frashëri, mbasi punonte gjithë ditën, natën terhiqte në dhomen e fjetjes dhe qendronte atje. Është periudhe dimri dhe debora bie pa ndërprerje, por ne krevatin e Samiut, nuk ka asgjë, se ciles, ne i japim emrin "jorgan". Samiu, ne te gjithë jeten e tij, bile ne dimrat me te ftohte, ne menyre kategorike, nuk është mbuluar me jorgan. Kundershtia e tij per jor-

ganin ishte e njohur per te gjithë familjen. Ai që është ndaj atyre, te cilet e konsideronin jorganin si një "parajsë" te ngrohte. Jorganin nuk e donte aspak. E quante ate si një gje per te qeshur dhe rendese te panevojshme, qe nuk te ngrohte aspak. Me fjalë te tjera, ne ate periudhe, megjithese secili vishte xhupa leshe dhe me pambuk, ai e urrente ate. Samiu, i cili thoshte se jorgani me pambuk nuk do ta ngrohte ate, mbulohej vetem me batanije. Simbas stines, keto batanije fillonin nga një dhe shkonin deri dytre, bile, ndonjëhere akoma me teper. Nga qe ishte një person me shendet jo te mire, soba, e cila, ndodhej ne dhomen e tij, ne cdo ore te nates, do te qendronte e ndezur. Perkundrejt asaj, i cili nuk donte rroba pambuku, do te perdorte rroba leshe.

NDOSHTA KINI TE DREJTE, POR...

Samiu, megjithese ishte njeriu më me edukatë, me njerezori i botes, kishte një "inat" mjaft dashamires, te bute. Degjonte me një dashamiresi dhe miresjellje te madhe dhe ndonjëherë gjate-gjate me ore te tera personin, i cili ishte perballe tij. Nuk ngrihej dhe ne fund te bisedës thoshte: Ndoshta zoteri kini te drejte, por une mendoj kështu. Por, dashamiresia e tij nuk i ka "sakrifikuar" aspak mendimet e tij. "Kokefortesia" me një dashamiresi te thelle, i kishte rilindur, i kishte dhene ne jeten e tij dhe ne pune, një energji te madhe. Per te treguar se ne cfare shkalle ishte miresjellja, dilekatesa e tij, mund te perdorim kete shembull: Ne kohen qe ishte me i zemeruar, me i nevrikosur, fjalët me te renda ndaj atij qe kishte perballe ishin: Te kini shume turp. Keto fjale ishin mjaft te njohura dhe Samiu i perdorte shume rralle.

A KA ZJARR ?

Ne shtepine e madhe, ishin marre disa masa, nga qe Samiu, ne një zhurme me te vogel, me te pa-perfillshme, nuk mund te shkruante. Zakonisht, te gjitha zerat, te cilat mendohej se nga mund te vinen, ishin marre masa qe te mos ndegjoheshin, sepse dijetari, i cili punonte gjithë ditën, kerkonte një qetesi absolute. Ndonjëhere, ne kohen qe shkruante, nga qe dera e dhomes se tij qendronte e mbyllur, macja e dashur e tij, macja me ngjyre te perhimte, do te qendronte jashte. Kjo mace, ishte si ulla mi i romancierit Hysen Rahimit, dhe ne kohen qe Samiu shkruante, ajo shtrihet ne kembet e tij. Te gjithë mendimetaret e medhenj e donin shume kete kafshe me ngjyre hiri. Kur macja e perhimte qendronte jashte dhe me te ndjere qe Samiu fillonte te punonte, ajo fillonte te gervishte deren e dhomes se dijetarit. Kështu, ne shtepine kaq te madhe, e vetmja zhurme, kjo do te ishte. Autori i fjaloreve te medhenj, ne kohen qe shkruante kapitullin me te rendesishem, me te degjuar kete shenjë te maces, do te ngrihej menjëhere dhe do te hapte deren. Atehere, macja e perhimte do te mjaullinte dy-tre here dhe menjëhere do te nderpriste zerin mjaullues, duke parandjere, qe shkenctari do t'i thoshte: "hesht!". Ulej ne minderin e punes se Sami Frashërit, ne le-tren e dorshkrimeve me ngjyre blu, te cilën Samiu e vendoste mbi gjundje dhe mbas kesaj, macja do te shtrihet mbi kembet e tij. Mbas një - dy minutash, perseri ne dhome, pervec gervishtjes se vecante te penes, nuk degjohej ze tjetër. Bile, kjo mace e perhimte, ashtu si e kishte ndjere qe Samiu nuk e pelqente vehten, me te mbaruar ai shkrimin, do te drejtohej dhe do te fillonte te mjaullinte. Ne, lidhur me kete i benim shenjë qe Samiu du-

➔ Vijon në faqen 18

→ Vijon nga faqja 17

hej te punonte ne një qetesi te thelle, te cilit i duhej ta kishte. Shihnim qe dhe nga gervishtja e dyerve nga ana e maces do te shqetesohej dhe nuk mund te punonte dot. Dhe vehte ai, ne kohen qe nuk punonte, do te levizte ne te njëjten menyre. Psh: Ne menyre kategorike nuk fliste shpejt. Njëhere nuk është degjuar qe te bertiste ne shtëpi. Nuk qortonte asnjë. Atyre qe flisin shpejt ne shtëpi, ata qe zbrinin nga shkallet duke bere zhurme do t'i pyeste me një miresjellje te madhe: A ka zjarr? Me kete autoritet miresjelljeje ne shtëpi ishte krijuar një qetesi e thelle. Bile dhe femijes me te zhurmshem do t'i thoshte: A ka zjarr?

NE TE GJITHE JETEN E TIJ, ASKUSH NUK E KIShte PARE ATE ME ROBDisHAN

Ne folem me lart per macen e perhimte, e cila perkedhelej mbi kembet e Samiut, ne kohen qe ai shkruante fjalorin, por dhe macet me emrat "Sari", "Nazli", shtriheshin mbi kembet e Hyseyin Rahimit, kur ai shkruante romanin. Kemi hasur shume raste te tjera per kafshet me ndjenja te thella ne jeten e dijetareve dhe artisteve te Lindjes. Një dite vere, macja e perhimte, dite e 5 Qershorit 1904, humbi nga shtëpia, sepse Sami Frasher kishte nderruar jete. Ai ishte një njëri mjaft i sinqerte. Por, njëkohesisht, nuk mund te duronte gjestin me te vogel ne shenjé mosrespekti ndaj tjetrit. Psh: ne te gjithë jeten e tij, ne shtëpi, femijet qe i donte me shume, qofte dhe një dite, nuk e kane pare ate te ecte ne shtëpi me robdishan nate. Bile, femijet nuk e dinin qe babai i tyre vishte robdishan. Samiu, kishte bere një veshje te vecante ne shtëpi, plotesisht per vehten e tij. Gjate veres, kjo veshje ishte një kemise, jaka e seciles ishte e mbyllur, me kordon terheqes. Jaka e kemishes, gjithmone qendronte e mbyllur dhe e kopsitur. Pandoflat, te cilat perdorte ne shtëpi, ishin te mbyllura mbrapa. Kurse gjate dimrit vishte një pallto, e cila te kujton pardesyne me ngjyre te zeze, shume te gjate ose tallaganin. Perseri, ne kembet e tij, pandofla si skarpin, kepuce te lehta. Samiu keto pandofla i ka mbahtur per njëmbëdhjete vjet, bile dhe akoma me tepër.

NJE GOTE KONJAK

Ne pame sesi ai punonte ne gjendjen e nje motori mendimtari. Afer mbremjes, duke arrdhur ne pushimin e tij, brenda nje gote shume te vogel, ai do te pinte vetem nje teke konjak "Omurca". Prane gotes se vogel te konjakut, qendronte nje kub i vetem sheqeri. Shumicen e rasteve, sheqerin e hidhte brenda gotes dhe deri ne kohen e ngrenges do te fliste. Ndermjet kohes se grenjes dhe gotes se konjakut do te pinte nje gote caji. Gjate periudhes se dimrit, ne ditet e ftohta, ky caj, ashtu si ne mengjes, do te sillej ne gjendjen e poncit. Kurse gjate diteve shumete nxehta te veres, ndonjëhere zgjatej deri ne Ciftehavuz. Atje do te pinte vetem nje gote birre me shume. Ja ne jeten e tij, nuk dinte dhe nuk ka luajtur asnje loje, deri dhe ne lojen me te thjeshte, ate te lojes me letra. Bile, ne kohen qe po pergatiste fjaloret, nga qe nuk donte te bente gabime ne fjalet lidhur me lojrat e tilla, i kushtonte shume vemendje. Me e vecanta, femijeve te tij do t'iu spjegonte keto: Une dhe ne femijerin time nuk dija te luaja lojrat e ditura te femijeve as ate me top, as lojen me balona, dhe asnje loje te ketij lloji. Po, drejtpersedrejti, Samiu i vogel, vehten e tij ia kishte kushtuar leximit. Ne kohen qe tek ai po formoheshin tiparet, karakteri i tij, ne pame qe tek ai kishte hyre nje ndjenje e re e shenjte, e respektit ndaj librit. Ai nuk mund te toleronte, ne menyre kategorike hapjen e librit duke perthyer cepat e faqeve me nje dore te pakujdesshme, te ashpër. Dhe nga qe nuk ishte nje njeri qe bertiste, ai do te dilte jashte. Do ta merrzimisn mjaft librat qe shiteshin te palidhur, duke thene: do te shiten ne kete menyre? Le te humbasin faqet e tyre? Dhe ai qepte vehte personalisht.

Vijon

P

POEZIA

NGA VLADIMIR HOLANÓ

HOROSKOP

Mbrëmë herët... Varrezë... Dhe era, porsi hanxhar eshtërrhëmues kasapi që në thetore copëton.

Nën torturën tronditëse, prej kallëpit shkundet ndryshku.

Dhe mbi gjithçka, përmbi lotët e turpit lëshuar, ylli pothuajse ka vendosur të rrëfejë se e kuptojmë thjeshtësinë vetëm kur zemra thyhet, dhe befasi bëhemi vetvetja, vetmuar dhe pa shpresë.

FËMIJA

Me veshët në shina, një fëmijë po përgjon trenat. Përhumbur nën zhurmërimën e kudohapur, pak vlen nëse po vjen treni apo është duke shkuar. Por ti gjithmonë ishe në pritje të dikujt, përherë duke u ndarë nga dikush, deri kur veten gjete dhe s'je më kund.

VDEKJE

Prej vetes e zbove shumë vite më parë, hapësirën e kyçe, u orvate të harrosdh gjithçka. E dije që në muzikë s'gjendej, ndaj këndove, në heshtje e dije që s'ndodhej, ndaj s'bëzate, e dije që s'qe në vetmi, ndaj vetëm qëndrove. Po sot, ç'të ketë ngjarë: a je ti që befasi, mesnatës vëren një përshkënditje nën derën e dhomës përballë, prej vitësh banuar nga askush?!

TRASHËGIM

Çfarë poetët lënë pas gjithmonë diçka e vranë është nga koha, krimi, dëbimi. Më i vërteti nga ata, më pak i njohuri, i heshturi dhe më i dashuri në ty nuk ndryn asgjë: as prej imazhit të tij, as përçmim e as mëshirë, më pak i dashuri. Dhe sot ai mungon. Edhe Pikaso, një plak borë kur ngrinte, fare mirë kuptoi që pavdekësia e artit në kohë qëndron, në krim, dëbim, që dielli duhet në lot t'i shpërbëjë: pranvera, lumenj, dete e hijë.

PËRSHKRIM

Një natë dhjetori, gotën mbush me verë dhe dhomës tjetër iu drejtove për një libër. E përgjysmuar ishte gota kur u kthevë. Ishë i frikësuar dhe nën një zë të shkërmoqur e të çartur pyete se kush mund ta kishte pirë, qyshse i vetëm ti rron, ndryrë mureve të gurit dhe gjembaçëve të egër e mes një panjerëzoreje, prej nga kohë më parë statujat përzure, kimerat dhe fantazmat.

NËNA

A e ke parë ndonjëherë nënën tënde të plakur shtratin të rregullojë për ty, se si i tërheq, shtrin, palos dhe zbut shtresat që të mos ndesh ti as edhe një rrudhë? Frymimi i saj, lëvizja e duarve dhe mollëzkat kaq të dashurueshme janë sa ende në të shkuarën një zjarr në Persepolis janë duke shuar e ndërkaq po ato çaste disa stuhit të ardhme qetësojnë gjireve të Kinës a në dete ende të panjohura.

Vladimir Holan u lind më 1905 në Pragë, Çeki. Punoi për shumë kohë si nëpunës, pas përfundimit të studimeve për Drejtësi.

Pas vargëzimeve të cikleve të para poetike, me afrimin e rrezikut nazist, qaset kah tematikë politike, fillimisht me Luftën Civile në Spanjë e më pas kundër Nazizmit. Cikle të tilla poetike i vijon edhe pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, duke shprehur hapur simpatinë ndaj komunizmit e Bashkimit Sovjetik. Nën këtë frymë idealiste, i largohet edhe besimit fetar, duke u bërë pjesë e Partisë Komuniste. Me thyerjen e besimit në utopinë komuniste dhe i sulmuar prej

akuzave absurde që stiseshin nën atë regjim, e përjashtojnë nga partia dhe kohë më pas i refuzohet çdo lloj botimi.

Pas kësaj, vetizolohet për gjashtëmbëdhjetë vjet në një shtëpi në fshat, duke ndërprerë gjithë lidhjet me botën letrare.

Përgjatë këtyre viteve marrin jetë edhe veprat më të mira poetike të tij: disa cikle poetike dhe ndjesive, e mirënjohur "Natë me Hamletin, 1964", një ngërthim monologjik i refleksioneve dhe ndjesive, e gjitha nën një tis të errët e melankolik.

Në fundvitet gjashtëdhjetë nominohet për çmimin "Nobel". Shuhet më 1980.



JETË E QETË NDANË LIQENIT

Po, gjithçka gjendet këtu. E përkryer dhe në vendin e vet... gjithçka, e qetë e rrëzëllitëse, liri gjen këtu, prej njeriut blatur, bukë e libra, jo, as edhe një fije floku, shkrimin për të të turbulluar a nevojë të ndesh që prej mëngës ta largosh, fare mirë e di se qilari i verës, vetëm verë ruan, forcat e natyrës janë këtu, era, yjet, stuhitë, teksa ti, për fluturimin i etur, ende përstat mbi emrat e anijeve bujtëse.

Përpara se t'i ëndërrësh këto, ndoshta më herët, ti vërtet do t'ia kesh mbathur porsi murgu që Olimpin braktisi sepse asnjë perëndeshë nuk gjeti aty.

PËRMIDIS

Gjendet më shumë nga ç'mund të kuptojmë midis idesë dhe fjalës. Ka ide të cilat asnjë fjalë s'mund t'i shprehë.

Mendimi i humbur syrit të një njëbrëshëri në të qeshurën e një qeni rishfaqet.

NATË PAS NATE

Vetëm një virgjëreshë mund të hyjë nëpër një derë të mbyllur në dhomën e saj ku gjithçka e qajtur siguri ajroren shpuese të masturbimit mban në shtresa, të dhunës, jargëve në pus a mballomë rrëshire vetvetui shkapërdërdhur në kullën e njeriut.

Në qoftë ai poet, çdo gjë do të rrënohet, një vrasës në qoftë, lakuriqësia atëherë do të mbsundojë aty e më tej një duartrotitës do të ketë, një duartrotitës punëshpërblyer prej shkrimeve të mermerta të Eskilit.

PO APO JO?

Konkurrenca përherë i gjen mjetet. Veçse si qëllim është e verbër. Duke rrëmuar në zemra në rrëmojmë verbërive tona. Dhe të verbër për shumë kohë ne përfundojmë thjesht në prekje. Prekje me pohime shfaqësuese se përherë do të ketë të pasur e të varfër jo sepse trupi ndihet i tejnogopur a i uritur, por se secili shpirt njerëzor është i ndryshëm. Ndërkohë është prekia e thjeshtë që pagabueshëm kërkon symbylltas nëpër gjarpërueset shtigje të pazarit të skllërvë.


PËRHERË

Jo se nuk dua të jetoj, por jeta kaq mashtruese është saqë dhe të drejtën më duhet ta kërktoj deri në vdekje.

Dhe këtë po bëj.

QËNDRO

Qëndro me mua, mos më lër, kaq e zbrazët është jeta ime, sa vetëm ti mund të më mbash larg,



krenarisht kokulur, prej pyetjeve të stërzgjatu-
ra.

Me mua qëndro, mos më lër,
mëshiroje padurimin tim,
brenda një qelie zhgarravitur
ky lundrim anijeje
përtjetësish do të na zgjasë.

Qëndro me mua, mos më lër,
ti zemërimin nuk e njeh. Yti zemërim nuk do të
zgjasë
dhe ku do të shkosh, si do të ndihesh
kur të të jetë fashitur?!
Prit pak, prit,
së paku, pritimë deri kur postieri
t'ia behë me letrat vetëm për ty.

MURI

Pse fluturimi yt është rënduar me kaq shumë
përkudjesje?
Pse kaq i zymtë e jo i lehtë ky fluturim?
Një muri i kam folur për pesëmbëdhjetë vjet
dhe zvarrë e kam nxjerrë
jashtë prej fatit tim,
gjithçka, tanimë,
t'jua rrefëje vetë.

VËSHTRUAR

Vështruar prej trenit, që të mirëqena i merr hi-
jet.
Por ajo vërtet ishte e bukur
dhe pa kapelë,
kokëzbuluar, sikur një ëngjëll
kokën të kishte lënë aty
e të kishte shkuar vetëm me kapelë.

TË DËGJOSH NJË REGJISTRIM

Vetëm sot, diku a diku tjetër,
ata kokën janë duke ia këputur fazanit
nisur për në tryezën e mbretit Sargon.
Vetëm sot, dopio çerek tingulli i zogjve, prej ko-
hësh zhdukur
rron në muzika vallesh barbare.
Vetëm sot, bajamet e zakonata të gurgdhend-
jeve,
lavdinë kafshërore përjetojnë fytit të operës.
Vetëm sot, tantalumi e bezoari
shfaqen në nënbrezin e statujave të lashta.

Kurrëgj s'kthehet prej botës tjetër.

Këtu është gjithçka.

Megjithatë, edhe shpirtit përherë i lipset
brenda nesh të hyjë.

E FUNDIT

E fundmja gjethe trandet në pemë
sepse e di që pa shkudje nuk ka prejje.
Trandem edhe unë, Zot, se ndiej
sesi shpejt do të vdes e do më duhet të pre-

hem.

E fundmja gjethe bie prej secilës pemë
porse me tokën e pabesë ajo nuk është;
prej çdo njeriu zhvoshket i fundit iluzion,
dhe krejt e lehtë është rrasa e varrit.
Gjethes nuk i duhet të të lusë për do gjëra, Zot,

Ti e rrite e ajo duart nuk t'i përdhosi,
kurse unë...

AGIM

Kjo është ora kur prifti nis të kopanisë
shpinën e djallit.
Është ora kur mbi shpinë i ngarkohet njeriut
trasta e rëndë mëngjesore.
Është ora e ngricës dhe e pa diellit,
dhe guri ende i ngrohtë është
sepse lëviz.

Është ora kur rrotull brigjeve të veta ngrin liqë-
ni.

Kjo është ora kur ëndrrat nuk janë veç pleshta
që lëkurën e Marsias thumbojnë.
Është ora kur pemët, prej degëve shqyer,
plagët kurojnë me rrëshirë.
Është koha kur elfët vjelin
të ngurosurat fjalë të kohës.

Është ora kur thjesht nga dashuria
dikush të zbrazë guxon
një shpellë stalakmitesh me lot,
që ndryrë në fshehtësi, vullnetin e tyre të mpirë
zhvilloi.

Kjo është ora kur një poezi të duhet ta shkru-
ash
dhe ndryshe ta thuash,
mjaft ndryshe.

TAKIM NË ASHENSOR

Ne hymë në ashensor. Vetëm ne të dy.
U pamë ndër sy dhe vetëm kaq.
Dy jetë, një çast, plotëri, gazmend.
Ajo doli në katin e pestë dhe unë vijova ngjitjen
me dijen se kurrë më nuk do ta shihja.
Takimi qe një herë e vetme për gjithçka:
që nëse e ndiqja, do të ndihesha si një i vde-
kur në gjurmët e saj
dhe nëse ajo do të kthehej tek unë,
do të ishte vetëm në një botë tjetër.

THELLË NË NATË

"Si të mos jesh?" pyet veten dhe zëllartë e
përsëriti së fundi.

Por pema dhe guri janë të heshtur
megjithëse nga fjalat është lindur secila dhe
për aty, të dy heshtën
qyshse dhe fjalat tmerrohet nga çfarë është
bërë.

Por ende mbajnë emra: pishë, panjë, plep...
dhe emra: shpat fushor, bozolit, fonolit, dashu-
ri.

Emra të bukur,
frikësuar nga çfarë janë bërë.

EDHE NJËHERË

Shpesh, edhe miqtë kanë dështuar,
duke mos kuptuar dot vargjet e mia,
(ka qenie që dot s'i vrasim
për gjithë ç'u mungon)
dhe pse në dëshpërimin e shkretimit
për gjithë ç'u tmerruan prej mëkateve njerëzore
disa statuja, sa në dru përfunduan)
dhe pse vetëm vetëvrasia më shoqëronte,
përherë të njëjtat ndjesi kam pasur:
si një hijë të ngrihem
e s'risht atë hijë të rrënoje.

Edhe një herë qeshë në dashuri.

Kur të dielave bie shi

Kur të dielave bie shi dhe i vetëm ti je,
i hapur ndaj botës, por asnjë hajdut s'të vjen
e asnjë i dehur, as armik s'troket,
kur të dielave rìgon e i vetëm ti je.
Dhe as që mendon të frymsh pa trup
a të mos jetosh qyshse trupin e ke
kur të dielave bie shi dhe i vetëm ti je.
Atëherë, është një ëngjëll që gjithë ç'ka sipër
njeh.
Një djall vjen atëherë, që një gjithë ç'ka nën
dhe.

Një libër ti mban, një poezi nxjerr.

PAS DITËS SË SHËN MARTINIT I

E para dëborë ia behu në agim. E re dhe e
ndrojtur,
vetëm një premtim e dhuratë,
iluzion që rrefën se si perëndon bukuria.
Dhe përpara se të vdekshmit,
të ndrojtur prej asaj pranije,
të rrefënin sikur edhe sy gjysmëpërënduar,
zjarrminë e dëshirave të tyre,
padurimthi, toka shkrofëtiu
dhe e etshme nisi të avullojë.

Veçse atëherë
prej do gjurmëve kuptove
se disa çapitën, të tjerët gjurmojnë në kohë.

Pas ditës së Shën Martinit II
Ndodhi pak kohë pas meshës së Martinit.
Unë po shkoja nëpër rrafshin e Gahatagatit.
ecja

Në humor qeshë disa
teksta ende nuk dija se ç'ditë qe.
Por bora kish rënë e rënë e gjithçka kish mbu-
luar.

Dhe era, aq e acartë ia behu në një çast
sa kokën ula
dhe befas, kokulur nisa të vërej
përherë një hap përpara meje,
një gjurmë të re në kohë.

Asnjë frymë s'ndihej përreth.
Kush gjendej pranë meje?

Isha unë që para meje çapisja.

VARGJE

Është koha kur lakra shërbehet me tërbim
dhe urrejtshëm bifteku,
është koha kur verën nxjerr vdekja prej
kuskutës,
është koha kur më i verbër të jesh, më qartë-
sisht sheh,
është koha kur gardhet, tokave janë rrafshuar,
është koha kur loti i nxehet e di
që i vetëm rrëshqet,
është koha kur letrën e librin t'i rrëmben ujku,
është koha kur mbi shpirt një prozhektor rri
varur,
është koha kur palumturinë tënde
ta duash ti nuk mundesh,
sepse të gjithëve u përket.

PISHA

Sa e bukur ajo pishë e vjetër
në kodrën e kujtimeve të fëmijërisë sate
që s'risht erdhe ta shohësh sot...
Nën mërmërimat e saj ti përsiat rreth vdekjes
dhe veten pyet nëse ti do të jesh tjetri.
Nën mërmërima ndihesh
sikur ke përfunduar të fundit libër
dhe vetëm të heshtësh, të mbetet
e të lotosh fjalët që të buisnin.

E ç'jetë ke pasur? Ti të njohurën braktise
për të panjohurën.
Dhe fati yt? Vetëm njëherë të buzëqeshi,
por ti nuk ishe aty...

NË ASGJË

Në asgjënë majmur si një libër i trashë
që një tekst të harruar trajton
prej një poeti të panjohur,
ne, që djersimë në vend që të lotojmë,
ne, që themi se guri djersin kur loton,
sot ndër mendëm dikë që u mbyt
tekta notin mësonte... për të mos u mbytur.

Ndërkohë, parku përtej dritares,
i ngrirë herëve të tjera,
hundën e tij të blertë fshiu mëngëve të erës
dhe vështrioi, më tej, përmas syve të veshullësisë.

GJATË NJË SËMUNDJEJE

Një akullimë në shkërrje, një rubinet në rrjedhje,
pikat e mjerimit duke numëruar.

Tibeti sheh prej ujit. Ne, prej lotësh.

EPOKË

Prej dukjes së objekteve
jemi ende në kohë.

Por sot, përpara se mbjellësi të ketë hedhur
një hap,
kositësi thuajse ka mbërritur.

Duket se jetë nuk do të ketë aty,
as vdekje.

TRUMCAKU

Fluturuar prej një dege të dëbortë, një trumcak
e shkundi pakëz atë,
duke pohuar kështu
mohimin e ndjenjës së verbër.

Pakëz dëborë rrëzuar prej degës.
Shumë shpejt, aty, një ortek do të ketë.

LAMTUMIRË

Edhe njëherë stuhia po lartohet prej çerekut të
erretë të fatit.

E plotëgj ndihet mendja
çuditur si një trup kthyer së mbrapthi.
Cili është ai që mbi flatrën e lakuriqit të natës
vallëzon?

E i pajalë, kush shtangu, prej britmës të asaj
çfarë pa?
Uji i pusit tundon rininë, pranverën kërkon një
burrë.

Gjithçka është mbyllur. Ka ca fjalë që prej dikujt
nuk duhen thënë.
Kurrë nuk do t'i mbash premtimet e dhëna.
Kaika t'i ka mjegulluar sytë.

Përktheu nga anglishtja:
ERALDO HATJIA

LETËRSIA

Oslobogjenje - një nga gazetat e përditshme më të vjetra në rajon, e mirënjohur për standardet e larta të gazetarisë dhe e vlerësuar me shumë çmime ndërkombëtare - publikon në faqet e saj një vështrim kritik mbi librin me tregime "Shpinë burri" të Arian Lekës, botuar në Serbi gjatë vitit 2018 nga "Partizanska knjiga."

Mes të tjerash autori i saj, Gjorgje Krajišnik shkruan: "Arian Leka është autori që na ndriçon madhërisht kontekstin e letërsisë shqiptare. Ndonëse përkthimi i një libri të vetëm nuk do të thotë zbulim i gjithë letërsisë, gjithsesi, e nënvijëzohet, pa librin "Shpinë burri" do të kishim mbetur sot e gjithë ditën padyshueshmërisht më të varfër me një zë të fuqishëm tregimtar, i cili në një formë a në një tjetër, me siguri na përket të gjithëve ne."

"Shpinë burri" na tregon padyshueshmërisht se Arian Leka është një autor ndërmjetësues, që e kapërcen dukshëm një kulturë të vetme, autor që me talentin dhe vrullin e vet hyn në aradhën e mjeshtrave të mëdhenj të kohës sonë."

Hapësirë me plasaritje të imta

NGA GJORGJE KRAJSHNIK

Letërsia shqiptare për ne, në hapësirën postjugosllave, mbetet ende një e panjohur e madhe. Raporti ndaj kësaj letërsie dhe i autorëve të saj ka qenë dhe mbetet i ngarkuar me bariera të llojllojshme politike, por edhe me mosinteresimin tonë absolut për të kuptuar kompleksitetin e jetës në këtë vend dhe orientimin kah kulturës së tij.

Qëndrimi i përgjithshëm i derisotmë ndaj kulturës shqiptare përbën një lloj marrie raciste, që vjen para së gjithash nga largësia gjuhësore, e reflektuar me dekada në letërsi, andaj tek ne kanë mbërritur pak materiale që të mund të zbulojnë atë çka pikërisht letërsia e një vendi në një farë mënyre të afërt për ne, me fenomene të këtilla, të jetë kaq larg nesh.

AVANGARDË LETRARE


Në të shkuarën lexuesit në gjuhën shtokaviane katërmërshe kanë pasur rastin të shohin letërsinë shqiptare para së gjithash përmes përkthimit të klasikut të kësaj letërsie, Ismail Kadare. Gjenerali i tij i ushtrisë së vdekur ka mbetur tek ne një nga krijimet më të njohura, që vjen nga kjo pjesë e botës.

Kompleksiteti i pozicionit politik të Kadaresë, jeta e tij parisiane dhe gjithçka që ajo ka sjellë me vete, e kanë bërë atë ndër të rrallët autorë, që kanë mundur të përcjellin diçka nga bota e mbyllur e regjimit të Hoxhës. Në kohët e reja kësaj mund t'u shtojmë edhe disa përkthime të autorëve kosovarë si Vetton Surroi apo poeti Arben Idrizi, pa lënë jashtë përmendjes dramaturgët Doruntina Basha dhe Jeton Neziri, tekstet e të cilëve janë interpretuar në disa prodhime teatrore rajonale.

Ndonëse bëhet fjalë për krijime letrare, që në shumëcka i kapërcëjnë kornizat lokale, ato gjithsesi nuk kanë ngjallur ndonjë interesim të gjerë në hapësirat tona.

Libri me tregime Shpinë burri i shkrytarit Arian Leka, botuar nga Partizanska knjiga, është përjashtimisht një krijim me vlerë dhe i rëndësishëm për të kuptuar atë çka sot letërsia shqiptare përfaqëson.

Arian Leka është autor që, në kontekstin europian, u bë i njohur pas hapjes së Shqipërisë dhe përfaqëson avangardën letrare, e cila ka për ushqim dominant shartimin e veprimit socrealist të kohës së Hoxhës. Ajo çka lë vrragë të qenësishme në kontekstin e të kuptuarit të këtij libri është fakti që kultura shqiptare në kohën e Enver Hoxhës ishte pothuaj tërësisht e



izoluar.

Në aspektin letrar kjo gjente pasqyrim para së gjithash në kontrollin e rreptë të asaj që krijohet dhe botohej, çka prodhonte një kontekst specifik për zhvillimin e letërsisë e cila, në të çarat e sistemit, rendite e frikësuar drejt mundësive të ndonjë shprehjeje tjetër.


Leka, si shkrytar, gjykonur nga mënyra e ndërimit të tregimeve, e ka përdorur padyshim si ushqim të parë letërsinë socrealiste. Mirëpo si autor ai e shpërfill atë dhe detyshmenë e saj e ka shfrytëzuar për të zhvilluar stilin e rrëfimit i cili, jam i lirë ta them, sot përbën një nga markat më autentike autoriale në këtë pjesë të Evropës.

Ajo çka përmbledhtaz mund të merret si veçori bazë e tregimeve të Arian Lekës ndoshta gjendet në një fjalë të tregimit të tij Terra Firma: "Gjithçka arriti kulmin. Fabula nuk zhvillohej dot më tej, ndaj duhej bërë gërshetë. Përdora teknika postmoderne-metafiksionin, pastisin, fiksionin dokumentar, shfrytëzova paranjoën kolektive dhe euforinë e masave, futa edhe diçka nga realizmi magjik dhe..."

Përgjatë gjithë librit Shpinë burri do të gjendet e alternuar formula e pikturimit të botës në prozë. Në këtë tregime Leka sillet pandërprerë me regjistrë të ndryshuar, eksperimenton me veprimin dhe gjuhën, duke i shpënë shpesh heronjtë e vet në situata krejtësisht absurde.

Të çudit, qoftë edhe në trajtën përkthimore, siguria me të cilën ky krijues zëbërthen disa nga ngjarjet më traumatike të së shkuarës shqiptare dhe të sotmes, por edhe in-vencionit letrar që Leka servir në trajtimin e temave.

Shpinë burri na tregon padyshueshmërisht se Arian Leka është



një autor ndërmjetësues, që e kapërcen dukshëm një kulturë të vetme, autor që me talentin dhe vrullin e vet hyn në aradhën e mjeshtrave të mëdhenj të kohës sonë.

Nëse do të flitim për konturin tematik të këtij libri të Arian Lekës do të mund të përmendim tri linja përmbajtimore që gërshetohen. Njëra syresh, e ngulitur thellë në Shqipërinë e postHoxhës, është pikërisht përplasja mes brezave, ndeshje që vjen pashmangshmërisht pas ndërrimit të një sistemi me një tjetër.

Kjo temë gjithsesi është deri diku familjare për lexuesit e hapësirës së Jugosllavisë së dikurshme, vetëm se Leka atë raport e ekzaminon mjeshhtërisht në një sërë tregimesh. Autori merret para së gjithash me traumën e atyre që kanë përjetuar torturën e diktaturës së Hoxhës, por edhe të atyre që, të ndodhur nën trysni, lanë vendin. Sindromi i arratisë, i shpërnguljes dhe zbrazes së Shqipërisë, në një numër tregimesh, shndërrohet në temë që sundon fatin e tyre.

Leka megjithatë nuk thurr tirada të angazhuara, nuk politizon. Ai

gjurmon në këto hapësira me shumë dromca të së vërtetës dhe prej këtej tregimet e tij hyjnë në një hapësirë me plasaritje të imta, prej të cilave më pas del në honet e konvulsioneve universale njerëzore përballë mundimeve ekzistenciale.

Edhe pse përkthimi i një libri të vetëm nuk do të thotë zbulim i një letërsie të tërë, gjithsesi pa Shpinë burri do të kishim mbetur sot dhe këtu padiskuteshmërisht më të varfër me një zë të fuqishëm tregimtar.

ZBRAZJA E VENDIT

Tema e zbrazes së vendit pas diktaturës mbetet në këtë kontekst interesimi më i fuqishëm artikullor nga Leka. Tregimi Gjilpërat në kokë, për shembull, na rrëfen qartësisht përmasat e katastrofës së një shoqërie të mbytur në vite me dhunë. "Na kishte ardhur radha që edhe ne të ishim nga pak hebrenj. Gjithkujt, herët apo vonë, ka për t'u ardhur radha. Do të ndodhë... Në të vërtetë nuk ka pasur asgjë të shenjtë, por as edhe biblike në eksodin e shqiptarëve në fund të shekullit XX."

Ngjashëm Arian Leka do të trajtojë problemin e largimit edhe në tregimin Lulet në ballkonin e tjetrit, ku heroi përshkon si fantazmë ambientet e zbrazura të të njohurve, që kishin ikur brenda natës, ndërsa në tregimin Pema, në një dialog mjeshhtëror dhe përmes dëshmi të dhunimit të të miturit do të çohet në kulm përplasia komplekse e brezave dhe manifestimi i racizmit ndaj atyre që mbeteshin rrugëve të Evropës.

Temë e dytë e rëndësishme e librit Shpinë burri mbetet tematika e familjes. Kuadri social-politik i përshkruar do të reflektoje edhe në raportet brenda familjes.

Në këto tregime Leka arrin pikën më të lartë. Problemi i përplasjes në një familje tradicionale, bazuar në jetën fisnore dhe me norma të ngurta, me mbërritjen e kohëve të reja, fladit perëndimor, detyrimisht do të sillte ndryshime në strukturën e shoqërisë shqiptare, çka Leka e jep me siguri dhe saktësi prej mjeshtri.

Në tregimin Zogjtë e pikturave, skena ku babai, kryefamiljari, shfaqet cullak para trashëgimtarëve, përbën një kulm rrëfimtari, i cili shtresëzon thellë një siklet që ndryshoi me themel marrëdhëniet brenda familjes.

Kemi përnjëmend të bejmë me një metaforë të mrekullueshme të frikës familjare që mban larg njerëz, që duhet të ishim më të afërtit. Arian Leka në këtë tregim, sikundër edhe në tregimin e arritë Brisku (i cili të kujton disi tonin e rrëfimit të Çamil Sijarçit) tregon shembjen e familjes tradicionale dhe dhimbjeve që e pasojnë. Nga ana tjetër, çështja e dasmës dhe dashurisë, robërimi prej tyre në ato kushte sociale që ekzistonin, në tregimin me titullin e vëllimit Shpinë burri, i ofron lexuesit kujtesë elegante për atmosferën e detajet.

Përfundimisht, linja e tretë tematike që haset në tregimet e Arian Lekës ka të bëjë me eksperimentet letrare postmoderne. Ka plot shembuj në këtë vëllim, ku Leka orvatet të shpërthejë kornizat e tregimit klasik, duke hyrë në eskapada tekstore, të cilat janë tekanjoje dhe presin në besë logjikën e tregimit.

Gjithsesi ajo që shihet nga një manovër e tillë është që ky shkrytar me një gjuhë të tillë mëton të gjejë hapësirë për ironi efektive, qoftë të pozicionit të vetë shkrytarit, qoftë edhe të veprimit të dez-integrimit të tregimit.

Më mirë se kudo gjetkë kjo demonstronhet në tregimet Sekret i demotjetësisë dhe Ftesa. Ndërsa veprimi postmodern në tregimin Krijim i Njeriut të Ri shfrytëzohet me synimin për të shpënë në absurditet çmendurinë nacionaliste të etnoinxhinjerimit dhe mitomanisë.

Arian Leka është autori që na ndriçon madhërisht kontekstin e letërsisë shqiptare. Ndonëse përkthimi i një libri të vetëm nuk do të thotë zbulim i gjithë letërsisë, gjithsesi, e nënvijëzohet, pa librin Shpinë burri do të kishim mbetur sot e gjithë ditën padyshueshmërisht më të varfër me një zë të fuqishëm tregimtar, i cili, në një formë a në një tjetër, me siguri na përket të gjithëve ne.

Përktheu nga origjinali Astrit Beqiraj

Dje në "Zërin e Amerikës"

Ballkani Perëndimor, në darën e protestave

(vijon nga faqja 1)

... i dhënë një zarf me para një bashkëpunëtor të Milo Gjukanovicit, udhëheqësit të Malit të Zi.

Biznesmeni i njohur, ish-mik i ngushtë i presidentit Gjukanoviç, e publikoi videon në fund të vitit të kaluar si hakmarrje ndaj akuzave të ngritura kundër tij për mashtrim dhe pastrim parash, të cilat u bënë shkak që ai të ikte në Londër për t'iu shmangur ndjekjes penale.

Biznesmeni Dushko Knezeviç publikoi gjithashtu një seri dokumentesh që akuzonin presidentin dhe partinë e tij në pushtet për korrupsion, nepotizëm dhe shpërdorim të detyrës, duke pretenduar se i ka dhënë miliona dollarë Gjukanoviçit dhe partisë së tij në pushtet.

Çështja "Zarfi" ka shkaktuar protesta të shumta kundër zotit Gjukanoviç, për të kërkuar dorëheqjen e tij, pas pothuajse 30 viteve në pushtet.

Demonstratat antiqeveritare në Mal të Zi vijjnë ndërkohë që protesta të ngjashme po zhvillohen edhe në Serbinë dhe Shqipërinë fqinje, ku demonstruesit kërkojnë dorëheqjen e udhëheqësve që ata i akuzojnë për sundim autokratik dhe korrupsion, me gjithë premtimet e këtyre udhëheqësve se do t'i fusin vendet përkatëse në Bashkimin Evropian.

Shpërthimi pothuajse i njëkohshëm i lëvizjeve të forta antiqeveritare në rajon ka bërë që të flitet për një "Pranverë Ballkanike", si vala e protestave dhe revolucioneve që përfshinë botën arabe në vitin 2010.


Edhe pse asnjëra nga protestat e deritanishme nuk ka arritur të rrezojë udhëheqësit e Ballkanit, ato kanë inkurajuar një rezistencë qytetare dhe kanë tronditur kontrollin e tyre të fuqishëm mbi pushtetin apo mbështetjen që u vjen nga Perëndimi.

Në Malin e Zi, zoti Gjukanoviç është përballur prej kohësh me akuzat për korrupsion dhe lidhje me krimin e organizuar. Videoja e fundit shihet si goditja më serioze ndaj qeverisjes së tij të deritanishme.

Në një intervistë me agjencinë e lajmeve "Associated Press", zoti Gjukanoviç i mohoi akuzat, duke thënë se pas protestave qëndronë partitë opozitare pro-ruse dhe "faktorët e huaj", edhe pse protestat zyrtarisht drejtohen nga grupe qytetare.

Zoti Gjukanoviç la të kuptohet se protestat kanë për qëllim çarmatosjen e udhëheqësve pro-Bashkimin Evropian dhe largimin e Ballkanit nga Perëndimi në favor të lidhjeve më të ngushta me Rusinë.

"Unë mendoj se kjo në thelb nuk është një lëvizje 'pranverore', por një lëvizje e zymtë vjeshtë", tha ai. "Bëhet fjalë për të mos lejuar që Ballkani të bashkohet me BE-në". Organizatorët e protestës në



Mal të Zi këmbëngulin se demonstrimet përfaqësojnë një lëvizje të sinqertë qytetare pa ndonjë ndikim të huaj. Tubimet e tyre të përjavshme kanë tërhequr mijëra njerëz dhe janë më të mëdha në vitet.

"Shkaku ishte ai zarf që u dha nga një biznesmen... me qëllimin për të blerë votuesit në zgjedhjet parlamentare të 2016-s", thotë Dzemal Peroviç, organizator i protestave në kryeqytetin malazez.

"Qëllimi ynë është ndryshimi i regjimit", tha ai. "Një tranzicion paqësor nga një regjim i korrupsionar, që ka qenë në pushtet prej 30 vitesh dhe që i ka fituar zgjedhjet përmes rryshfetit dhe manipulimit".

Që kur erdhi në pushtet në fund të viteve 1980, "Car Milo-ja", siç quhet zakonisht në Malin e Zi, ka qenë president, kryeministër apo

udhëheqës i partisë falë kalimit nga njëri post në tjetrin. Por, ai ka qenë gjithashtu një aleat i rëndësishëm të Perëndimit në kundërshtimin e ndikimit rus në rajon dhe para kësaj, në shkëputjen nga njëri i fortë i Serbisë, Slobodan Miloseviç gjatë luftërave të viteve 1990.

Edhe në Serbi, presidenti populist Aleksandar Vuçiç e portretizon veten si udhëheqës pro-evropian, ndërkohë që përballet me akuzat për frenimin e lirisë demokratike dhe të mediave në vend. Tensionet politike u rritën muajin e kaluar kur protestuesit hynë në ndërtesën e televizionit shtetëror të zemëruar ndaj raportimeve të këtij stacioni, që ata thonë se është i njëanshëm.

Demonstruesit po kërkojnë dorëheqjen e zotit Vuçiç, zgjedhje të lira dhe më shumë demokraci. Ata kanë planifikuar një tubim të

madh javën e ardhshme në Beograd.

Edhe Presidenti Vuçiç është përpjekur të minimizojë rëndësinë e protestave si një përpjekje e opozitës për të marrë pushtetin me forcë, ndërsa mediat pro-qeveritare i kanë quajtur udhëheqësit e opozitës si vegla të të huajve.

Në Shqipëri, partitë e opozitës vazhdojnë të protestojnë në rrugë që nga mesi i shkurtit, duke bërë thirrje për dorëheqjen e qeverisjes dhe për zgjedhje të parakohshme. Opozita e qendrës së djathtë akuzon qeverinë e majtë socialiste të kryeministrit Edi Rama për korrupsion dhe lidhje me krimin e organizuar, akuzat që qeveria i ka hedhur poshtë.

Protestat kanë qenë të dhunshme. Përkrahësit e opozitës disa herë janë përpjekur të hyjnë në ndërtesat e parlamentit, ose të qeverisë në Tiranë, ndërsa policia ka përdorur gaz lotsjellës dhe pompat e ujit për t'i shpërndarë.

"Tipar i përbashkët i të gjitha këtyre protestave është se njerëzit janë të pakënaqur me regjimet shumëvjeçare dhe të korruptura, është zemërimi i grumbulluar për vite, në mos për dekada me radhë", thotë analisti politik malazez, Stevo Muk.

Shpërthimi pothuajse i njëkohshëm i lëvizjeve të forta antiqeveritare në rajon ka bërë që të flitet për një "Pranverë Ballkanike", si vala e protestave dhe revolucioneve që përfshinë botën arabe në vitin 2010.

HOROSKOPI

DASHI

Të lindurit e kësaj shenje do të përjetojnë momente shumë të këndshme gjatë kësaj të diele. Ka gjasë të merrni disa durata domethënëse. Nuk rekomandohet të bëni blerje dhe as të dërgoni para sot.

DEMI

Do të frymëzoheni nga diçka që do t'ju bëjë të mendoheni gjatë për të ardhmen. Nuk parashikohen evente të veçanta gjatë kësaj dite. Ekziston më shumë mundësia të përfshihen në punë e shtëpisë dhe nuk do të realizoni ato çfarë kishit planifikuar.

BINJAKET

Do të ndiheni mjaft të lodhur sot. Mos u përpiqni të veproni kundër fizikut tuaj. Nëse e ndjeni të nevojshme për t'u relaksuar, mendoni mënyrën më të mirë për ta bërë këtë. Rekomandohet të gjeni kohë edhe për lojëra me fëmijët.

GAFORJA

Gaforet nuk rekomandohet të kalojnë shumë kohë në internet. Është e rëndësishme të përfshihen nëpër aktivitete që do të kënaqin edhe familjen tuaj. Bëni kujdes me dietën ushqimore dhe luftoni zakonet e këqija.

LUANI

Disa Luanë mund të ndodhen në një periudhë të vështirë. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se nuk do të keni momente të lumtura. Mos u shqetësoni nëse konkurrenti ose rivali juaj kryesor është më i fortë se ju. Mendoni me zgjuarsi dhe ecni përpara.

VIRGJERESHA

Të lindurit e kësaj shenje duhet të tregohen më të sinqertë. Ka gjasë t'ju dalë në pah një gënjeshtrë, e cila do t'ju bëjë të ndiheni mjaft keq. Sinqeriteti është i mirësoritur kudo, megjithatë duhet të tregoheni edhe me veten tuaj. Mos u përpiqni të manipuloni të tjerët.

PESHORJA

Mos lejoni që të tjerët të përpqien t'ju ndryshojnë mendimin. Kini besim të vetja dhe tregohuni i sigurt kur dialogoni me të tjerët. Edhe pse është e diel, ka gjasë që të shënoini sukses në biznes. Rekomandohet të gjeni kohë për t'u përkushtuar pamjes fizike dhe mirëqenies.

AKREPI

Akrepat nuk rekomandohen të tregohen agresivë ndaj personave të afërt. Shmangni fyerjet dhe fjalët provokuese. Mbani veten nën kontroll dhe evitoni çdo konflikt të mundshëm. Nuk ka asnjë arsye sot për t'u përfshirë në situata të tensionuara.

SHIGJETARI

Shigjetarët do të marrin disa lajme inkurajuese. Kjo mund të lidhet me marrëdhëniet në familje apo me një çështje trashëgimie. Beqarët e kësaj shenje nuk rekomandohen të përfshihen sot në marrëdhënie romantike, pasi nuk është dita e duhur.

BRICJAPI

Bricjapët do ta shpenzojnë këtë ditë duke shijuar çdo moment. Ka gjasë të realizoni të gjitha planet tuaja. Mos i refuzoni këshillat e tjerëve, mbi të gjitha nëse këshillat vijjnë nga të afërmit tuaj. Bëni kujdes me shëndetin!

UJORI

Ujorët mund të ndihen të lodhur nga dita e sotme. Ka shumë gjasë që pjesën më të madhe të kohës të jeni të aktivizuar në punë, apo me çështje urgjente personale. Vetëm në mënyrë të mund të gjeni pak kohë të lirë.

PESHQIT

Të lindurit e kësaj shenje reagojnë të përfshihen në një konflikt verbal. Ka gjasë që fjalët e shprehura në fuqi të emocionave do të dëmtojnë marrëdhënien tuaj me dikë të afërt. Beqarët e kësaj shenje nuk rekomandohet ta kërkojnë dashurinë nëpër rrjete sociale, pasi ato vende që frekuentojnë më shpesh.

Intervista e Ditës

Roth: Ka rënë interesi strategjik për Ballkanin Perëndimor

Nga Michael Roth

(vijon nga faqja 1)

... Ministrinë e Jashtme gjermane në bisedë me "Deutsche Welle"-n.

Sekretari i Shtetit në Ministrinë e Jashtme, Michael Roth, ishte pjesë e delegacionit që shoqëroi presidentin gjerman, Frank-Walter Steinmeier, në vizitën e tij nga 4-5 prill në Bullgari.

"Deutsche Welle": Zoti Roth, gjatë vizitës në Bullgari, presidenti gjerman përmendi disa herë angazhimin e Bullgarisë për Ballkanin Perëndimor. A mendoni ju se afrimi i Ballkanit Perëndimor me BE ka humbur dinamikën e vet si temë? Kemi nevojë për një impuls të ri?

Michael Roth: Kam përshtypjen, si edhe më parë, se interesi strategjik i BE dhe shumë vendeve anëtare për Ballkanin Perëndimor ka rënë. Kjo është problematike dhe më shqetëson, sepse ne si BE mund të jetojmë të sigurt dhe në stabilitet, vetëm nëse mund të bëjmë më shumë për stabilitetin dhe pajtimin rajonal në Ballkanin Perëndimor. Prandaj gëzohem aq më shumë kur shoh se ka partnerë në BE, që e kanë kuptuar rëndësinë strategjike të Ballkanit Perëndimor.

Çarë mund të bëhet sot në këtë drejtim?

Michael Roth: Rëndësi ka që të rrisim prezencën e BE-së, që të bëhet e qartë se ne nuk i harrojmë njerëzit në Ballkanin



Perëndimor, edhe sepse procesi i transformimit, rruga në BE është treg i brendshëm, një projekt vështirësi për njerëzit atje. Këtë ne po e përjetojmë tani tek të rinjtë, që duan të largohen nga vendi e që vijnë në Gjermani, sepse nuk shohin më perspektivë në vendin e tyre. Përveç kësaj, duhet të bëjmë të qartë se për çfarë

bëhet fjalë kur flasim për BE. BE nuk është në radhë të parë një treg i brendshëm, një projekt ekonomik, por para së gjithash një bashkësi vlerash. Demokracia, shteti ligjor, respekti ndaj pakicave kanë rëndësi parësore për ne. E për këtë nuk duhet të ketë rabat politik.

Gjatë presidencës së BE, Bull-

garia e ktheu në temë qendrore afrimin e Ballkanit me BE. Mendoni se edhe Rumania, presidentja e radhës po angazhohet po kaq shumë Ballkanin?

Michael Roth: Ballkanin Perëndimor duhet gëzohet prioritet për të gjitha presidencat e radhës. Një angazhim të madh e dëshiroj nga të gjithë, jo vetëm nga Gjer-

mania, presidenca jonë e radhës është vitin e ardhshëm. Natyrisht, tani jemi bllokuar nga tema të tjera. Si për shembull Brexit, që kushton shumë energji dhe kohë. Kemi edhe negociatat për kuadrin financiar buxhetor. Prandaj ka aq më shumë rëndësi që në këtë moment të mos e lëmë të humbasë si temë Ballkanin Perëndimor.

Ju përmendët të rinjtë në rajon. Gjatë vizitës në Bullgari, presidenti gjerman, Frank-Walter Steinmeier u mor intensivisht me këtë temë, me shkollimin profesional dhe sistemin dual arsimor, dy instrumente që mund t'u hapin perspektiva të rinjve të qëndrojnë në vend.

Michael Roth: Fillimisht duhet të mbajmë parasysh që të mos e harrojmë Bullgarinë, se ky vend në muajt e fundit është larguar disi nga vëmendja. Ne kemi disa mesazhe: Demokracia, luftimi i korrupsionit, shteti ligjor janë ato që ne si europianë na mbajnë së bashku. Gjermania është e gatshme të bëjë më shumë në drejtim të arsimit dual profesional. E nëse kushtet plotësohen, edhe firmat gjermane janë të gatshme të investojnë në Bullgari dhe Ballkan për të krijuar vende pune. Por kjo nuk është vetëm një çështje e infrastrukturës, por edhe e shtetit ligjor. Kjo është bërë e qartë edhe në bisedimet në Bullgari.

Bisedën e zhvilloi Alexander Andreev, drejtuesi i ekipit bulgar të redaksisë së Ballkanit Perëndimor në "Deutsche Welle"

Arian Galdini: Kodi Zgjedhor si kontratë paramartësore PS - PD!

Kryetari i LDE Arian Galdini ka zhvilluar një takim në Romë me Kryetarin e Parlamentit Europian Fabio Massimo Castaldo.



tuale e madje shpesh herë edhe luftënxitëse. Ne besojmë se Opozita duhet të bashkojë më të mirët

dhe të merituarit e Shqipërisë dhe të rikthehet në institucionalizëm dhe pro-perëndimorizëm. Ne si


LDE jemi partia e vetme e djathtë opozitare që derisot kemi vendosur të marrim pjesë në zgjedhjet lokale të 30 qershorit, por nuk ngurrojmë tu bëjmë thirrje të gjithë aleatëve tanë të Koalicionit Opozitar që edhe ata të regjistrohen për pjesëmarrje në zgjedhje. Së bashku në zgjedhje ne fitojmë. Ne jemi të bindur se Opozita fiton e bashkuar. Nga ana tjetër ne kemi dyshimet tona serioze se "lufta" e dakordësuar mes palëve është pjesë e një plani të dakordësuar gjithashtu, për të mbërritur në një "paqe konventive" për udhëheqësitë politike

të korruptuara. Ndaj u bëjmë thirrje të gjithë miqve ndërkombehtarë perëndimorë të Shqipërisë që të ushtrojnë trysni madhore mbi palët e mëdha politike në Shqipëri që ti ndalin udhët me konsensus negativ. Ka ardhur koha që në Shqipëri të mos komandojmë më 4 apo 5 njerëz, 4 apo 5 familje. Ka ardhur koha që liria të funksionojë në Shqipëri. Duhet ndryshuar Kodi Elektorale. Duhet ndryshuar radikalisht. I plotë. Duhet ndryshuar sistemi. Çështja nuk qëndron tek legjitimiteti i këtij Kodi, por tek fryma e tij kriminale, antiliri dhe antigarë. Ky Kod i miratuar nga PD - PS në 2008 është si një kontratë paramartësore e këtyre 2 partive të cilën e mbështet edhe LSI, e treta që ka kuptuar se Kodi ia jep mundësinë të endet sa në krahët e PS aq edhe në krahët e PD. Duhet ndryshuar sistemi zgjedhor dhe përbajtja e fryma e Kodit. Po nuk ia rikthejmë shpirtin e lirisë dhe barazisë e drejtësisë së garës Kodit Elektorale, nuk e prishim dot martesën e PD me PS."

Politikani i Opozitës shqiptare Galdini i ka shprehur Zv/ Presidentit të Parlamentit Europian, pikëpamjen e tij dhe të LDE mbi zhvillimet politike aktuale në Shqipëri.

Pedagogu Galdini i tha europarlamentarit Castaldo se: "Vendimi që ka marrë LDE për të marrë pjesë në zgjedhjet lokale nuk është aspak as braktisje e Opozitarizmit dhe as e Koalicionit Opozitar. Ne si LDE - Partia për Liri, Demokraci dhe Etikë ndajmë opinione dhe qëndrime të ndryshme me aleatët tanë mbi strategjitë dhe veprimet e ndërmarra prej tyre pas 16 shkurtit 2019 e kënde, por ama jemi të qartë e të vendosur në kërkesën se KM Edi Rama përbën tashmë një rrezik publik për demokracinë, lirinë, udhëtimin europian dhe financat e shqiptarëve. Ne si LDE nuk e mbështesim aspak, madje e quajmë krejtësisht të gabuar "djegjen e mandateve", sikurse nuk e ndajmë aspak gjuhën ultimative, konflik-

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Bëjnë arte me re.
- Krijoi Arsene Lupin (inic).
- Janë forma.
- Në hyrje të plazhit.
- Kapen të parat.
- Janë ufot.
- Mbahen nga ata që i thyejnë.
- Inicialet e Mascagnit.
- Në krye të trupave.
- Eshtë edhe ai i Këngëve dhe valleve.
- Pak hemorrhagji.
- U shkrua nga Jack London.
- Institucione Ndërkombëtare Europiane.
- Scarlet e Bashkë me erën.
- Janë tituj në ekran.
- Eric aktor.
- Kështu e ka syrin vigjilenti
- Janë nofka.
- Një provë... inteligjence.

- Mund të jenë me sahat.
- Një pjesë e naivitetit.
- Pak imagjinatë.
- Pikat pa kufij
- Fillojnë aksionin.
- Kërkohet nga poetët.
- Nota e diapazonit.
- I prin kolonës.
- Eshtë filozofie moraliit.
- Ulet në dhomën e lartë.

VERTIKAL

- Malet pa kufij.
- Janë banorë imagjinarë të planetit të kuq.
- Inicialet e Altman.
- Një sportist që arrin majat
- Courier ish-kampion i tenisit.
- Fillojnë testin.
- Mund të jetë parabolike.
- Bie me ballë.
- Camera, ish-kampion i ringut.
- Lidhet mes punëtorit dhe punëdhënësit
- I kanë rrënjët në tokë.
- Eshtë pushkë.
- Brown i Kodi i Da Vinci-t.
- Takim Brezash Durrës.
- Ishte lumi i Elizit
- Eshtë kardinal.
- Mbyllin një krah.
- Artikull anglez.
- Mbyllin fushatat.
- Partia pa ara.
- Zola që shkroi Nana
- Nganjehet duhen vënë mbi i.
- Një fjalë kastile
- Inicialet e Mann shkrimtar.
- Maiden që këndojnë.
- Ai i shtatë është kinemaja.
- Fillojnë arsyetimin.
- Eshtë nënë e Tironës.
- Eshtë shahu i fundit.
- Inicialet e Klee piktor.
- Dy asa.
- Mbarojnë fare

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL:

- Patricia këngëtare.
- I vocërr ai i Migjenit
- Hari splune.
- Qyteti i Robespierre.
- Phimeas i famshëm i cirikut.
- Pak latinisht.
- Inicilet e Banderas.
- Janë tek në rrota.
- Pak efikasitet.
- Eshtë shkolla fillore.
- Arrihet duke aderuar
- Pak iniciativë.
- Një... art i Don Judd.
- U kompozua nga Rachmaninov.
- Diku në qendër.
- Një është për të lidhur.
- Jepet për hartim.
- Sergej, poet i famshëm rus.
- Veriu pa kufij.


- Mbyllin një tender.
- Një pjesë analogjisë.
- Mjeku pa ju.
- Nisin nga kreu.
- Një racë kombi.
- Një rapper i famshëm.
- Një pikë... vaj.
- Në fund majtas.
- Ndizen me një çelës.
- Emri i Delon
- Janë të dërguar specialë

VERTIKAL


- Eshtë edhe ai i sheqerit.
- Eshtë lloj papagalli.
- Një Pop i Andy Warhol.
- Sapo fillojnë.
- Qendër në Kubë
- Eshtë pluhuri si Dash.
- Eshtë e hollë dhe therëse.
- Fillojnë muzikën.
- Një kontinent i ri.
- Eshtë për medaljen e parë.
- Kujtohet për një fitore të grekëve ndaj persëve.
- Provinca e boerëve.
- Eshtë qyteti i njëmbinjë ditoreve.
- Eshtë dukuria.
- Eshtë hidrokarbur.
- Griffith aktore.
- Qe përdështa e fitores.
- Mbeten në fund.
- Tregon gminin.
- Këndohet në opera.
- Para Fe në New Mexico.
- Eshtë princ arab.
- Tony që këndon Quando, quando, quando.
- Bën mëza.
- Pak tolerante.
- Modem pa zë.
- Pak maramendëse.
- Mbyllin një dyqan.
- Fillojnë teorikisht.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

HORIZONTAL: 1. FISH, 2. ARSENE LUPIN, 3. NJË, 4. PLAZHI, 5. KAPEN, 6. NJË, 7. NJË, 8. NJË, 9. NJË, 10. NJË, 11. NJË, 12. NJË, 13. NJË, 14. NJË, 15. NJË, 16. NJË, 17. NJË, 18. NJË, 19. NJË, 20. NJË, 21. NJË, 22. NJË, 23. NJË, 24. NJË, 25. NJË, 26. NJË, 27. NJË, 28. NJË, 29. NJË, 30. NJË, 31. NJË, 32. NJË, 33. NJË, 34. NJË, 35. NJË, 36. NJË, 37. NJË, 38. NJË, 39. NJË, 40. NJË, 41. NJË, 42. NJË, 43. NJË, 44. NJË, 45. NJË, 46. NJË, 47. NJË, 48. NJË, 49. NJË, 50. NJË, 51. NJË, 52. NJË, 53. NJË, 54. NJË, 55. NJË, 56. NJË, 57. NJË, 58. NJË, 59. NJË, 60. NJË, 61. NJË, 62. NJË, 63. NJË, 64. NJË, 65. NJË, 66. NJË, 67. NJË, 68. NJË, 69. NJË, 70. NJË, 71. NJË, 72. NJË, 73. NJË, 74. NJË, 75. NJË, 76. NJË, 77. NJË, 78. NJË, 79. NJË, 80. NJË, 81. NJË, 82. NJË, 83. NJË, 84. NJË, 85. NJË, 86. NJË, 87. NJË, 88. NJË, 89. NJË, 90. NJË, 91. NJË, 92. NJË, 93. NJË, 94. NJË, 95. NJË, 96. NJË, 97. NJË, 98. NJË, 99. NJË, 100. NJË.

FJALËKRYQI (2)

HORIZONTAL: 1. PATRICIA, 2. I, 3. NJË, 4. HARI, 5. QYTETI, 6. PHIMEAS, 7. NJË, 8. INICILET, 9. NJË, 10. NJË, 11. NJË, 12. NJË, 13. NJË, 14. NJË, 15. NJË, 16. NJË, 17. NJË, 18. NJË, 19. NJË, 20. NJË, 21. NJË, 22. NJË, 23. NJË, 24. NJË, 25. NJË, 26. NJË, 27. NJË, 28. NJË, 29. NJË, 30. NJË, 31. NJË, 32. NJË, 33. NJË, 34. NJË, 35. NJË, 36. NJË, 37. NJË, 38. NJË, 39. NJË, 40. NJË, 41. NJË, 42. NJË, 43. NJË, 44. NJË, 45. NJË, 46. NJË, 47. NJË, 48. NJË, 49. NJË, 50. NJË, 51. NJË, 52. NJË, 53. NJË, 54. NJË, 55. NJË, 56. NJË, 57. NJË, 58. NJË, 59. NJË, 60. NJË, 61. NJË, 62. NJË, 63. NJË, 64. NJË, 65. NJË, 66. NJË, 67. NJË, 68. NJË, 69. NJË, 70. NJË, 71. NJË, 72. NJË, 73. NJË, 74. NJË, 75. NJË, 76. NJË, 77. NJË, 78. NJË, 79. NJË, 80. NJË, 81. NJË, 82. NJË, 83. NJË, 84. NJË, 85. NJË, 86. NJË, 87. NJË, 88. NJË, 89. NJË, 90. NJË, 91. NJË, 92. NJË, 93. NJË, 94. NJË, 95. NJË, 96. NJË, 97. NJË, 98. NJË, 99. NJË, 100. NJË.

SUDOKU

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|--|---|
| | | | | 6 | 4 | 3 | | | |
| 4 | | | | 8 | 1 | | | | |
| | | 8 | | | | | 2 | | |
| 2 | | | 1 | | 7 | 4 | | | |
| 5 | | | | | | | | | |
| 8 | | 2 | | | | | | | |
| | | | | | | | | | |
| | 9 | 7 | 8 | | | | | | 3 |
| 3 | | | 5 | 9 | | | | | 1 |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|--|
| 6 | 9 | 4 | 3 | 1 | 7 | 2 | 5 | 8 | |
| 3 | 1 | 8 | 5 | 2 | 6 | 9 | 4 | 7 | |
| 5 | 2 | 7 | 8 | 4 | 9 | 6 | 3 | 1 | |
| 7 | 8 | 5 | 2 | 6 | 3 | 1 | 9 | 4 | |
| 1 | 3 | 6 | 9 | 8 | 4 | 5 | 7 | 2 | |
| 9 | 4 | 2 | 7 | 5 | 1 | 8 | 6 | 3 | |
| 4 | 5 | 3 | 1 | 9 | 2 | 7 | 8 | 6 | |
| 2 | 6 | 9 | 4 | 7 | 8 | 3 | 1 | 5 | |
| 8 | 7 | 1 | 6 | 3 | 5 | 4 | 2 | 9 | |

Argëtim filozofik

-Ta zemë se ajo më do, sa shumë do të më merzisë në këtë rast. Dhe, ta zemë se nuk më do, sa shumë arsye më të mëdha akoma do të kishte në këtë rast që ajo të më bëhet e mërzitshme! -Pra, nuk paska veçse dy mënyra për t'u mërziur: kështu që, le të marrohem.

- Një mik gjatë gjithë jetës është mjaft, dy janë shumë, tre pothuajse është e pamundur.

Thënie të mençura

- Kur interesohesh, nuk harron... kur kujdesesh, nuk i kthen shpinën mbropa, kur do...nuk kërkon kohë ... kur dashuron nuk lëndon!!!
- I vetmi person që mund të kontrollosh në një marrëdhënie, është vetëvetja.
- Gjëja më e mirë që ka për të bërë dikush që nuk është i sigurtë në vetveten e tij, është të heshti.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

4 1 9 2 10 19 6 5 4 5 3 19
6 4 1 3 11 3 T R S U P
13 4 3 2 4 3 2 4 5 3
7 2 9 5 4 6 5 4 5 3
13 5 11 6 4 5 10 3 5 3 14 4
19 3 2 16 1 4 2 3 2
7 4 6 14 5 2 1 11 5
8 11 1 6 11 14 4 2 18 11
3 2 10 3 2 11 6 18 4 4 2
18 8 4 5 7 6 14 6 3 5
15 2 3 2 11 2 11 6 5 10 5 3
5 3 2 14 2 3 7 2 3 5 3 6

M I K E K M S E
E K A R O M A K E T
K M I L I T A N T E T
M A T E M A T I K A
P A S A N I K T S
E K U A N E T A R E T
R E T E I R A N I
I T R B L A K E L
M I A R E D E K I
E M E T A L E I S
T E K E M K U M T
M O R A V I A M A E

